

UNIVERZITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH – EAST EUROPEAN UNIVESITY



FAKULTETI I DREJTËSISË
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ
FACULTY OF LAW

STUDIME PASDIPLOMIKE-CIKLI I DYTË

TEZA:

**KORRUPSIONI NË PROKURORIMET PUBLIKE DHE FORMA E PARAQITJES SË
TIJ NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT**

MENTOR:

Prof D-r Ismail Zejneli

KANDIDAT:

Nustret Sulejmani

Tetovë, 2019

Mirënjohje

Ky hulumtim kërkoi shumë përkushtim, përgatitje dhe bashkpunime të ndryshme, prandaj do të ishte e udhës që të përmendim edhe të gjithë ata të cilët e ndihmuan këtë proces. Ky punim nuk do të ishte i mundur në rradhë të parë, pa ndihmën e mentorit tim Prof. D-r. Ismail Zejneli, udhëzimet, këshillat dhe toleranca e të cilit ishin shumë të rëndësishme gjatë shkriimit të këtij punimi.

Gjithashtu do të doja që të falënderoj stafin e institucioneve të cilët më ndihmuan dhe më dhanë informacionet që u kërkua, ato janë: Ministria e Punëve të Brendshme, Prokuroria Publike Shtetërore, PSP, të cilët pranuan të ishin pjesë e këtij studimi.

Në fund do ta falënderoja familjen time dhe shokët e mij të cilët më ndihmuan dhe mbështetën gjatë kësaj pune.

Abstrakt

Tema e prokurimeve publike haset shumë shpesh në shoqërinë e çdo shteti, për shkak se aty preken edhe fushat më të ndjeshme të saj si sektori privat, publik, taksapaguesit etj. Prokurimet publike si pjesë kryesore e funksionimit normal të një shteti, kanë rol kryesor në zhvillimin e drejtë të tregut ekonomik dhe konkurrencës. Për shkak të rëndësisë së madhe që ka stabiliteti i vet sistemit të prokurimeve publike dhe vendin e tij në Bruto Prodhimit Vendor të shtetit, një pjesë e konsiderueshme e mjeteve të tij janë të lidhura me qëllimet themelore që duhet të arrihen nëpërmjet sistemit të furnizimeve publike, të cilat janë: konkurenca, transparenca, llogaridhënia, jodiskriminimi, dhe shumë karakteristika të tjera themelore.

Sistemi për prokurim publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut është i rregulluar me ligjin për prokurim publike. Qëllimi i këtij punimi është që nga njëra anë të bëjë paraqitjen, analizat dhe krahasimet në lidhje me rregullacionin e prokurimeve publike dhe përputhshmërinë e ligjit të prokurimeve publike me normat europiane, dhe nga ana tjetër me anë të hulumtimit i cili është gjithashtu pjesë përbërëse e punimit, të hulumtojmë dhe analizojmë rastet dhe shkaqet e inkriminimit dhe korupsionit, të cilat kanë ndodhur nëpër institucionet shtetërore që kapin sferën e prokurimeve publike.

Korniza normative ekzistuese për prokurime publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, siguron respektimin e parimeve themelore të transparences, trajtim të barabartë, efikasitet dhe kursim gjatë ndarjes së marrëveshjeve të prokurimeve publike. Duke e pasur parasysh faktin se nëpërmjet prokurimeve publike, harxhohen para publike, para të qytetarëve dhe firmave nëpërmjet të taksave, imponohet nevoja që kjo të realizohet sa më me më përgjegjësi, transparenca, ligjore dhe të qartë dhe sa më publike etj. dhe gjithashtu të jepet raport për atë se si janë harxhuar paratë e tyre.

PËRMBAJTJA

HYRJE	1
QËLLIMET E HULUMTIMIT	4

KAPITULLI I PARË

1.KARAKTERISTIKAT DHE ZHVILLIMI I SISTEMIT TË PROKURORIMEVE PUBLIKE .5	
1.1. Sistemi i prokurimeve publike pas pamvarësimit të Republikës së Maqedonisë (viti 1996 – 2007)	5
1.2. Korniza ligjore dhe institucionale e prokurimit publik në R.M	6
1.2.1. Parimet themelore	9
1.2.2. Përgjithshme	10
1.2.3. Planifikimi i prokurimeve publike	10
1.3. Hulumtime për rregullimin ligjor dhe mbrojtjen ligjore të prokurimeve publike në RM	12
1.3.1. Byroja e Prokurimeve Publike	13
1.3.2. Komisioni Shtetëror i Ankesave për Prokurimin Publik	14
1.3.3. Të drejtë ankese kanë	15
1.3.4. Gjykata Administrative e Republikës së Maqedonisë	15
1.3.5. Gjykata e Lartë Administrative	16
1.3.6. Enti Shtetëror i Revizionit në kontrollin e ligjshmërisë së procedurës	16
1.3.7. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit	17
1.3.8. Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës	18
1.4. Legjislacioni i Bashkimit Evropian	18
1.4.1. Korniza ligjore e BE-së në fushën e prokurimit publik	18

KAPITULLI I DYTË

2.FAZAT DHE LLOJET E PROCEDURAVE TË PROKURORIMIT PUBLIK	20
2.1. <i>Pragjet financiare në prokurimin publik</i>	20
2.2. <i>Fazat në prokurimin publik</i>	22
2.3. <i>Përzgjedhja e ofertës më të favorshme</i>	23
2.4. <i>Lidhja e Marrëveshjes</i>	23
2.5. <i>Zbatimi i Marrëveshjes</i>	25
2.6. Llojet e procedurave të prokurimit publik.....	25
2.6.1. <i>Prokurime me vlerë të vogël</i>	25
2.6.2. <i>Procedura e hapur e thjeshtësuar</i>	26
2.6.3. <i>Procedura e hapur</i>	26
2.6.4. <i>Procedura e kufizuar</i>	27
2.6.5. <i>Procedura konkurruese me negociim</i>	29
2.6.6. <i>Dialogu konkurrues</i>	31
2.6.7. <i>Partneriteti për inovacione</i>	34
2.6.8 <i>Procedura me negociim pa publikim të shpalljes</i>	36
2.6.9 <i>Procedura me negociim me publikim të shpalljes</i>	38
2.6.10 <i>Mënyrat e veçanta për zbatimin e procedurës</i>	39
2.6.10.1. <i>Marrëveshja kornizë</i>	39
2.6.10.2. <i>Sistemi dinamik për prokurime</i>	40
2.6.10.3. <i>Ankandi elektronik</i>	40
2.6.10.4. <i>Katalogu elektronik</i>	41
2.6.10.5. <i>Aktivitetet e centralizuara për prokurim dhe trupi qendror për prokurime</i>	41

KAPITULLI I TRETË

3.PROBLEMET NË ZBATIMIN E LIGJIT PËR PROKURIME PUBLIKE	42
3.1. Transparenca dhe përgjegjësia e pamjaftueshme	42
3.2. Abuzimi me marrëveshjet e drejtpërdrejta	43
3.3. Korrupsioni në prokurorimin publik	43

KAPITULLI I KATËRT

4.PARANDALIMI I KORRUPSIONIT	46
4.1. Roli i policisë në parandalimin e korrupsionit	46
4.1.1 Policia financiare	48
4.2. Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë	54
4.2.1. Prokuroria Publike Speciale	57
4.3. Roli i gjykatave në parandalimin e korrupsionit	70
4.3.1. Gjykatën Themelore	70
4.3.2. Gjykatat e Apelit	73
4.3.3. Gjykata Supreme	74

PËRFUNDIMI:

ANALIZA	75
KONKLUZIONI	78
LITERATURA E SHFRYTËZUAR	81
SHTOJCAT	85

Hyrje

Meqenëse po jetojmë në një shtet i cili bën pjesë në vendet të cilat kanë aspirata për integrimin e tyre në shoqërinë e shteteve evropiane, vend i cili ka nevojë që të aplikojë shumë metoda të reja në çdo sferë duke përfshirë këtu edhe prokurimet publike, zgjedha këtë temë e cila jo rastësisht është një ndër temat më aktuale nëpër media të shkruara dhe elektronike, në mënyrë që të vetëdijsohemi për rëndësinë e kësaj problematike. Edhe pse studimi im është më tepër analizë dhe sipërfaqësor, përsëri përmban argumente që ndihmojnë në kuptimin dhe shqyrtimin e kësaj problematike.

Prokurimet publike përbëjnë një sërë aktivitete të kryera nga Organet kontraktuese, të cilat kanë të bëjnë me blerjen e mallrave, kryerjen e shërbimeve ose realizimin e punëve. Dihet pak për thelbin e rregullave të prokurimit publik, sepse ata janë të vendosur nga praktikatat e mira ndërkombëtare që po zhvillohen në botë pothuajse gjysmë shekulli.¹

Zhvillimi i drejtë i ekonomisë së tregut dhe konkurrencës është drejtpërsëdrejti i varur nga proceset e drejta të prokurimeve publike, për shkak se një sistem i shëndoshë dhe i qëndrueshëm i prokurimeve publike mund të shihet nga vëllimi i tyre si pjesë e BPV-së së përgjithshme të një vendi.

Për këtë arsye, objektivat kryesore që duhet të arrihen përmes sistemit të prokurimeve publike janë: “konkurrenca ndërmjet operatorëve ekonomik, trajtimi i barabartë dhe mosdiskriminimi i operatorëve ekonomik, transparenca dhe integriteti, procesi i ndarjes së kontratave për prokurime publike, shfrytëzimi racional dhe efikas i mjeteve në procedurat për ndarjen e kontratave për prokurime publike dhe parimet tjera themelore të cilat vazhdojnë të jenë bazë e sistemit për prokurime publike,”² si dhe inovacione, qëndrueshmëri, konsideratë për aspektet sociale dhe mjedisore, etj. Në këtë punim, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet rregullimit të prokurimeve publike, harmonizimit me normat evropiane dhe arritjes së qëllimit thelbësor, zhvillimit të korrupsionit përmes prokurimeve publike.

¹Богева Мицовска, М., Јованоска, М., Агрировски, А., Глигоријевска, Р., Примена на Законот за Јавни Набавки во Пракса II издание, Здружение на финансиски работници на локалните самоуправи и јавните претпријатија- Велес, Скопје 2012Fq.11

²Ligji për prokurime publike neni 2 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 136/2007; 130/2008, 97/2010, 53/2011, 185/2011, 15/2013, 148/2013, 160/2013, 28/2014, 43/2014, 130/2014, 180/2014, 78/2015, 192/2015, 27/2016, 120/2016, 165/2017 dhe 83/2018)

Në këtë punim magjistrature, i cili bazohet në përpunimin teorik dhe empirik, në mënyrë të detajuar është përpunuar tematika për Prokurimet publike dhe korrupsionin në sektorin publik. Punimi fokusohet në studimin dhe analizën e sistemit të prokurimeve publike, format e shfaqjes së korrupsionit në procesin e prokurimeve publike. Në këtë punim shkencor-hulumtues, tema është e orientuar drejt të kuptuarit dhe përpunimit të procedurave ligjore, nevojës për ekzistimin e tyre dhe ndikimin dhe rolin e tyre në zhvillimin e rregullimit juridik në këtë sferë. Nëpërmjet këtyre veprimeve shteti furnizohet me mallra, shërbime dhe punë që janë të nevojshme, dhe për të cilat një përqindje e madhe e buxheteve kombëtare rrjedhin pikërisht për këtë qëllim, a janë prokurimet publike pasojë ose pjesë integrale e modernizimit social dhe politik të shoqërisë, gjë që kërkon mbikëqyrje të gjerë të pjesëmarrësve ekzistues të cilët vendosin mbi procedurat për ndarjen e kontratave për prokurime publike.

Marrëveshje për furnizim publik është marrëveshja me interes financiar, që i përfshin edhe marrëveshjet e sektorëve, të lidhur me shkrim ndërmjet një apo më shumë organeve kontraktuese nga njëra anë dhe një apo më tepër operatorëve ekonomik nga ana tjetër, ndërsa lëndë e së cilës është realizimi i punëve, dërgesa e mallrave ose sigurimi i shërbimeve, në pajtim me këtë ligj.³

Aktualizimi i temës për prokurime publike ka të bëjë, para së gjithash, me nevojën gjithnjë në rritje të qytetarëve për të ditur se në ç'mënyrë shteti i shpërndan paratë të cilat ata i derdhen në buxhetin e shtetit. Pikërisht nga buxheti i shtetit sigurohen prokurimet me mallra, shërbimet dhe punët. Shpenzimet për këtë zë buxhetor nga viti në vit rriten, në pajtim me nevojat në rritje dhe të vetë shoqërisë.

Ky punim do të përpiqet të jep përgjigje në çështjet e hulumtuara:

1) Si funksionon procesi i prokurimeve publike?

2) Cilat janë format e shfaqjes së korrupsionit në prokurimet publike?

Në kuadër të këtij hulumtimi janë shpalosur një sërë studimesh rasti që konfirmojnë nevojën për zbatimin e kontrolleve në prokurimet publike. Në kushte të korrupsionit mjaft të përhapur në sferën e prokurimeve publike, është i nevojshëm përmirësimi i rregullativës ligjore dhe

³Ligji për prokurime publike neni 3 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 136/2007; 130/2008, 97/2010, 53/2011, 185/2011, 15/2013, 148/2013, 160/2013, 28/2014, 43/2014, 130/2014, 180/2014, 78/2015, 192/2015, 27/2016, 120/2016, 165/2017 dhe 83/2018).

përforcimit të përgjegjshmërisë së bartësve të pushtetit në drejtim të shpenzimit të duhur dhe racional të parave publike përmes një procesi transparent dhe llogaridhënës.

Në përputhje me mbikëqyrjen e prokurimeve publike në nivel lokal për muajin qershor të vitit 2018, rezultatet tregojnë se konkurrenca e ulët në tenderët lokal, mesatarja shumëvjeçare e të cilëve është 2,6 oferta për tender, vazhdon edhe më tutje të lëviz nën tre ofertues, gjë që konsiderohet si konkurrencë minimale. Në tenderët e mbikëqyrur, ka pasur mesatarisht nga 2,8 ofertues, njëjtë si në periudhën e mëparshme. Ajo që shqetëson më tej është përqindja e rritur e tenderëve me një ose pa asnjë ofertë të vetme, që ka kërcyer në 40% në periudhën e mbikëqyrur, e që paraqet nivelin më të lartë në tre vitet e fundit. Projektimi i keq i vlerës së prokurimeve shpesh çon në dështimin e tenderëve lokal. Disa nga tenderët anulohen madje nga disa herë, dhe kalojnë vetëm pasi të jetë korrigjuar vlera e projektuar. Përqindja e procedurave të anuluarra të prokurimeve publike në kampionin e mbikëqyrur u ngjiti në 20%, duke arritur përsëri kufirin më të lartë në pesë vitet e fundit. Madje në rreth 50% të procedurave të anuluarra, arsyeja për anulimin ka qenë mospasja e asnjë oferte. Ankand elektronik është mbajtur vetëm në 58% të tenderëve të mbikëqyrur. Ai është i suksesshëm vetëm tek prokurimet me më shumë konkurrencë, ndërsa tek të tjerat është vetëm formal dhe shpesh duket sikur operatorët ekonomik merren vesh se si do të futen në ankand. Si në asnjë periudhë më parë, gjatë kësaj periudhe të mbikëqyrur, të dhënat e kërkuara përmes qasjes së lirë deri në informacionet me karakter publik, në 28% të tenderëve janë siguruar me anë të ankesës deri tek Komisioni për mbrojtjen e kësaj të drejte.

Sipas mbikëqyrjes së prokurimeve publike nga muaji qershor i vitit 2017, në tenderët e mbikëqyrur ka pasur mesatarisht nga 2.4 ofertues, ndërsa në 35% e tenderëve kanë pasur një apo asnjë ofertë. Ndonëse të obligueshme për të gjitha prokurimet, ankandet elektronike janë mbajtur vetëm në 55% të tenderëve të mbikëqyrur. Përkundër kësaj, përqindja e të ashtuquajturave e-procedura ose tenderë të cilat kryhen plotësisht në mënyrë elektronike është 58%. Ulja mesatare e çmimeve gjatë e-ankandëve ka qenë vetëm 10%.

Ndërkaq, mbikëqyrja e prokurimeve publike për muajin qershor të vitit 2013, tregon lëshime të caktuara, vërejtje apo gjëra të palogjikshme në zbatimin e prokurimeve publike që janë regjistruar në pjesën dominuese të procedurave të mbikëqyrura në nivel lokal. Në një pjesë të

mirë të procedurave të mbikëqyrura, ka nga disa vërejtje, ndërsa nuk është i vogël numri i procedurave ku lëshimet e regjistruara çojnë deri në situata absurde.

Qëllimet e hulumtimit

Sistemi i prokurimit publik është thelbësor për shpërndarjen e fondeve publike nga ana e autoriteteve shtetërore të cilët duhet të përpiqen për një procedurë të drejtë, bashkërisht me sektorin e biznesit për një ndarje të drejtë të bazuar në ligj, duke marrë vlerën më të mirë për paratë. Sipas parimeve të Bashkimit Evropian mbi lëvizjen e lirë të mallrave, kapitalit dhe shërbimeve në të gjithë Shtetet Anëtare të BE-së, kjo çështje bëhet gjithnjë e më e rëndësishme. Sistemi i prokurimit përpiqet të sigurojë llogaridhënie dhe transparencë në shpenzimin e parave publike, me shqyrtimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit, për të parandaluar keqpërdorimin e parave të obliguesve tatimor. Qëllimi i këtij punimi është që të promovojë zbatimin e prokurimit publik nga organet shtetërore në vend në drejtim të transparencës më të madhe, llogaridhënies dhe përgjegjësisë në shpenzimin e parave publike, nëpërmjet një studimi të praktikave aktuale në prokurimin publik, në mënyrë për të zbuluar dobësitë dhe gabimet dhe të nxjerrë rekomandime dhe udhëzime për përmirësimin e procesit dhe procedurave.

Qëllimet kryesore të këtij punimi janë:

- 1) Analiza dhe përpunimi i detajuar i procesit të prokurimit publik,
- 2) Përcaktimi i formave të korrupsionit në prokurimet publike.

Objektivat e prokurimit publik janë të lidhura drejtpërdrejt me parimet. Për të arritur objektivin e prokurimit publik, ligji përcakton rregullat e procedurave përmes të cilave dhe vetë procedurën e dhënies së kontratës. Qëllimet e prokurimit publik janë: konkurrencë ndërmjet operatorëve ekonomik, më qëllim parandalimin e korrupsionit dhe përmirësimin e disiplinës financiare në menaxhimin e fondeve publike për të rritur mundësinë e shqyrtimit publik në shpenzimet publike, shpenzimet racionale të fondeve publike.

Duke nisur nga fakti se ekzistojnë situata universale dhe identike në aplikimin për shkak se ligji nuk mund të parasheh çdo situatë. Në të vërtetë, përmes prokurimit publik, shteti duhet të tregojë në mënyrë të qartë se ai respekton parimet bazë të ekonomisë së tregut, që kryen funksionin e projektuar dhe si garantues i funksionimit normal të konkurrencës së lirë dhe të drejtë.

KAPITULLI I PARË

1. Karakteristikat dhe zhvillimi i sistemit të prokurimeve publike

1.1. Sistemi i prokurimeve publike pas pavarësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (viti 1996 – 2007)

Me hyrjen në fuqi të Urdhërësës (Rregullores) për Prokurim Publik në vitin 1996, filloi vendosja e sistemit të ri të Prokurimeve publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Me këtë rregullore janë rregulluar procedura dhe mënyra e arritjes së kontratave (marrëveshjeve) ndërmjet Qeverisë së RMV, autoriteteve republikane, organeve administrative dhe shfrytëzuesve të tjerë të buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërmarrjeve publike të themeluara nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, respektivisht Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, me persona juridik dhe fizik, për furnizim të mallrave, kryerje të shërbimeve, të drejtave materiale dhe punimeve në ndërtimtari (urdhrave publike).⁴

Kjo Rregullore (edhe pse krahasuar me sistemin e sotëm të prokurimeve publike dhe me ligjin e sotëm mbi prokurimet publike, nuk paraqet ndonjë zgjidhje sistematike dhe afatgjate) ka vendosur themelet e sistemit të prokurimeve publike në RMV pas pavarësimit të saj, ku në vete përmbante parimet themelore të transparencës dhe konkurrencës gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit publik dhe të cilën mund ta quajmë bazë e Ligjit të Prokurimeve Publike të vitit 1998 që ishte edhe ligji i parë mbi Prokurimet Publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.⁵

Edhe pse ligji i vitit 1998 për herë të parë ka arritur të vendosë sistem të procedurës objektive ligjore për zbatimin e prokurimeve publike, përsëri, gjatë zbatimit të tij në praktikë janë vërejtur mangësi dhe dobësi të cilat kryesisht lidhen me zbatimin e pjeshëm të rregullave të tij.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe bashkësisë Evropiane (CCA)⁶, më 9 prill të vitit 2001, Republika Maqedonisë së

⁴Rregullorja për Prokurimet Publike, Neni 1 paragrafi 1, Gazeta Zyrtare e RM nr.18/96.


⁵Gazeta Zyrtare e RM, Nr.26/98, 50/01, 2/02, 24/03

⁶Спогодбата за стабилизација и асоцијација со Европските заедници и нивните земји-членки (ССА) е постојната правна рамка која ги регулира односите на Република Македонија со Европската Унија. Република Македонија е првата земја која потпиша ССА и првата земја во која ССА стапи во сила. ССА

Veriut në bazë të Nenit 68⁷ të Marrëveshjes morri obligimin për harmonizim të një pjese të ligjvënies së brendshme me të drejtën e Bashkimit Evropian. Sipas marrëveshjes, procedurat për Prokurime publike, duhet të zbatohen në bazë të mosdiskriminimit dhe reciprocitetit, sidomos në kuadër të Organizatës tregtare Botërore⁸. Detyrimet të cilat u vendosën me marrëveshjen (CCA), dhe rregullat tjera të Bashkimit Evropian në pjesën e prokurimeve publike, kontribuan që në vitin 2004 të miratohet një ligj i ri mbi prokurimet publike.⁹ Miratimi i këtij ligji e vendoste Maqedoninë e Veriut më afër integriteteve evropiane. Me këtë ligj u vendosën parimet themelore për sigurimin e konkurrencës së barabartë, pozitës së barabartë dhe jodiskriminuese të ofertuesve, transparencës dhe procedurës së hapur (publike) dhe ndalimin e diskriminimit në aspektin e origjinës (prejardhjes) së ofertuesit ose vendit të origjinës së mallrave. Me këtë u krijua pozitë e barabartë e pjesëmarrësve në treg.¹⁰

Në vijim do të paraqesim formimin e Sistemit të Prokurimeve publike.

Figura 1:



беше потпишана на 9 април 2001 година во Луксембург и по нејзината ратификација од сите потписници, стапи во сила на 1 април 2004 година. Но, иако ССА стапи во сила во 2004 година, деловите од ССА кои ги регулираат трговијата и трговските прашања стапија во сила на 1 јуни 2001 година со посебната Времена спогодба за трговија и трговски прашања меѓу Република Македонија и Европската заедница. ССА овозможува рамка за политички дијалог и ја зајакнува регионалната соработка, го унапредува проширувањето на пазарите и економските односи помеѓу страните и ги воспоставува основите за техничката и финансиската помош.

⁷Gazeta zyrtare e R.M nr.28/01

⁸Gazeta zyrtare e R.M nr.28/01.neni 72 pika 1

⁹Gazeta zyrtare e R.M nr..19/04, 109/05.

¹⁰Gazeta zyrtare e R.M nr.19/04, 109/05, neni 6

1.2.Korniza ligjore dhe institucionale e prokurimit publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Në Nëntor të vitit 2007 në kuvendin e RMV, u miratua ligji mbi prokurimet publike në RMV dhe ai filloi të zbatohet më datë 01.01.2008, si edhe aktet nënligjore që u sollën në bazë të këtij ligji. Gjithë këto që u theksuan e përbëjnë Kornizën Ligjore të prokurimeve publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ky ligj ka pësuar ndryshime dhe përmirësime pesëmbëdhjetë herë që nga sjellja e tij deri më sot me qëllim që të arrihet një ligj sa më praktik dhe i standardizuar.¹¹

Sipas direktivave të Bashkimit Evropian mbi prokurimet publike duhej të arrihej mbrojtje ligjore me anë të krijimit të një sistemi të ri që do ta mundësonte të njëjtën, dhe kështu, në bazë të ligjit të ri i cili ishte në përputhje me standardet evropiane, u formua edhe Komisioni Shtetëror i Ankesave për Prokurimin Publik. U vendos një sistem i ri për pragjet e vlerës si dhe procedura më të hapura për prokurimin publik. U vendos për Prokurimet publike elektronike, marrëveshjet kornizë si dhe ankandet elektronike si një mënyrë e veçantë për dhënien e kontratave të prokurimit publik, dhe gjithashtu është parashikuar një kapitull i veçantë që rregullon marrëveshjet e sektorit, tërësisht u rregulluan me anë të ligjit të ri.

Ndryshime më të mëdha të ligjit për prokurime publike u bënë në vitin 2011 në të cilën u korrigjuan disa nene të veçanta të ligjit, disa dispozita të veçanta u sqaruan dhe u vendosën zgjidhje të reja, me të cilat tentohet ndikimi në përmirësimin e cilësisë së procedurave për dhënien e kontratave të prokurimit publik.¹² Komisioni evropian sugjeroi që të bëhet certifikimi i zyrtarëve të prokurimit publik, në mënyrë që të përforcohet kapaciteti administrativ dhe zgjerimi i njohurive të të punësuarve në prokurimet publike. Për këtë arsye edhe me ndryshimet e fundit të ligjit u parapanë të gjitha këto sugjerime. Nga viti 2012 ligji parasheh edhe përdorimin e e-ankandëve (e-aukcia) si dhe nga 01.07.2012 edhe publikimin e detyrueshëm të të gjithë procedurave të prokurimit publik në Sistemin Elektronik për Prokurim Publik, pra edhe procedurat deri në 5000 euro pa TVSH, ku në të kaluarën kjo procedurë nuk ishte e paraparë. E gjithë kjo ka për qëllim zmadhimin e konkurrencës gjatë procedurave të prokurimit publik.

¹¹Gazeta zyrtare e R.M nr.136/2007

¹²Gazeta zyrtare e R.M nr.185/2011

Detyrimi për udhëheqjen e dialogut teknik, gjatë aplikimit të procedurave për dhënien e kontratave të prokurimeve publike të shërbimeve dhe mallrave, me vlerë të mbi 130.000 euro, shpallje e obligueshme e dokumentacionit tenderik në Sistemin Elektronik të Prokurimeve Publike, dhe zvogëlimin e afateve për dhënien e ofertave gjatë procedurave, si mënyrë e veçantë për dhënien e kontratave të prokurimeve publike tek Organet kontraktues (pjesëmarrëse) sektorial, u vendos apo u krijua Sistem Kualifikues, kompetencë e re e Komisionit Shtetëror të Ankesave për Prokurime Publike, që të vendos rreth ankesave dhe procedurave për dhënie të kontratave për koncesione dhe partneritete private-publike.

Shfrytëzimi i teknologjisë informatike paraqet prioritet strategjik të qeverisë së RMV, dhe të Byrosë për Prokurime Publike, me qëllim zvogëlimin e shpenzimeve të procedurave dhe zmadhimin e transparencës dhe konkurrencës.

Ligji për Prokurime Publike në përdorimin e deritanishëm është ndryshuar dhe plotësuar rreth 15 herë, ndërsa me ndryshimin e fundit në vitin 2017 u shfuqizua Këshilli për Prokurime publike, një pjesë e këtyre ndryshimeve u kritikuan nga ana e Komisionit Evropian.

Ne vijim nëpërmjet tabelës do të paraqesim ngjashmëritë dhe ndryshimet e Ligjit të Ri për Prokurime Publike nga ai paraprak.

TABELA 1:

<p>Çka ndryshon Ligji i ri nga ai paraprak?</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dispozitat penale janë fshirë, - Janë vendosur dispozitat për kundërvajtje, - Është vendosur kontrolli paraprak, - Ankandi bëhet fakultativ (opsional), - Ndryshime në kriteret për vlerësim dhe kompetencë, - E-tregu i prokurimeve të vogla publike, - Në përgjithësi thjeshtëzohet procedurat, - Rritja e transparencës është futur në përputhje me udhëzimet e Qeverisë, - Janë futur forma të reja të raportimit, - Pragjet për aplikim janë rritur, - E-mjete të reja të tilla si katalogë elektronike, apel (ankesë) elektronik, sistem dinamik të prokurimit, - Referenca negative zvogëlohet, - Punët dhe shërbimet shtesë nuk janë më pjesë e procedurës, - Dispozitat për realizimin e kontratës, 	<p>Çka mbetet e njëjtë?</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fushëveprimi i autoriteteve kontraktuese, - Shumica e përkufizimeve, - Përrjashtimet nga aplikimi janë të ngjashme, me disa dallime - Rregullat e vlerësimit - Dispozita të ngjashme për planifikimin dhe vendimin për prokurimin publik, - Mënyra e publikimit të shpalljes dhe informimit, - Disponueshmëria e dokumentacionit të tenderit, - Procedura e hapur, procedura e kufizuar, dialogu konkurrues, - Shërbime të veçanta kundër shërbimeve jo prioritare, - Procedurë më e thjeshtë e hapur është e ngjashme me GPP deri në 20,000 euro, - Dialogu teknik, - Dispozitat për dokumentacionin e tenderit
--	--

<ul style="list-style-type: none"> - Dispozitat në lidhje me ligjin e ri për prokurimin në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, - Përgjegjësitë e reja të KSHAPP, - Afatet e detajuara për ankesat për procedurat e dukshme, - Kontratat e rezervuara - Paraqitja e një mendimi paraprak për një procedurë të negociuar - Procedura të reja, - Dispozita për nënkontraktorët dhe përkrahje nga një subjekt tjetër. 	<p>dhe specififikimet teknike</p> <ul style="list-style-type: none"> - ngjashmëri në kriterin e vlerësimit - ngjashmëri në kriteret e aftësisë - Garancitë dhe një deklaratë serioze të ofertës, - Hapja e ofertave.
---	--

Edhe në vitin 2018 u paraqit nevoja për përpilimin e Ligjit të ri të Prokurimit publik dhe prandaj filluan edhe procedurat për përgatitjen e tij, u kryen konsultime intensive për zgjidhje të caktuara të cilat i propozoi Byroja për Prokurime Publike

BJN që prej disa vitesh jep vërejtje për një zgjidhje ligjore të re. Arsyet kryesore për përpilimin e ligjit të ri i cili hyn në fuqi me 1.04.2019 janë:

- Direktivat e reja për Prokurime Publike,
- Obligimi për të qenë pajtueshmëri me to,
- Largimi i dobësive të cilat u vërejtën, sidomos ndërlíkueshmëria e tepërt të procedurave.

1.2.1. Parimet themelore

“Gjatë dhënies së kontratave të prokurimit publik, Organet kontraktuese janë të detyruara të respektojnë parimet bazë, d.m.th. të sigurojnë:

- konkurrenca midis operatorëve ekonomikë,
- trajtimi i barabartë dhe mosdiskriminimi i operatorëve ekonomikë,
- transparencën dhe integritetin në procesin e dhënies së kontratave të prokurimeve publike,
- Shfrytëzimi racional dhe efikas i fondeve në procedurat për dhënien e kontratave të prokurimit publik.

Këto parime rrjedhin nga ligji i BE-së, d.m.th. Traktati i Romës dhe Direktivat e BE-së për Prokurimet Publike. Respektimi i këtyre parimeve duhet të çojë deri në krijimin e sistemit të prokurimit publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i cili do ta mundësojë atë duke

respektuar të drejtat dhe detyrimet e të gjithë pjesëmarrësve në procedurat e dhënies së kontratave të prokurimit publik, si dhe kontroll efikas të procedurave të zbatuara.

Në thelb, çdo vend që pretendon të krijojë një mënyrë transparente, efikase dhe sistem funksional të prokurimeve publike duhet të përcaktojë në ligjet e tij kombëtare këto parime dhe duhet ti zbatojë në procedurat për dhënien e kontratave të prokurimit publik.”¹³

1.2.2. Përfashtime të përgjithshme

Përfashtimet e përgjithshme nga zbatimi i Ligjit për Prokurimin Publik rregullohen me nenet 6 deri 11 të Ligjit dhe ato zbatohen për Organet kontraktuese në sektorin klasik, kurse përfashtimet e veçanta nga zbatimi i Ligjit për Prokurim Publik kanë të bëjnë vetëm me kontratat sektoriale. Organet sektoriale kontraktuese kanë të drejtë të përdorin përfashtimet e përgjithshme nga zbatimi i Ligjit për Prokurim Publik.¹⁴

1.2.3. Planifikimi i prokurimeve publike

Planifikimi i prokurimeve publike mund të përkufizohet si proces i parashikimit të nevojës për prokurim të mallrave, shërbimeve dhe punëve gjatë vitit për të plotësuar nevojat e Organeve kontraktuese. Ky proces është me rëndësi të madhe për zbatimin e duhur të Ligjit për Prokurim Publik dhe çdo mosveprim në planifikimin e nevojave mund të shkaktojë vështirësi për Organet kontraktuese. Për të siguruar planifikimin e duhur të nevojave të tyre, Organet kontraktuese paraprakisht duhet të zhvillojnë strategjinë e tyre të blerjes. Strategjia e blerjes përbëhet nga tri pjesë: Vlerësimi i përvojës së kaluar me blerjet; vlerësimi i tregut dhe zhvillimi i udhëzimeve bazuar në rezultatet e arritura.¹⁵

¹³Аргировски, А., Глигоријевска, Р., Мацевска – Сараќинчева, А., Папеш, Г., Данаилов, Д., Каракашова Шулев, Б., Трајковиќ, М., Герлек, Е., Дониновска Сусинов,Ф.,Прирачник за јавни набавки Четврто издание Биро за јавни набавки сектор за нормативна дејност, обуки и меѓународни односи (електронско издание) Скопје 2017, fq 28.

¹⁴Ligji për prokurime publike neni 6,7,8,9,10,11,12 (Gazeta zyrtare nr 136/07, 130/2008, 97/2010, 53/2011, 24/2012, 15/2013, 185/2011,15/2013, 148/2013, 160/2013, 28/2014, 43/2014, 130/2014, 180/2014, 78/2015, 192/2015, 27/2016, 120/2016, 165/2017,83/2018)

¹⁵Богева Мицовска, М., Јованоска, М., Аргировски, А., Глигоријевска, Р., Примена на Законот за Јавни Набавки во Пракса II издание, Здружение на финансиски работници на локалните самоуправи и јавните претпријатија- Велес, Скопје 2012 fq.95.

Gjatë përgatitjes së strategjisë së prokurimit, Organet kontraktuese duhet të kenë parasysh përvojën me blerje të ngjashme që i kanë realizuar në të kaluarën. Organet kontraktuese duhet të përshkruajnë në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe pa mëdyshje subjektin e prokurimit, me qëllim që operatorët ekonomik të mund të dorëzojnë oferta të pranueshme, në pajtim me nenin 3 pika 24 të Ligjit.¹⁶

Autoriteti kontraktues është i detyruar të miratojë planin për nevojat e përgjithshme të prokurimit për vitin aktual, deri në fund të janarit të atij viti. Plani i prokurimit publik gjatë vitit mund të ndryshohet dhe plotësohet në përputhje me fondet e planifikuara dhe të siguruar për prokurimin publik.

Në planin vjetor për prokurimin publik, Organet kontraktuese përcaktojnë lëndën e kontratës së prokurimit publik sipas llojit të mallrave, shërbimeve dhe punëve, planifikojnë periudhën e fillimit të procedurës së prokurimit publik, vlerën e parashikuar të kontratës së prokurimit publik pa TVSH dhe llojin e procedurës që do të zbatohet për dhënien e kontratës së prokurimit publik.¹⁷

Nëpërmjet tabelës do të paraqesim procedurat e dhënies së kontratave sipas ligjit të vjetër dhe ligjit i cili pritet të hyjë në fuqi më 1.4.2019.

Tabela 2.

Ligji për Prokurimin Publik për dhënien e kontratave të prokurimit publik parashikon procedurat e mëposhtme	Ligji i ri për dhënien e kontratave të prokurimit publik i cili duhet të hyjë në fuqi në 2019, parashikon procedurat e mëposhtme
1. Procedura e hapur - procedura e rregullt (open procedure)	1. procedurë e hapur;
2. Procedura e kufizuar - procedura e rregullt (restricted procedure);	2. Procedurë e kufizuar;
	3. Dialogun konkurrues;
	4. Partneritet për inovacione (e re)

¹⁶Аргировски, А., Глигоријевска, Р., Мацевска – Сараќинчева, А., Папеш, Г., Данаилов, Д., Каракашова Шулев, Б., Трајковиќ, М., Герлек, Е., Дониновска Сусинов, Ф., Прирачник за јавни набавки Четврто издание Биро за јавни набавки сектор за нормативна дејност, обуки и меѓународни односи (електронско издание) Скопје 2017, fq.47.

¹⁷Аргировски, А., Глигоријевска, Р., Мацевска – Сараќинчева, А., Папеш, Г., Данаилов, Д., Каракашова Шулев, Б., Трајковиќ, М., Герлек, Е., Дониновска Сусинов, Ф., Прирачник за јавни набавки Четврто издание Биро за јавни набавки сектор за нормативна дејност, обуки и меѓународни односи (електронско издание) Скопје 2017, fq.45

3. Kërkesa për mbledhjen e ofertave - kombëtare dhe thjeshtuar (simplified competitive procedure)	5. Procedura konkurrenente me negociata (e re);
4. Procedurë e negociuar me publikim paraprak të një njoftimi (shpallje) (negotiated procedure with prior publication of a contract notice)	6. Procedurë negocimesh me shpallje të një njoftimi
5. Procedura e negociuar pa publikim paraprak të një njoftimi (negotiated procedure without prior publication of a contract notice)	7. Procedurë negocimesh pa shpallje të një njoftimi;
6. Dialogu konkurrues - procedurë e jashtëzakonshme (competitive dialogue) dhe	8. Procedurë e hapur më e thjeshtëzuar (e re); dhe
7. Konkurs për zgjedhjen e projektit ideor (idejno resenie)	9. Blerje me vlerë të ulët

Në tabelë kemi cekur procedurat e dhënies së kontratave me ligjin e tanishëm për Prokurim Publik dhe ndryshimet që do të jenë në ligjin e ri që do të hyjë në fuqi më 1.04.2019 i cili është plotësisht në përputhje me Direktivat e BE-së.

1.3.Hulumtime për rregullimin ligjor dhe mbrojtjen ligjore të prokurimeve publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Republika e Maqedonisë së Veriut si shtet-aspirant për bashkëngjitje në familjen e shteteve të Bashkimit Evropian, bëri harmonizim të legjislacionit të saj në Prokurimet Publike me standardet e BE-së dhe gjithë dokumentacionin e vet në këtë sferë e përshtati me kushtet dhe kërkesat fundamentale ekonomike, të vendosura nga ana e saj. Kjo u bë kur u soll ligji i ri për prokurimet publike në vitin 2007, dhe hyri në fuqi më 1 janar 2008. Përveç kësaj, janë miratuar aktet nënligjore të nevojshme.¹⁸

¹⁸Аргировски,А., Глигоријевска,Р., Мацевска – Сараќинчева,А., Палеш, Г., Данаилов,Д., Каракашова Шулев,Б., Трајковиќ,М., Ѓерлек,Е., Дониновска Сусинов,Ф.,Прирачник за јавни набавки Четврто изданиеБиро за јавни набавки сектор за нормативна дејност, обуки и меѓународни односи (електронско издание) Скопје 2017, fq 14.

“Ligji për Prokurimin Publik zbatohet vetëm për subjektet që janë përcaktuar si Organe kontraktuese, ku bëjnë pjesë: Organet shtetërore, Organet e njësisve për vetëqeverisje lokale dhe të Qytetit të Shkupit, subjektet juridike të themeluara me një qëllim të veçantë për përmbushjen e nevojave të interesit publik dhe të cilat kryesisht financohen nga këto autoritete kontraktuese, ose që janë subjekt i kontrollit të operacioneve të OK, ose në të cilën shumica e gjysmës së anëtarëve të Bordit të Drejtorëve (BD) ose bordi mbikëqyrës (BM) janë emëruar nga Organet Kontraktues. Gjithashtu ligji në fjalë vlen edhe për prokurimet e kryera nga ndërmarrjet publike, kompanitë aksionare dhe kompanitë me përgjegjësi të kufizuar, në të cilët organet shtetërore kanë ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi pronësinë mbi to, respektivisht që zotërojnë shumicën e kapitalit të kompanisë, kanë shumicën e votave të aksionarëve ose emërojnë më shumë se gjysmën e anëtarëve të Bordit Drejtues ose të BM, si dhe çdo person juridik i bazuar në të drejtën speciale ose ekskluzive në rastet kur ai jep kontrata publike ose përfundon marrëveshjet kornizë në mënyrë që të kryejnë aktivitetet përkatëse.”¹⁹

1.3.1. Byroja e Prokurimeve Publike

“Byroja e Prokurimeve Publike (PPB) si një institucion përgjegjës për zhvillimin e sistemit të prokurimit publik, si dhe sigurimin e racionalitetit, efikasitetit dhe transparencës në zbatimin e prokurimit publik është themeluar në vitin 2004 me Ligjin për Prokurim Publik (“Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 19/04).

Nga viti 2004 deri më 1 shtator 2009, Byroja ishte pjesë e Ministrisë për Financa si autoritet në përbërje (pjesëmarrës) pa statusin e personit juridik. Nga 1 shtatori 2009, në pajtim me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurim Publik (“Gazeta Zyrtare e RM”, nr. 130/08), Byroja fitoi statusin e një subjekti juridik, por mbeti nën kompetencë të Ministrisë së Financave.”²⁰

¹⁹Ligji për prokurime publike neni 4 (Gazeta zyrtare nr 136/07, 130/2008, 97/2010, 53/2011, 24/2012, 15/2013, 185/2011,15/2013, 148/2013, 160/2013, 28/2014, 43/2014, 130/2014, 180/2014, 78/2015, 192/2015, 27/2016, 120/2016, 165/2017,83/2018)

²⁰Аргировски,А., Глигоријевска,Р., Мацевска – Сараќинчева,А., Папеш, Г., Данаилов,Д., Каракашова Шулев,Б., Трајковиќ,М., Ѓерлек,Е., Дониновска Сусинов,Ф.,Прирачник за јавни набавки Четврто изданиеБиро за јавни набавки сектор за нормативна дејност, обуки и меѓународни односи (електронско издание) Скопје 2017, fq 15.

1.3.2. Komisioni Shtetëror i Ankesave për Prokurimin Publik

“Komisioni Shtetëror i Ankesave për Prokurimin Publik (DKZJN), është përgjegjës për zgjidhjen e ankesave në procedurat për dhënien e kontratave të prokurimit publik, pas ankesave në procedurat për dhënien e kontratave të koncesionit dhe partneriteteve publike-private. Komisioni Shtetëror i Ankesave është një organ i pavarur shtetëror me kapacitetin e një personi juridik dhe siguron mbrojtje ligjore bazuar në parimet e ligjshmërisë, efikasitetit dhe kosto-efektivitetit të procedurës. Roli i Komisionit Shtetëror të Ankesave është veçanërisht i rëndësishëm për funksionimin e duhur të mbrojtjes ligjore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Gjegjësisht, me punën e tij, Komisioni Shtetëror jo vetëm që mbron interesat ligjore të operatorëve ekonomik të cilët kanë vuajtur ose mund të pësojnë dëm nga një shkelje e mundshme e dispozitave të ligjit, por gjithashtu kontrollon procedurat e kryera nga organet kontraktuese, d.m.th. kontrollon nëse janë bërë shkelje të rëndësishme të ligjit. Procedura e mbrojtjes ligjore mund të iniciohet nga çdo operator ekonomik cili ka interes ligjor në marrjen e një kontrate të prokurimit publik dhe që ka ose mund të ketë pësuar dëmtime nga shkeljet e mundshme të dispozitave të Aktit. Mbrojtja ligjore mund të kërkohej kundër vendimeve, veprimeve dhe dështimit për të ndërmarrë veprime nga Organet kontraktuese në procedurën për dhënien e kontratës së prokurimit publik, dhe Komisioni Shtetëror duhet të vendosë për ligjshmërinë e të njëjtit.”²¹

Në vijim do të paraqesim të dhënat e komisionit shtetëror për prokurime publike në vitin 2017.

Tabela 3:

Sipas të dhënave të Komisionit Shtetëror në vitin 2017²²	Numri
Numri i lëndëve të mbërritura dhe të regjistruara është	561
Nga të cilat raste të zgjidhura	548
Ankesa nga O.K kundër një vendimi të lëshuar nga këshilli i prokurimit publik	30

²¹Аргировски, А., Глигоријеvsка, Р., Мацевска – Сараќинчева, А., Папеш, Г., Данаилов, Д., Каракашова Шулев, Б., Трајковиќ, М., Герлек, Е., Дониновска Сусинов, Ф., Прирачник за јавни набавки Четврто издание Биро за јавни набавки сектор за нормативна дејност, обуки и меѓународни односи (електронско издание) Скопје 2017, fq 25.

²²Извештај за активностите за Бирото за јавни набавки во функционирањето на системот за јавните набавки, Скопје јуни 2018, fq. 23.

Padi kundër vendimeve të miratuara nga Komisioni Shtetëror deri te Gjykata Administrative	86
Rastet e pazgjidhura	13

“Gjithashtu Komisioni shënon një trend të uljes së numrit të lëndëve të pazgjidhura. Në kategorinë e lëndëve të pazgjidhura në vitin 2017, numri është 13 lëndë, në krahasim me vitet 2016 dhe 2015, kur numri i lëndëve ishte 17, respektivisht 16. Gjithashtu, sipas të dhënave nga Komisioni Shtetëror i Ankesave për Prokurimin Publik, gjithsej 7 kërkesa për vazhdimin e procedurës janë dorëzuar në vitin 2017. Nga kjo shifër, 7 kërkesa janë refuzuar, dhe asnjë kërkesë nuk është pranuar.”²³

1.3.3 Të drejtë ankese deri(DKZJN)

Çdo operator ekonomik i cili ka interes ekonomik për fitimin e marrëveshjes për furnizim publik dhe i cili ka pësuar ose do të mund të pësojë dëm nga shkelja eventuale e dispozitave të këtij ligji, mund të kërkojë mbrojtje juridike kundër vendimeve, veprimeve ose lëshimeve për ndërmarrjen e veprimeve nga ana e Organeve kontraktuese në procedurën e ndarjes së marrëveshjes për furnizim publik. Mbrojtje juridike mund të kërkoj edhe Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, kur i mbron interesat e shtetit ose interesin publik.²⁴

1.3.3. Gjykata Administrative e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Gjykata Administrative e Republikës së Maqedonisë së Veriut është kompetente për të vendosur mbi paditë e ngritura nga palët që nuk janë të kënaqura me vendimet e Komisionit Shtetëror të Ankesave për Prokurimin Publik. Duke pasur parasysh këtë kompetencë, ky institucion ka

²³Извештај за активностите за Бирото за јавни набавки во функционирањето на системот за јавните набавки, Скопје јуни 2018, fq 24,25.

²⁴Ligji për prokurim publike neni 207("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 136/2007; 130/2008, 97/2010, 53/2011, 185/2011, 15/2013, 148/2013, 160/2013, 28/2014, 43/2014, 130/2014, 180/2014, 78/2015, 192/2015, 27/2016, 120/2016, 165/2017 dhe 83/2018)

rëndësi të madhe në pjesën e mbrojtjes ligjore në procedurat për dhënien e kontratave të prokurimit publik.²⁵

1.3.4. Gjykata e Lartë Administrative

“Kundër vendimeve të Gjykatës Administrative mund të bëhet një mjet i rregullt ligjor - një ankesë në Gjykatën e Lartë Administrative brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit. Duhet të merret në konsideratë se kundër vendimit të Gjykatës së Lartë Administrative nuk mund të ushtrohet mjet i rregullt ligjor, por një zgjidhje e jashtëzakonshme mund të paraqitet në Gjykatën Supreme (kërkesa për përsëritjen e procedurës dhe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë).”²⁶

“Sipas të dhënave nga Gjykata e Lartë Administrative në vitin 2017, në GjLA janë pranuar 14 lëndë për prokurime publike nga të cilat 12 janë ankesa administrative ndërsa 2 janë ankesa administrative me masa të përkohshme. Në 8 lëndë është vendosur të refuzohen ankesat ndërsa dy janë hedhur dhe dy janë pranuar.”²⁷

1.3.5. Enti Shtetëror i Revizionit në kontrollin e ligjshmërisë së procedurës

“Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) është institucioni suprem i revizionit në Republikëne Maqedonisë së Veriut, qëllimi i së cilës është të informojë Kuvendin e Republikës në mënyrë të duhur dhe në kohë, Qeverinë dhe bartësit tjerë të funksioneve publike për gjetjet e revizionit të zbatuar. ESHR mbështet Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në zbatimin e kompetencave të tij përmes identifikimit dhe zbulimit të parregullsive në rastet e trajtimit të paligjshëm dhe rastet e mundshme të korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës zyrtare. Nëpërmjet rekomandimeve të ofruara nga ana e Entit Shtetëror për Revizion jep mbështetje për institucionet shtetërore dhe përdoruesit e fondeve publike në mënyrë që të përmirësoj menaxhimin e tyre. Enti

²⁵Извештај за активностите за Бирото за јавни набавки во функционирањето на системот за јавните набавки
Извештај за активностите за Бирото за јавни набавки, Скопје јуни 2018, fq 26.

²⁶Аргировски, А., Глигоријеvsка, Р., Мацевска – Сараќинчева, А., Папеш, Г., Данаилов, Д., Каракашова
Шулев, Б., Трајковиќ, М., Герлек, Е., Дониновска Сусинов, Ф., Прирачник за јавни набавки Четврто
издание Биро за јавни набавки сектор за нормативна дејност, обуки и меѓународни односи (електронско
издание) Скопје 2017, fq. 27

²⁷Извештај за активностите за Бирото за јавни набавки во функционирањето на системот за јавните набавки
Извештај за активностите за Бирото за јавни набавки, Скопје јуни 2018, fq 28.

Shtetëror i Revizionit kryen revizion të rregullsisë dhe revizion të performancës. Kryerja e një revizioni të rregullsisë, përveç pjesës tjetër, ekzaminimi dhe vlerësimi i përdorimit të fondeve kryhet në përputhje me rregullat ligjore, d.m.th. inspektohet mënyra e planifikimit, zbatimit dhe realizimit të procedurave të prokurimit publik të kryera në periudhën për të cilën zbatohet revizioni.”²⁸

1.3.6. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit

“Gjatë vitit 2017, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit ka vepruar në gjithsej 7 raste të paraqitura për korrupsion të mundshëm në fushën e prokurimit publik, lidhur me procedurat për dhënien e marrëveshjeve për prokurime publike të cilat janë zbatuar nga Organet kontraktuese.

Duke vepruar në përputhje me kompetencat e miratuara në ligjin kundër korrupsionit, pas mbledhjes së informatave relevante nga institucionet tjera me qëllim të përcaktimit të gjendjes faktike dhe verifikimit të pretendimeve për rastet e paraqitura.

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në shtatë rastet e paraqitura ka arritur në përfundimin se pretendimet e përfshira në rastet e paraqitura nuk janë konfirmuar dhe vendosën se nuk ka elemente për përcaktimin e mëtejshëm të rasteve konkrete.

Nëse krahasojmë vitet e mëparshme (2012, 2013, 2014 dhe 2015), mund të përfundojmë se ka një tendencë të vazhdueshme të reduktimit të rasteve krahasuar me periudhën e mëparshme (në vitin 2011 ka pasur deri në 45 raporte). Në vitin 2013, vetëm 14 raporte, në vitin 2014, kanë dorëzuar 25 raporte, në vitin 2015, gjithsej 10 raporte janë dorëzuar, ndërsa në vitin 2016 janë dorëzuar vetëm 3 raporte për korrupsion të dyshuar në prokurimet publike, ndërsa në vitin 2017 ka shtatë raporte të paraqitura.”²⁹

²⁸Аргировски, А., Глигоријевска, Р., Маџевска – Сараќинчева, А., Папеш, Г., Данаилов, Д., Каракашова Шулев, Б., Трајковиќ, М., Герлек, Е., Дониновска Сусинов, Ф., Прирачник за јавни набавки Четврто издание Биро за јавни набавки сектор за нормативна дејност, обуки и меѓународни односи (електронско издание) Скопје 2017, fq. 25

²⁹Извештај за активностите за Бирото за јавни набавки во функционирањето на системот за јавните набавки Извештај за активностите за Бирото за јавни набавки, Скопје јуни 2018, fq 30.

1.3.7. Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës

Konkurrenca e lirë është me rëndësi të veçantë për të gjitha vendet, ekonomitë e të cilave janë të bazuara në parimet e tregut të lirë, ku shpërndarja e mediumit është rezultat i marrëdhënieve të ofertës dhe kërkesës në treg.

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës nga viti 2012 ka prezantuar një risi që ndalon marrëveshjet ndërmjet ndërmarrjeve gjatë dorëzimit të tenderëve në procedurat e prokurimit publik: kjo është veçanërisht e vërtetë nëse konsiderohet që në vitin 2015 dhe 2016 Komisioni nuk ka vërejtur shkelje në lidhje me konkurrencën në prokurimin publik. Në krahasim me të dhënat e marra nga vitet 2015 dhe 2016, në vitin 2017 Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës ka vërejtur një shkelje ku ka zbuluar një marrëveshje në mes ndërmarrjeve gjatë dorëzimit të ofertës në një procedurë për lidhje të marrëveshjes për prokurime publike. Për shkeljen e vërejtur u është shqiptuar një gjobë e përshtatshme.³⁰

1.4. Legjislacioni i Bashkimit Evropian

1.4.1. Korniza ligjore e BE-së në fushën e prokurimit publik

Kuadri ligjor primar (korniza ligjore primare e BE-së)

“Burimet primare të së drejtës së BE-së nuk përmbajnë rregulla specifike për prokurimin publik, por parimet bazë të cilat burojnë nga parimet e përgjithshme të aplikimit në të cilat bazohet tregu i brendshëm janë: Lëvizja e lirë e mallrave, Liria e themelimit, Liria për të ofruar shërbime, Ndalimi i çdo lloj diskriminimi në bazë të kombësisë, Konkurrenca e tregut.

Korniza ligjore e dytë përbëhet nga direktiva dhe rregullore:

- Direktiva 2004/18/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 31 mars 2004, për koordinimin e procedurave për dhënie të kontratave të punëve publike, kontratat për prokurimin publik të mallrave dhe kontratat të shërbimit publik;³¹

³⁰Извештај за активностите за Бирото за јавни набавки во функционирањето на системот за јавните набавки, Скопје јуни 2018, fq 31,32.

³¹Me Direktivën 2014/24/EU për prokurime publike nga 18 prilli 2016, u shfuqizua Direktiva 2004/18/EU

- Direktiva 2004/17/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 31 mars 2004, për koordinimin e procedurave të prokurimit publik të subjekteve që veprojnë në sektorët ujë, energji, transport dhe shërbime postare;³²
- Direktiva 2014/24/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 26 Shkurtit 2014 mbi prokurimin publik dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/18/KE³³
- Direktiva 2014/25/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 26 Shkurtit 2014, për prokurimet publike të kryera nga subjektet që veprojnë në sektorët e furnizimit me ujë, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare;
- Direktiva 2014/23/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 26 Shkurtit 2014 mbi dhënien e kontratave të koncesionit;
- Direktiva e Këshillit 89/665/EEC e 21 dhjetorit 1989, për harmonizimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative që lidhen me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të prokurimit publik dhe punëve publike;
- Direktiva 2007/66/EK e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 dhjetor 2007, që ndryshon Direktivën e Këshillit 89/665/EEC dhe 92/13/EEC, lidhur me përmirësimin e efektivitetit të procedurave të rishikimit në lidhje me dhënien e prokurimeve publike;
- Direktiva 2009/81/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 korrik 2009 mbi harmonizimin e kontratave të caktuara të furnizimit, mallrat dhe shërbimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë të lidhura nga organet kontraktuese dhe ndryshimin e Direktivave 2004/17 / EC dhe 2004/18 / EC;
- Direktiva 2009/33/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 prillit 2009 për promovimin e automjeteve të pastra dhe efikase në transportin rrugor;
- Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 2151/2003 të 16 dhjetorit 2003me të cilën ndryshohet Rregullorja (KE) nr. 2195/2002 e Parlamentit Evropian dhe i Këshillit të Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (CPV);

³²Me Direktivën 2014/25/EU për prokurime të subjekteve që veprojnë në sektorët e ujit, energji, transport dhe shërbime postare nga 18 prilli 2016,ushfuqizuaDirektiva 2004/17/EU.

³³Me Direktivën 2014/25/EU u shfuqizua Direktiva 2004/17/E3 e Parlamentit të Evropës dhe Këshillit nga 31 marsi 2004. Për koordinim të procedurave për prokurim të subjekteve që veprojnë në sektorët e ujit, energji, transport dhe shërbime postare.

- Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 1564/2005 të datës 7 shtator 2005i cili përcakton format standarde për publikimin e njoftimeve në kuadër të procedurave të prokurimit publik, në përputhje me Direktivën 2004/17 / EC dhe 2004/18 / EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit;
- Rregullorja (KE) nr. 1422/2007 të Komisionit Evropian të datës 4 dhjetor 2007, për ndryshimin dhe plotësimin e Direktivave 2004/17 / EC dhe 2004/18 / EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit lidhur me zbatimin e pragjeve dhe zbatimin e procedurave për dhënien e kontratave të prokurimit publik dhe Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 213/2008 të datës 28 nëntor 2007, për ndryshimin e Rregullores (KE) nr. 2195/2002 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit (FPP) dhe Direktivat 2004/17 / EC dhe 2004/18 / EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillin mbi procedurat për dhënien e kontratave të prokurimit publik (Rregullorja zbatohet nga Shtetet Anëtare të BE-së - nga 15 shtatori 2008).

Edhe pse Republika e Maqedonisë së Veriut nuk është shtet anëtar i BE, megjithatë, në bazë të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimitka një detyrim për të harmonizuar legjislacionin kombëtar të Bashkimit Evropian. Kjo do të thotë që rregulloret e BE-së në lidhje me prokurimin publik duhet të ndiqen në mënyrë të përhershmedhe të zbatohet në nivel kombëtar legjislacioni, i cili është një nga kompetencat e Byrosë së Prokurimit Publik.

Kuadri ligjor i BE-së në fushën e prokurimit publik është në dispozicion në faqen e internetit:

<http://eur-lex.europa.eu/en/index.htm>. Direktivat dhe rregulloret e tjera publikohen në të gjitha gjuhët zyrtare të BE-së, që do të thotë se pas pranimit të Republikës së Maqedonisë së veriut në rregulloret ligjore të BE-së do të jetë në dispozicion edhe në gjuhën maqedonase.”³⁴

³⁴Аргировски, А., Глигоријевска, Р., Мацевска – Сараќинчева, А., Папеш, Г., Данаилов, Д., Каракашова Шулев, Б., Трајковиќ, М., Герлек, Е., Дониновска Сусинов, Ф., Прирачник за јавни набавки Четврто издание Биро за јавни набавки сектор за нормативна дејност, обуки и меѓународни односи (електронско издание) Скопје 2017, fq.9,10,11.

KAPITULLI I DYTË

2. Fazat dhe llojet e procedurave të prokurimit publik

2.1. Pragjet financiare në prokurimin publik

“Dispozitat e këtij ligji zbatohen në procedurat për prokurime publike dhe në konkurset për zgjedhjen e zgjidhjes ideore vlera e përcaktuar e së cilës pa tatimin e vlerës së shtuar (në tekstin e mëtejshëm: TVSH) është e barabartë ose më e madhe se: a) në sektorin publik klasik: - 1.000 euro në kundërvlerë me denarë për mallra ose shërbime ose për konkurs për zgjedhjen e zgjidhjes ideore: - 5.000 euro në kundërvlerë me denarë për punë dhe- 10.000 euro në kundërvlerë me denarë për shërbime të veçanta. b) në veprimtaritë e sektorit: - 2.000 euro në kundërvlerë me denarë për mallra ose shërbime ose për konkurs për zgjedhje të zgjidhjes ideore tek organe kontraktuese nga neni 9 paragrafi (1) pika g) të këtij ligji; - 10.000 euro në kundërvlerë me denarë për punë tek organet kontraktuese të nenit 9 paragrafi (1) pika g) e këtij ligji; - 20.000 euro në kundërvlerë me denarë për shërbime të veçanta, përveç shërbimeve të përfshira me shifrën nga LPNFP 79713000-5 tek organet kontraktuese të nenit 9 paragrafi (1) pika g) të këtij ligji; - 400.000 euro në kundërvlerë me denarë për mallra ose shërbime ose për konkurs për zgjedhje të zgjidhjes ideore tek organet kontraktuese nga neni 9 paragrafi (1) pika d) të këtij ligji; - 5.000.000 euro në kundërvlerë me denarë për punë tek organet kontraktuese të nenit 9 paragrafi (1) pika d) dhe - 1.000.000 euro në kundërvlerë me denarë për punë tek organe kontraktuese të nenit 9 paragrafi (1) pika d) e këtij ligji. Organi kontraktues nuk guxon të përdorë metoda për llogaritjen e vlerës së përcaktuar të marrëveshjeve për marrjen e vlerës më të ulët nga vlera reale e prokurimit, me qëllim që të shmangët ndonjë procedurë e përcaktuar me këtë ligj. Organi kontraktues nuk guxon të kryejë ndarje të prokurimeve në më shumë prokurime të veçanta me vlerë më të ulët me qëllim të shmangies së zbatimit të këtij ligji. Në rast të nevojës për prokurim për të cilën tashmë është zbatuar procedurë për prokurim publik në vitin rrjedhës, e që nuk ka mundur të parashihet në momentin e zbatimit të saj, organi kontraktues e merr parasysh vlerën e plotë të përcaktuar të nevojës përkatëse gjatë zgjedhjes së llojit të procedurës.

Prokurimet me vlerë nën pragjet vlerësuese nga paragrafi (1) i këtij neni, organi kontraktues nga neni 9 paragrafi (1) pika a), b), c) dhe ç) të këtij ligji i vendos në evidencën e tremujorit e cila është publikisht e arritshme SEPP. Vlera e plotë e prokurimeve nën pragjet vlerësuese të paragrafit (1) të këtij neni tek organet kontraktuese të nenit 9 paragrafi (1) pikat a), b) dhe c) të këtij ligji nuk guxon të tejkalojë 12.000 euro në kundërvlerë me denarë në vitin rrjedhës, derisa tek organet kontraktuese të nenit 9 paragrafi (1) pika ç) e këtij ligji 24.000 euro në kundërvlerë me denarë në vitin rrjedhës.”³⁵

2.2. Fazat në prokurimin publik

“Me vendim përcaktohet lënda (lloji) dhe sasia e furnizimit, shuma dhe burimi i mjeteve të nevojshme për realizimin e marrëveshjes, mënyra dhe procedura për ndarjen e marrëveshjes për furnizim publik, dhe caktohen kryetari dhe anëtarët e komisionit për furnizim publik, numri i tyre dhe i zëvendësve të tyre (në tekstin e mëtejshëm: komisioni), si dhe angazhimi i personave të jashtëm profesionalë, nëse është e nevojshme.”³⁶ Të gjitha prokurimet publike të kryera nga një institucion duhet të parashihen në planin vjetor të prokurimit publik, të cilat duhet të miratohen dhe miratohen në fillim të vitit më së voni deri në fund të janarit.

Plani specifikon “Në bazë të burimeve të përcaktuara për financim, organi kontraktues e miraton planin për nevojat e veta të përgjithshme për prokurime në vitin rrjedhës sipas llojeve të mallrave, shërbimeve dhe punëve, sipas Listës së përgjithshme emërore për prokurime publike, me të cilin e cakton edhe fillimin e pritur të procedurës, vlerën e përcaktuar të marrëveshjes dhe llojin e procedurës për ndarjen e marrëveshjes. Nevojat e përgjithshme i përfshijnë edhe nevojat që realizohen si prokurime në grup apo nëpërmjet trupit qendror për prokurime.”³⁷

³⁵Ligji për prokurime publike neni 40 (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 24/2019)

³⁶Ligji për prokurime publike neni 28 (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 136/07, 130/2008, 97/2010, 53/2011, 24/2012, 15/2013, 185/2011, 15/2013, 148/2013, 160/2013, 28/2014, 43/2014, 130/2014, 180/2014, 78/2015, 192/2015, 27/2016, 120/2016, 165/2017, 83/2018).

³⁷Ligji për prokurime publike neni 26 (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 136/07, 130/2008, 97/2010, 53/2011, 24/2012, 15/2013, 185/2011, 15/2013, 148/2013, 160/2013, 28/2014, 43/2014, 130/2014, 180/2014, 78/2015, 192/2015, 27/2016, 120/2016, 165/2017, 83/2018).

2.3. Përzgjedhja e ofertës më të favorshme

“Organi kontraktues e zgjedh ofertën më të volitshme, për çka merr vendim, në bazë të kriterit për ndarjen e marrëveshjes të përcaktuar në shpallje për ndarjen e marrëveshjes për furnizim publik dhe në dokumentacionin tender, nëse ofertuesi oferta e të cilit është më e volitshme i plotëson kriteret e caktuara për përcaktimin e aftësisë.

Organi kontraktues është i obliguar që të marrë vendim për zgjedhje ose për prishje të procedurës në afat i cili nuk është më i gjatë se afati për parashtrimin e ofertave, përkatësisht fletëparaqitjeve për pjesëmarrje në procedurën konkrete, duke llogaritur nga dita e përcaktuar si afat i fundit për parashtrimin e ofertave, përkatësisht fletëparaqitjeve për pjesëmarrje.”³⁸

2.4. Lidhja e Marrëveshjes

“Palët kontraktuese lidhin marrëveshje për prokurim publik ose marrëveshje kornizë me shkrim në suaza të afatit të vlefshmërisë së ofertës më të volitshme, por jo më vonë se 30 ditë nga dita e finalizimit të vendimit për zgjedhje.

Marrëveshja për prokurim publik ose kontrata kornizë lidhet në pajtim me kushtet e caktuara në dokumentacionin e tenderit dhe ofertës.

Në rast të marrëveshjes kornizë me më shumë operatorë ekonomik, organi kontraktues lidh marrëveshje kornizë me të gjithë operatorët ekonomik ose kontrata të veçanta kornizë me secilin operator ekonomik veçmas.

Marrëveshja individuale në bazë të marrëveshjes kornizë lidhet me shkrim, kurse efekt të marrëveshjes mund të kenë edhe porosia, urdhëresa, kontrata dhe ngjashëm nëse i përmbajnë të gjitha elementet thelbësore të marrëveshjes.”³⁹

Në vijim do të paraqesim llojet e procedurave dhe kontratat e përgjithshme për vitin 2018 dhe vlera.

³⁸Ligji për prokurim publike neni 116 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.24/2019)

³⁹Ligji për prokurim publike neni 165 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 136/2007; 130/2008, 97/2010, 53/2011, 185/2011, 15/2013, 148/2013, 160/2013, 28/2014, 43/2014, 130/2014, 180/2014, 78/2015, 192/2015, 27/2016, 120/2016, 165/2017 dhe 83/2018).

Tabela 5: ⁴⁰

Lloji i procedurës	Kontrata të përgjithshme	Vlera e përgjithshme e kontratave të përfunduara
Procedura e hapur	9.306	33.004.801.505 mkd
Procedurë me kërkesë me grumbullimin e ofertave deri 20.000 euro	8.057	3.998.549.982 mkd
Sistem kualifikues	37	1.528.960.439 mkd
Procedurë me bisedime pa botim të shpalljes	534	1.954.465.869 mkd
Procedurë me kërkesë për grumbullimin e ofertave deri 5.000 euro	8.724	1.213.069.256 mkd
Dhënia e kontratave të prokurimit publik për kategorinë e shërbimeve 17 - 27	245	614.182.263 mkd
Procedurë me bisedime me botim të shpalljes	19	518.901.972 mkd
Shpallje të tjera deri 20.000 euro	995	121.473.069 mkd
Të kufizuara	1	4.548.900 mkd
Gjithsej:	27.918	42.958.953.354 mkd

Numri dhe vlera e kontratave të prokurimeve publike të lidhura për vitin 2018 sipas llojit të procedurës së dhënies së kontratës janë paraqitur në tabelë. Në vitin 2018 janë nënshkruar 27.918 kontrata. Vlera e përgjithshme e kontratave të prokurimit publik në vitin 2018 është 42.958.953.354 denarë. Procedura më e përdorur sipas vlerës është procedura e hapur përmes së cilës janë lidhur 9,306 kontrata në vlerë prej 33.004.801.505 denarë, vijon Procedurë me kërkesë me grumbullimin e ofertave me prag prej më shumë se 5,000 euro - 8.057 kontrata në vlerë prej 3.998.549.982 denarë.

⁴⁰Të dhënat janë nga sistemi elektronik <https://e-nabavki.gov.mk/opendata-contracts.aspx#/home>

2.5. Zbatimi i Marrëveshjes

“Palët kontraktuese e zbatojnë marrëveshjen për prokurim publik ose marrëveshjen kornizë në pajtim me kushtet e caktuara në dokumentacionin e tenderit dhe ofertën e zgjedhur më të volitshme.

Organi kontraktues është i obliguar të kryejë kontroll nëse zbatimi i marrëveshjes për prokurim publik ose kontrata kornizë është në pajtim me kushtet e marrëveshjes. Për përgjegjësitë e palëve kontraktuese për plotësim të obligimeve kontraktuese, krahas dispozitave të këtij ligji, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat nga ligji që i rregullon marrëdhëniet obligatorë dhe dispozitat materiale me të cilat rregullohet lënda e prokurimit”⁴¹

2.6. Llojet e procedurave të prokurimit publik

2.6.1. Prokurime me vlerë të vogël

“Organi kontraktues mund të kryejë prokurime me vlerë të vogël të mallrave dhe shërbimeve me vlerë të përcaktuar deri në 10.000 euro në kundërvlerë me denarë dhe të punëve deri në 20.000 euro në kundërvlerë në denarë. Prokurimi me vlerë të vogël kryhet: - me publikim të shpalljes për prokurim me vlerë të vogël, me ç’rast afati minimal për parashtrim të ofertave është shtatë ditë nga dita e publikimit të shpalljes ose - nëpërmjet tregut elektronik të prokurimit me vlerë të vogël të SEPP, për blerjen e mallrave standarde dhe shërbimeve. Në rastet nga paragrafi (2) alineja 1 e këtij neni, secili operator ekonomik ka të drejtë të paraqesë ofertë sipas shpalljes të publikuar për prokurim publik.

Në rastet nga paragrafi (2) alineja 2 e këtij neni, organi kontraktues e zgjedh ofertën me çmimin më të ulët që është në përputhje me kërkesat dhe kushtet e përshkrimit të shkurtër të lëndës së prokurimit. Organi kontraktues publikon njoftim në tregun elektronik të prokurimeve me vlerë të vogël për qëllimin që të kryejë prokurim së paku 48 orë para realizimit të prokurimit, me ç’rast jepet përshkrim i shkurtër të lëndës së prokurimit.

Tek prokurimi me vlerë të vogël, organi kontraktues e përcakton vetëm kushtin për kryerjen e veprimtarisë profesionale.

⁴¹Ligji për prokurime publike neni 117 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.24/2019)

Ministri i Financave në mënyrë më të detajuar i përcakton llojet e prokurimeve dhe mënyrën e kryerjes së prokurimeve me vlerë të vogël përmes tregut elektronik të prokurimeve me vlerë të vogël në SEPP.”⁴²

2.6.2. Procedura e hapur e thjeshtësuar

“Organi kontraktues mund të zbatojë procedurë të hapur të thjeshtësuar për prokurim të mallrave dhe shërbimeve me vlerë të përcaktuar deri në 70.000 euro në kundërvlerë me denarë dhe të punëve deri në 500.000 euro në kundërvlerë në denarë.

Në procedurën e hapur të thjeshtësuar, çdo operator ekonomik i interesuar mund të paraqesë ofertë në bazë të shpalljes publike për prokurim publik.

Në shtojcë të ofertës dorëzohet deklaratë për dëshmimin e aftësisë ose dokumenteve për përcaktimin e aftësisë.

Para miratimit të vendimit për përzgjedhjen e ofertës më të volitshme, operatori ekonomik oferta e të cilit vlerësohet si më e volitshme është i obliguar t’i dorëzojë dokumentet për përcaktimin e aftësisë, nëse nuk i ka dorëzuar ato me ofertën.

Organi kontraktues i pranon dokumentet për përcaktimin e aftësisë nga paragrafi (4) i këtij neni, të cilat janë lëshuara edhe pas afatit të fundit për parashtrimin e ofertave.

Afati kohor minimal për parashtrimin e ofertave është 15 ditë nga dita e publikimit të shpalljes në SEPP.”⁴³

2.6.3. Procedura e hapur

“Procedura e hapur zhvillohet në një fazë dhe mund të zbatohet për secilën lëndë të prokurimit, me ç’rast secili operator ekonomik i interesuar mund të dorëzojë ofertë me dokumentacionin e nevojshëm për përcaktimin e aftësisë dhe të gjithë dokumentacionin tjetër në përputhje me kërkesat e dokumentacionit të tenderit.

Afati minimal për parashtrimin e ofertave është 30 ditë nga dita e publikimit të shpalljes në SEPP.Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni, nëse organi kontraktues publikon njoftim

⁴²Ligji për prokurime publike neni 48("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/2019)

⁴³Ligji për prokurime publike neni 49("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/2019)

paraparak informativ, kurse tek prokurimet publike nga veprimtaritë sektoriale njoftim periodik indikativ që nuk shfrytëzohet si zëvendësim për shpallje për prokurim publik, afati minimal kohor për paraqitjen e ofertave është 20 ditë, nëse: në njoftimin paraparak informativ ose në njoftimin periodik indikativ janë theksuar të gjitha informacionet që i përmban shpallja për prokurim publik, që janë të njohur në momentin e publikimit dhe njoftimi paraparak informativ ose njoftimi periodik indikativ është publikuar së paku 35 ditë, kurse më së shumti 12 muaj para datës së publikimit të shpalljes për prokurim publik.

Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni, nëse për shkaqe urgjente që organi kontraktues në mënyrë adekuate do t'i arsyetojë në vendimin për prokurim publik, nuk mund të respektohet afati nga i njëjti, organi kontraktues mund të përcaktojë afat që nuk do të jetë më i shkurtër se 20 ditë nga data e publikimit të shpalljes për prokurim publik.”⁴⁴

2.6.4.Procedura e kufizuar

“Procedura e kufizuar zbatohet në dy faza dhe mund të zbatohet për secilën lëndë të prokurimit, me ç’rast secili operator ekonomik i interesuar mund të paraqesë fletëparaqitje për pjesëmarrje në bazë të shpalljes së publikuar për prokurim publik.

Në shtojcë të fletëparaqitjes për pjesëmarrje, dorëzohet edhe dokumentacioni për përcaktimin e aftësisë sipas kushteve të dokumentacionit të tenderit për fazën e parë.

Afati minimal kohor për paraqitjen e fletëparaqitjeve për pjesëmarrje tek prokurimet publike të sektorit publik klasik është 30 ditë nga data kur është publikuar shpallja për prokurim publik.

Afati kohor për parashtrimin e fletëparaqitjeve për pjesëmarrje tek prokurimet publike të veprimtarive sektoriale sipas rregullës nuk do të jetë më i shkurtër se 30 ditë nga data kur është publikuar shpallja për prokurimin publik, e nëse shfrytëzohet njoftimi periodik indikativ si zëvendësim për shpallje për prokurim publik, afati sipas rregullës nuk do të jetë më i shkurtër se 30 ditë nga dita e dërgimit të ftesës për vërtetimin e interesit për pjesëmarrje, por në asnjë rast nuk guxon të jetë më i shkurtër se 15 ditë.

Pas përfundimit të fazës së parë, komisioni përgatit raport për vlerësimin e aftësisë së kandidatëve dhe listën e kandidatëve të kualifikuar.

⁴⁴Ligji për prokurime publike neni 50 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/2019)

Në bazë të raportit të komisionit, organi kontraktues miraton vendim për kandidatët e zgjedhur të cilëve do t'u dorëzojë ftesë për parashtrimin e ofertave, me ç'rast oferta në fazën e dytë mund të parashtrinë vetëm kandidatët e përzgjedhur.

Organi kontraktues mund ta kufizojë numrin e kandidatëve të aftë të cilët do të ftohen të paraqesin ofertë në fazën e dytë, në bazë të kriterëve objektive dhe jodiskriminuese të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit.

Afati minimal kohor për parashtrimin e ofertave tek sektori publik klasik është 25 ditë nga data e dërgimit të ftesës për parashtrimin e ofertës.

Afati për parashtrimin e ofertës tek prokurimet publike në veprimtaritë sektoriale mund të përcaktohet me marrëveshje të ndërsjellë ndërmjet organit kontraktues dhe kandidatëve të aftë, me ç'rast të njëjtit duhet të kenë në dispozicion të njëjtën periudhë kohore për përgatitjen dhe parashtrimin e ofertës. Në mungesë të marrëveshjes së këtillë të përbashkët, afati minimal për parashtrimin e ofertave në fazën e dytë është dhjetë ditë nga dita e dërgimit të ftesës për parashtrimin e ofertës.

(Nëse organi kontraktues ka publikuar njoftim paraprak informativ, afati minimal kohor për parashtrimin e ofertave nga paragrafi (8) të këtij neni mund të zvogëlohet në dhjetë ditë, nëse: a) në njoftimin paraprak informativ ose njoftimin periodik indikativ të jenë theksuar të gjitha informatat që i përmban shpallja për prokurim publik, që janë njohur në momentin e publikimit dhe b) njoftimi paraprak informativ ose njoftimi periodik indikativ është publikuar së paku 35 ditë, kurse më së shumti 12 muaj para datës së publikimit të shpalljes për prokurim publik.

Me përjashtim nga paragrafët (3), (4) dhe (8) të këtij neni, nëse për shkaqe urgjente që organi kontraktues në mënyrë adekuate do t'i arsyetojë në vendimin për prokurime publike, nuk mund të respektohen afatet e këtij neni, organi kontraktues mund të përcaktojë afat i cili nuk do të jetë më i shkurtër se: a) 15 ditë nga data ku është publikuar shpallja për prokurim publik si afat për paraqitjen e fletë paraqitjeve në fazë të parë dhe b) dhjetë ditë nga dita kur kandidatëve të përzgjedhur u është dërguar ftesë për parashtrimin e ofertës si afat për parashtrimin e ofertave në fazën e dytë.”⁴⁵

⁴⁵Ligji për prokurime publike Neni 51 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/2019)

2.6.5. Procedura konkurruese me negociim

“Organi kontraktues mund të shfrytëzojë procedurë konkurruese me negociim vetëm për prokurime publike në sektorin publik klasik edhe atë në rastet në vijim: a) për prokurim të mallrave, shërbimeve ose punëve, nëse: - nevojat e organit kontraktues nuk mund të realizohen pa përshtatjen e zgjidhjeve tanimë të kapshme, - lënda e prokurimit përfshin zgjidhje inovative ose të disenjatorit, - për shkak të rrethanave specifike në lidhje me llojin, ndërlikueshmërinë ose kornizën juridike dhe financiare ose për shkak të rreziqeve shoqëruese, marrëveshja për prokurim publik nuk mund ndahet pa negociata paraprake ose - organi kontraktues nuk mund në mënyrë mjaftë precize t’i përcaktojë specifikimet teknike në pajtim me kushtet e këtij ligji; b) për prokurimin e mallrave, shërbimeve ose punëve, për të cilat në procedurë të thjeshtësuar të hapur, të hapur ose të kufizuar janë parashtruar së paku dy oferta dhe të gjitha: - nuk janë në pajtim me dokumentacionin e tenderit, - kanë arritur me vonesë, - kanë çmim jashtëzakonisht të ulët ose - i tejkalojnë mjetet e siguruara në organin kontraktues. Në rastet e kësaj pike, organi kontraktues nuk e ka për obligim të publikojë shpallje nëse në procedurë i përfshin të gjithë ofertuesit që i plotësojnë kushtet për pjesëmarrje dhe për të cilat nuk ekzistojnë arsye për përjashtim dhe të cilat në procedurë të hapur të thjeshtësuar paraprake, procedurë të hapur ose procedurë të kufizuar kanë parashtruar ofertë në pajtim kërkesat formale të procedurës për prokurim publik.

Në procedurën konkurruese me negociim për çdo operator ekonomik të interesuar mund të paraqitet fletëparaqitje për pjesëmarrje, në bazë të shpalljes së publikuar për prokurim publik. Në shtojcë të fletëparaqitjes për pjesëmarrje dorëzohet edhe dokumentacioni për përcaktimin e aftësisë sipas kushteve të dokumentacionit të tenderit për fazën e parë.

Organi kontraktues e përcakton lëndën e prokurimit në dokumentacionin e tenderit, me përshkrimin e nevojave të tij dhe karakteristikat e kërkuara të mallrave, shërbimeve ose punëve që prokurohen, si dhe kriteret për zgjedhjen e ofertës më të volitshme. Organi kontraktues thekson edhe me cilat elemente të përshkrimeve përcaktohen kushtet minimale që doemos duhet t’i përmbushin operatorët ekonomikë. Informatat e theksuara duhet të jenë mjaftueshëm precize që t’u mundësojnë operatorëve ekonomikë ta identifikojnë llojin dhe vëllimin e kërkesave të kërkuara dhe të vendosin nëse do të paraqiten për pjesëmarrje në procedurë.

Afati minimal kohor për parashtrimin e fletëparaqitjeve për pjesëmarrje është 30 ditë nga dita e publikimit të shpalljes për prokurim publik, ndërsa afati minimal kohor për parashtrimin e ofertave fillestare është 25 ditë nga dita e dërgimit të ftesës për parashtrimin e ofertës fillestare.

Nëse organi kontraktues publikon njoftim paraprak informativ, afati minimal kohor për parashtrimin e ofertave nga paragrafi (5) të këtij neni, mund të zvogëlohet në dhjetë ditë, nëse: a) në njoftimin paraprak informativ ose njoftimin periodik indikativ të jenë theksuar të gjitha informatat që i përmban shpallja për prokurim publik, që kanë qenë të njohura në momentin e publikimit dhe njoftimi paraprak informativ ose njoftimi periodik indikativ të jetë publikuar së paku 35 ditë, kurse më së shumti 12 muaj para datës së publikimit të shpalljes për prokurim publik. Me përjashtim nga paragrafi (5) të këtij neni, nëse për shkaqe urgjente që organi kontraktues në mënyrë adekuate do t'i arsyetojë në vendimin për prokurim publik, nuk mund të respektohen afatet nga ky nen, organi kontraktues mund të përcaktojë afat që nuk do të jetë më i shkurtër se: a) 15 ditë nga data ku është publikuar shpallja për prokurim publik si afat për parashtrimin e fletëparaqitjeve për pjesëmarrje në fazë të parë dhe b) dhjetë ditë nga dita kur kandidatëve të përzgjedhur u është dërguar ftesa për parashtrimin e ofertës si afat për parashtrimin e ofertave në fazën e dytë. Pas përfundimit të fazës së parë, komisioni përgatit raport për vlerësimin e aftësisë së kandidatëve dhe listën e kandidatëve të kualifikuar. Në bazë të raportit të komisionit, organi kontraktues miraton vendim për kandidatet e zgjedhur të cilëve do t'u dorëzojë ftesë për parashtrimin e ofertës fillestare. Ofertë fillestare, e cila është bazë për negociata të mëtejshme, mund të paraqesin vetëm ata kandidatë të cilët do t'i ftojë organi kontraktues pas vlerësimit të aftësisë së tyre. Organi kontraktues mund ta kufizojë numrin e kandidateve të aftë të cilët do të ftohen të parashtrojnë ofertë fillestare, në bazë të kriterëve objektive dhe jodiskriminuese të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit. Me qëllim që të përmirësohet përmbajtja e ofertave, organi kontraktues negocion me ofertuesit për ofertën fillestare dhe të gjitha ofertat e ardhshme, përveç në rast të ofertës përfundimtare. Kushtet minimale dhe kriteret për zgjedhje të ofertës më të volitshme nuk janë lëndë e negociatave.

Organi kontraktues, në bazë të ofertës fillestare, mund të ndajë prokurim publik pa negociata, nëse në shpalljen për prokurime publike e ka theksuar atë mundësi.

Organi kontraktues doemos duhet të sigurojë trajtim të barabartë të të gjithë ofertuesve në negociata dhe informatat nuk guxon t'i sigurojë në mënyrë diskriminuese, për ç'arsye disa pjesëmarrës do të kenë përparësi në raport me të tjerët.

Të gjithë ofertuesit të përfshirë në fazën tjetër, organi kontraktues i informon me shkrim për të gjitha ndryshimet në specifikimet teknike ose në pjesë të tjera të dokumentacionit përshkrues, përveç kushteve minimale dhe kriterëve për përzgjedhjen e ofertës më të volitshme. Pas ndryshimeve të bëra organi kontraktues duhet të sigurojë kohë të mjaftueshme që ofertuesit të mund t'i përgatisin dhe paraqesin ofertat e ndryshuara, nëse është e nevojshme.

Organi kontraktues, nuk guxon pa pëlqimin e kandidatit i cili merr pjesë në negociata, t'ua zbulojë informatat e tij konfidenciale pjesëmarrësve të tjerë. Ky pëlqim doemos duhet të ketë të bëjë me informatat të cilat organi kontraktues ka për qëllim t'i përcjellë kandidatëve ose ofertuesve tjerë.

Në procedurë konkurruese me negociim, organi kontraktues mund të parashohë që negociatat të zhvillohet në faza të njëpasnjëshme me qëllim që të zvogëlohet numri i ofertave për të cilat negociohet, që e thekson në shpalljen për prokurim publik ose në dokumentacionin përshkrues.

Kur organi kontraktues ka për qëllim t'i përfundojë negociatat, i informon ofertuesit e tjerë për rrethin e fundit të negociatave dhe e përcakton afatin për parashtrimin e cilave do oferta të reja ose të ndryshuara, përveç nëse numrin e rretheve e ka publikuar në shpalljen për prokurim publik ose në dokumentacionin e tenderit, ose nëse ai negocion me vetëm një ofertues.

Pas pranimit të ofertave përfundimtare, organi kontraktues kontrollon nëse ato janë në përputhje me kërkesat minimale dhe do ta ndajë marrëveshjen e prokurimit publik në bazë të kriterëve për përzgjedhje të ofertës më të volitshme.”⁴⁶

2.6.6. Dialogu konkurrues

“Dialogu konkurrues zbatohet në tri faza, si vijon: - faza parakualifikuese, - faza e dialogut dhe - faza e parashtrimit të ofertës përfundimtare.

Organi kontraktues mund ta shfrytëzojë dialogun konkurrues nëse plotësohen kushtet si vijojnë:

a) për prokurim të mallrave, shërbimeve ose punëve, nëse: - nevojat e organit kontraktues nuk

⁴⁶Ligji për prokurime publike neni 52 Ligji("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/2019)

mund të realizohen pa përshtatjen e zgjidhjeve tanimë të arritshme, - lënda e prokurimit përfshin zgjidhje inovative ose të disenjatorit, - për shkak të rrethanave specifike në lidhje me natyrën, ndërlikueshmërinë ose strukturën juridike dhe financiare ose rreziqet që dalin nga ajo, marrëveshja për prokurim publik nuk mund të ndahet pa negociata paraprake ose - organi kontraktues nuk mund në mënyrë mjaftë precize t'i përcaktojë specifikimet teknike në pajtim me kushtet e këtij ligji; b) për prokurimin e mallrave, shërbimeve ose punëve për të cilat në procedurë të hapur ose të kufizuar janë parashtruar së paku dy oferta dhe të gjitha: - nuk janë në pajtim me dokumentacionin e tenderit, - kanë arritur me vonesë, - kanë çmim jashtëzakonisht të ulët ose - i tejkalojnë mjetet e siguruara në organin kontraktues. Në rastet nga kjo pikë, organi kontraktues nuk e ka për obligim të publikojë shpallje nëse në procedurë i përfshin të gjithë ofertuesit që i plotësojnë kushtet për pjesëmarrje dhe për të cilët nuk ekzistojnë arsye për përjashtim dhe të cilët në procedurën paraprake të hapur apo të kufizuar kanë parashtruar ofertë në pajtim kërkesat formale të procedurës për prokurim publik.

Pavarësisht nga paragrafi (2) i këtij neni, tek prokurimet publike të veprimtarive sektoriale, procedura me dialogun konkurrues mund të shfrytëzohet si procedurë e rregullt pa përcaktim paraprak të përmbushjes së kushteve nga paragrafi (2) të këtij neni.

Në procedurën me dialogun konkurrues, çdo operator ekonomik i interesuar mund të paraqesë fletëparaqitje për pjesëmarrje, me të cilën e dorëzon dokumentacionin e nevojshëm për përcaktimin e aftësisë.

Afati minimal kohor për paraqitjen e fletëparaqitjeve për pjesëmarrje është 30 ditë nga dita e publikimit të shpalljes për prokurim publik.

Afati kohor për parashtrimin e fletëparaqitjeve për pjesëmarrje tek prokurimet publike nga veprimtaritë sektoriale sipas rregullës nuk duhet të jetë më i shkurtër se 30 ditë nga dita e publikimit të shpalljes për prokurim publik, por në asnjë rast nuk guxon të jetë më i shkurtër se 15 ditë.

Pas përfundimit të fazës së parë, komisioni përgatit raport për vlerësimin e aftësisë së kandidatëve dhe listën e kandidatëve të kualifikuar. Në bazë të raportit të komisionit, organi kontraktues do të miratojë vendim për kandidatët e zgjedhur të cilëve do t'u dorëzojë ftesë për pjesëmarrje në dialog. Në dialog mund të marrin pjesë vetëm ato kandidatë që do t'i ftojë organi kontraktues pas vlerësimit të aftësisë së tyre.

Organi kontraktues mund ta kufizojë numrin e kandidatëve të aftë që do të ftohen të marrin pjesë në fazën e dialogut. Në procedurën me dialog konkurrues, marrëveshja ndahet ekskluzivisht sipas kriterit të raportit më të mirë ndërmjet çmimit dhe kualitetit. Organi kontraktues i thekson nevojat e veta dhe kushtet në shpalljen për prokurim publik, të cilat në mënyrë të detajuar i definojnë në dokumentacionin e tenderit për fazën e parë, si dhe kriteret e përzgjedhje të ofertës më të volitshme dhe kornizën kohore indikative. Organi kontraktues fillon dialog me kandidatët e aftë në të cilin mund të diskutohet për të gjitha aspektet e prokurimit publik për përcaktimin dhe definimin e mënyrave më adekuate për të përmbushur nevojat e tij.

Organi kontraktues doemos duhet të sigurojë trajtim të barabartë të të gjithë pjesëmarrësve në dialog dhe informatat nuk guxon t'i sigurojë në mënyrë diskriminuese, për arsye disa pjesëmarrës do të kishin përparësi në raport me tjerët. Për çdo mbledhje, organi kontraktues mban procesverbal për çështjet që kanë qenë lëndë e dialogut. Procesverbalin e nënshkruan edhe kandidati i zgjedhur me të cilin është zhvilluar dialogu. Organi kontraktues, nuk guxon pa pëlqimin e kandidatit i cili merr pjesë në dialog t'i zbulojë zgjidhjet e tij të propozuara ose informata tjera të besueshme pjesëmarrësve tjerë. Ky pëlqim doemos duhet t'u referohet informatave të cilat organi kontraktues ka për qëllim t'ua zbulojë kandidatëve tjerë. Organi kontraktues mund të parashikojë që procedura të zhvillohet në faza të njëpasnjëshme me qëllim që të zvogëlohet numri i zgjidhjeve të mundshme me zbatimin e kriterëve për përzgjedhjen e ofertës më të volitshme, që e thekson në shpalljen për prokurim publik ose në dokumentacionin e tenderit. Organi kontraktues e vazhdon dialogun derisa nuk gjen një ose më shumë zgjidhje që mund t'i përmbushin nevojat e tij. Kur organi kontraktues do ta mbarojë dialogun dhe për këtë do t'i informojë pjesëmarrësit që kanë marrë pjesë në pjesën e fundit të dialogut, secilin prej tyre e fton të parashtojë ofertë përfundimtare në bazë të zgjidhjes së kontraktuar ose zgjidhjeve, që janë prezantuar dhe më detajisht të përcaktuara gjatë dialogut.

Oferta përfundimtare doemos duhet t'i përmbajë të gjitha elementet e nevojshme dhe të domosdoshme për zbatimin e projektit.

Organi kontraktues mund të kërkojë nga ofertuesi që ta sqarojë ofertën përfundimtare, në mënyrë më të detajuar të përcaktojë dhe ta optimizojë, por kjo nuk guxon të përfshijë ndryshime në elementet themelore të ofertës ose të dokumentacionit të tenderit. Organi kontraktues do t'i vlerësojë ofertat e paraqitura në bazë të kriterëve për përzgjedhjen e ofertës më të volitshme nga

shpallja dhe nga dokumentacioni i tenderit. Organi kontraktues, me ofertuesin për të cilin ka konstatuar se ka dorëzuar ofertë që paraqet raport më të mirë ndërmjet çmimit dhe cilësisë, mund të negociojë për konfirmimin e detyrimeve financiare ose kushteve të tjera të ofertës duke me finalizimin e kushteve të marrëveshjes, me kusht që të mos ndryshohen elementet themelore të ofertës, duke përfshirë nevojat dhe kërkesat e dokumentacionit të tenderit dhe të mos e prishin konkurrencën ose të ketë efekt diskriminues. Organi kontraktues në dokumentacionin e tenderit mund ta përcaktojë shumën e shpërblimeve ose pagesave për pjesëmarrësit në dialog.”⁴⁷

2.6.7. Partneriteti për inovacione

“Organi kontraktues mund të shfrytëzojë partneritet për inovacione nëse ka nevojë për mallra inovativë, shërbime ose punë, që nuk mund të plotësohen edhe me prokurim të mallrave, shërbimeve ose punëve që janë tanimë të arritshme në treg. Organi kontraktues i përcakton arsyet dhe nevojën për mallrat inovativë, shërbimet ose punët në dokumentacionin e tenderit, si dhe kërkesat minimale në lidhje me lëndën e prokurimit dhe kushtet minimale për përcaktimin e aftësisë të cilat duhet të jenë mjaftë precize për t’u mundësuar operatorëve ekonomikë që ta identifikojnë llojin dhe vëllimin e zgjidhjeve të kërkuara dhe të vendosin nëse do të paraqiten për pjesëmarrje në procedurë.

Në procedurën për partneritet për inovacione çdo operator ekonomik i interesuar mund të paraqesë fletëparaqitje për pjesëmarrje, me të cilën e dorëzon dokumentacionin e nevojshëm për përcaktimin e aftësisë. Organi kontraktues mund të vendosë për vendosjen e partneritetit për inovacione me një ose më shumë partnerë të cilët do të zbatojnë aktivitete të veçanta hulumtuese dhe zhvillimore. Afati minimal kohor për pranimin e fletëparaqitjeve për pjesëmarrje është 30 ditë nga dita e publikimit të shpalljes për prokurim publik. Afati kohor për parashtrimin e fletëparaqitjeve për pjesëmarrje tek prokurimet publike të veprimtarive sektoriale sipas rregullës nuk do të jetë më i shkurtër se 30 ditë nga dita kur është publikuar shpallja e prokurimit publik, por në asnjë rast nuk guxon të jetë më i shkurtër se 15 ditë. Ofertë fillestare në procedurën për partneritetit për inovacione mund të paraqesin vetëm ato kandidatë që do t’i ftojë organi

⁴⁷Ligji për prokurime publike neni 53 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/2019)

kontraktues pas vlerësimit të aftësisë së tyre. Organi kontraktues mund ta kufizojë numrin e kandidatëve të aftë që do të ftohen të marrin pjesë në partneritetin për inovacione. Në procedurën e partneritetin për inovacione, marrëveshja ndahet ekskluzivisht sipas kriterit të raportit më të mirit ndërmjet çmimit dhe kualitetit.

Partneriteti për inovacione strukturohet në faza të njëpasnjëshme, me respektimin e radhitjes së hapave në procesin e hulumtimit dhe inovacioneve, të cilat mund të përfshijnë prodhimin e mallrave, sigurimin e shërbimeve ose kryerjen e punëve. Tek partneriteti për inovacione vendosen qëllime të përkohshme të cilat duhet t'i arrijnë partnerët në fazë individuale, si dhe pagimi i kompensimeve në këste përkatëse. Në bazë të qëllimeve nga paragrafi (9) të këtij neni, organi kontraktues mundet që pas çdo faze të vendosë ta ndërpresë partneritetin për inovacione, kurse në rast të partneritetit me më shumë partnerë, ta zvogëlojë numrin e partnerëve me prishjen e marrëveshjeve individuale, me kusht që atë ta ketë theksuar në dokumentacionin e tenderit, si dhe kushtet në të cilat mund të shfrytëzohet mundësia e tillë. Organi kontraktues siguron se struktura e partneritetit, kurse në veçanti kohëzgjatja dhe vlera e fazave individuale, përcaktohen duke marrë parasysh nivelin e inovacionit të zgjidhjes së propozuar, si dhe një varg veprimtarish hulumtuese dhe inovative të nevojshme për zhvillimin e zgjidhjes inovative që ende nuk është e arritshme në treg. Vlera e përcaktuar e mallrave, shërbimeve ose ndërtimeve nuk guxon të jetë jo proporcionale me investimet që janë të domosdoshme për zhvillimin e tyre. Organi kontraktues mund të negociojë me ofertuesit për ofertën fillestare dhe të gjitha ofertat e ardhshme për përmirësimin e përmbajtjes së tyre, me përjashtim të ofertës përfundimtare. Për kushtet minimale dhe kriterin për zgjedhjen e ofertës më të volitshme nuk mund të negociohet. Organi kontraktues doemos duhet të sigurojë trajtim të barabartë të të gjithë pjesëmarrësve në negociata dhe informatat nuk guxon t'i sigurojë në mënyrë diskriminuese, për ç'arsye disa pjesëmarrës do të kenë përparësi në raport me tjerët. Organi kontraktues me shkrim i informon të gjithë ofertuesit e përfshirë në fazën e ardhshme për të gjitha ndryshimet në specifikimet teknike ose në pjesë tjera të dokumentacionit të tenderit. Pas ndryshimeve të bëra, organi kontraktues siguron kohë të mjaftueshme për ofertuesit që të mund t'i përgatisin dhe paraqesin ofertat e ndryshuara, nëse është e nevojshme. Në procedurën për partneritet për inovacione,organi kontraktues mund të parashikojë që negociatat të zhvillohet në faza të njëpasnjëshme me qëllim që të zvogëlohet numri i zgjidhjeve te mundshme që e thekson në shpalljen për prokurim publik ose në

dokumentacionin e tenderit. Gjatë zgjedhjes së kandidatëve, organi kontraktues në veçanti i shfrytëzon kushtet në lidhje me aftësinë e kandidatëve në fushën e hulumtimit dhe zhvillimit, si dhe në zhvillimin dhe implementimin e zgjidhjeve inovative. Vetëm ato operatorë ekonomikë të cilët do t'i ftojë organi kontraktues pas vlerësimit paraprak të informatave të kërkuara mund të dorëzojnë projekte hulumtuese dhe inovative për përmbushjen e nevojave të organit kontraktues të cilat nuk mund të përmbushen me zgjidhjet ekzistuese. Organi kontraktues përcakton se si do të rregullohen të drejtat e pronësisë intelektuale në dokumentacionin e tenderit. Organi kontraktues nuk guxon që pa pëlqimin e partnerit t'ua zbulojë partnerëve të tjerë zgjidhjet e propozuara ose informacionet tjera konfidenciale të cilat ia ka dorëzuar partneri. Ky pëlqim doemos duhet të ketë të bëjë me informatat të cilat organi kontraktues ka për qëllim t'ua përcjellë partnerëve tjerë.”⁴⁸

2.6.8 Procedura me negociim pa publikim të shpalljes

“Organi kontraktues mund të zbatojë procedurë me negociim pa publikimin e shpalljes për prokurim publik për mallra, shërbime apo punë në rastet si vijojnë: a) kur pas dy procedurave të hapura të zbatuara paraprakisht ose procedurave të thjeshtësuara të hapura nuk është dorëzuar asnjë ofertë ose asnjë ofertë e përshtatshme, respektivisht kur pas dy procedurave të zbatuara paraprakisht të kufizuara, nuk është paraqitur asnjë fletëparaqitje për pjesëmarrje ose asnjë fletëparaqitje përkatëse për pjesëmarrje në fazën e parë, me kushtet që të mos jenë ndryshuar kushtet në mënyrë të konsiderueshme nga dokumentacioni i tenderit. Çmimi i përgjithshëm i ofertës përfundimtare të propozuar në procedurën me negociim nuk guxon ta tejkalojë çmimin e ofertës së ofertuesit të njëjtë të paraqitur në procedurën e mëparshme të pasuksesshme për prokurim publik; b) nëse prokurimi publik i veprimtarive sektoriale ka për qëllim vetëm hulumtimin, eksperimentimin, studimin ose zhvillimin dhe nuk ka për qëllim të realizojë profit ose t'i kompensojë shpenzimet për hulumtim dhe zhvillim, me kusht që dhënia e marrëveshje të tillë nuk ndikon në konkurrencën gjatë ndarjes së marrëveshjeve të mëvonshme për prokurim publik për ato qëllime; c) nëse mallrat, shërbimet ose puna mund të sigurohen nga operatori ekonomik i caktuar për arsyet e mëposhtme: - qëllimi i prokurimit publik është të krijohet ose të fitohet vepër unike artistike ose shfaqje artistike, - kur për arsye teknike nuk ka konkurrencë për

⁴⁸Ligji për prokurime publike nr. 54 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/2019)

lëndën e prokurimit ose - për mbrojtjen e të drejtave ekskluzive, duke përfshirë të drejtat e pronësisë intelektuale; ç) nëse, për shkak të urgjencës së skajshme të shkaktuar si rezultat i ngjarjeve që organi kontraktues nuk ka mundur t'i parashikojë, afatet për procedurat e tjera nuk mund të zbatohen. Rrethanat me të cilat arsyetohet urgjenca e skajshme në asnjë rast nuk guxon të jenë të tilla që t'i atribuohen organit kontraktues.

Bazat për shfrytëzimin e procedurës me negociim pa publikimin e shpalljes nga paragrafi (1) pika c), alinetë 2 dhe 3 të këtij neni mund të shfrytëzohen nëse nuk ka alternativë adekuate ose zëvendësim dhe nëse mungesa e konkurrencës nuk është pasojë e kufizimit të pajustificuar të specifikimeve të lëndës së prokurimit.

Procedura me negociim pa publikim të shpalljes mund të shfrytëzohet për prokurim të mallrave:

a) të prodhuar ekskluzivisht për hulumtim, eksperimentim, studim ose zhvillim, por jo për mallrat në prodhimin serik me të cilin do realizohej fitim ose kthim i shpenzimeve për zhvillim ose hulumtim; b) kur organi kontraktues doemos duhet të prokurojë dërgesa shtesë nga bartësi i parë i prokurimit me qëllim të zëvendësimit të pjesshëm të mallrave të zakonshme ose instalimeve, ose zgjerim të mallrave ekzistuese ose instalimeve, me çrast ndryshimi i ofertuesit do ta obligonte organin kontraktues të blejë materiale me karakteristika të ndryshme teknike që do të rezultonte me inkompatibilitet ose vështirësi teknike joproportionale në funksionim dhe mirëmbajtje. Kohëzgjatja e prokurimeve shtesë nuk guxon të tejkalojë tri vite nga lidhja e marrëveshjes fillestare, kurse vlera e tyre nuk guxon të tejkalojë 20% të vlerës së marrëveshjes fillestare; c) që kuotojnë dhe cilat organi kontraktues i prokuron nga bursa; ç) që prokurohen me kushte veçanërisht të volitshme nga ofertues që i mbyll aktivitetet e tij afariste (likuidim ose falimentim), nga drejtor i falimentimit ose likuidator, me marrëveshje paraprake me kreditorët; d) në veprimtaritë sektoriale, me shfrytëzimin e ndonjë mundësie posaçërisht të volitshme që është në dispozicion vetëm për kohë shumë të shkurtër me çmim dukshëm më të ulët se çmimi i zakonshëm i tregut. Procedura me negociim pa publikim të shpalljes mund të shfrytëzohet për prokurime publike të shërbimeve: a) Që prokurohen me kushte veçanërisht të volitshme nga ofertues që i mbyll aktivitetet e tij afariste (likuidim ose falimentim), nga drejtor i falimentimit ose likuidator, me marrëveshje paraprake me kreditorët; b) kur marrëveshja në fjalë vijon pas konkursit të zbatuar për zgjedhjen e zgjidhjes ideore dhe i ndahet pjesëmarrësit më të mirë të ranguar ose njërit nga pjesëmarrësit më të mirë të ranguar. Nëse marrëveshja i ndahet njërit nga

pjesëmarrësit më të mirë të ranguar, organi kontraktues i fton të gjithë ata të marrin pjesë në negociata.

Në rastet nga paragrafin (1) pikat c) dhe ç), organi kontraktues e fillon procedurën me negociim pa publikim paraprak të shpalljes vetëm pas marrjes së mendimit paraprak nga Byroja.

Me përjashtim nga paragrafi (5) i këtij neni, organi kontraktues nuk e ka për obligim të marrë mendim paraprak para se të zbatojë procedurë me negociim pa publikim paraprak të shpalljes në bazë të paragrafit (1) pika ç) të këtij neni, nëse drejtpërdrejt është e cenuar siguria, jeta dhe shëndeti i njerëzve.

Mendimin nga paragrafi (5) i këtij neni Byroja e jep në afat prej dhjetë ditësh pune nga dita e marrjes së kërkesës, respektivisht pesë ditë pune në rastet nga paragrafi (1) pika g) të këtij neni.

Nëse Byroja nuk e jep mendimin nga paragrafi (5) të këtij neni në afatin nga paragrafi (7) të këtij neni, organi kontraktues mund të fillojë procedurë edhe pa të.

Organi kontraktues në vendimin për prokurim publik i thekson dhe arsyeton shkaqet për përzgjedhjen e procedurës me negociim pa publikim të shpalljes.

Organi kontraktues gjatë negociatave, paraprakisht në formë të shkruar, e kumton rrethin e fundit të negociatave, përveç nëse numrin e rretheve e ka publikuar në dokumentacion në lidhje me ndarjen e prokurimit publik, përkatësisht negociacion me vetëm një kandidat.

Organi kontraktues nuk e ka për obligim ta përcaktojë aftësinë e operatorëve ekonomikë në procedurën me negociim pa publikim të shpalljes. Organi kontraktues njoftimit për marrëveshje të lidhur ia bashkëngjet edhe mendimin e Byrosë në rastet kur i njëjti është i detyrueshëm. Formën dhe përmbajtjen e kërkesës për mendim nga paragrafi (7) të këtij neni e përcakton ministri i Financave.”⁴⁹

2.6.9 Procedura me negociim me publikim të shpalljes

“Organi kontraktues mund ta shfrytëzojë procedurën me negociim me publikimin e shpalljes për prokurim publik të veprimtarive sektoriale.

Në procedurën me negociim me publikim të shpalljes, çdo operator ekonomik i interesuar mund të parashtrijë fletëparaqitje për pjesëmarrje, në bazë të shpalljes së publikuar për prokurim

⁴⁹Ligji për prokurime publike neni 55 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/2019)

publik. Si shtojcë e fletëparaqitjes për pjesëmarrje dorëzohet edhe dokumentacioni për përcaktimin e aftësisë. Afati kohor për parashtrimin e fletëparaqitjeve për pjesëmarrje sipas rregullës nuk duhet të jetë më i shkurtër se 30 ditë nga data kur është publikuar shpallja e prokurimit publik, kurse nëse shfrytëzohet njoftimi periodik indikativ si zëvendësim për shpallje për prokurim publik, sipas rregullës nuk do të jetë më i shkurtër se 30 ditë nga dita e dërgimit të ftesës për të konfirmuar interesin për pjesëmarrje, por në asnjë rast nuk guxon të jetë më i shkurtër se 15 ditë.

Pas përfundimit të fazës së parë, komisioni përgatit raport për vlerësimin e aftësisë së kandidatëve dhe listën e kandidatëve të kualifikuar.

Në bazë të raportit të komisionit, organi kontraktues miraton vendim për kandidatet e zgjedhur të cilëve do t'u dorëzohet ftesë për parashtrimin e ofertës fillestare.

Oferta fillestare, e cila është bazë për negociata të mëtejshme, mund të paraqesin vetëm kandidatët të cilët do t'i ftojë organi kontraktues pas vlerësimit të aftësisë së tyre.

Organi kontraktues mund ta kufizojë numrin e kandidateve të aftë që do të ftohen të paraqesin ofertën fillestare. Afati për parashtrimin e ofertës mund të përcaktohet me marrëveshje të ndërsjellë ndërmjet organit kontraktues dhe kandidatëve të kualifikuar, me ç'rast të njëjtit duhet të kenë në dispozicion të njëjtën periudhë kohore për përgatitjen dhe parashtrimin e ofertës. Në mungesë të marrëveshjes së tillë të ndërsjellë, afati minimal për parashtrimin e ofertave të para është dhjetë ditë nga dita e dërgimit të ftesës për parashtrimin e ofertës.”⁵⁰

2.6.10 Mënyrat e veçanta për zbatimin e procedurës

2.6.10.1. Marrëveshja kornizë

“Organi kontraktues mund të lidhë marrëveshje kornizë me shfrytëzim të një prej procedurave të përcaktuara në nenin 47 të ligjit për Prokurime Publike.

Afati i vlefshmërisë së marrëveshjes kornizë në sektorin publik klasik nuk guxon të jetë më i gjatë se tri vjet, e në veprimtaritë sektoriale nuk guxon të jetë më i gjatë se pesë vjet, përveç në raste veçanërisht të arsyeshme që janë të lidhura drejtpërdrejt me lëndën e prokurimit dhe të cilat organi kontraktues në mënyrë adekuate i ka arsyetuar në vendimin për prokurimin publik.”⁵¹

⁵⁰Ligji për prokurime publike neni 56 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/2019)

⁵¹Ligji për prokurime publike neni 57 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/2019)

2.6.10.2. Sistemi dinamik për prokurime

“Sistemi dinamik për prokurime mund të ndahet në kategori mallra, shërbime ose punë që janë të definuara objektivisht në bazë të karakteristikave të rëndësishme të lëndës së prokurimit. Këto karakteristika mund t'i referohen vëllimit maksimalisht të lejueshëm të marrëveshjeve të veçanta ose rajonit gjeografik në të cilin do të realizohen marrëveshjet e veçanta.

Gjatë kryerjes së prokurimeve publike përmes sistemit dinamik për prokurime, organi kontraktues i zbaton rregullat e procedurës së kufizuar, përveç rregullave të cilat kanë të bëjnë me afatin minimal për parashtrim të fletëparaqitjeve për pjesëmarrje dhe të ofertave. Të gjithë kandidatët që i përmbushin kushtet për pjesëmarrje, fitojnë qasje në sistemin, me ç'rast numri i kandidatëve që do të fitojnë qasje nuk guxon të kufizohet.

Nëse organi kontraktues e ndan sistemin dinamik për prokurime në kategori mallra, shërbime ose punë, për çdo kategori definohej veçmas kritere për përcaktimin e aftësisë.”⁵²

2.6.10.3. Ankandi elektronik

“Organi kontraktues mund të shfrytëzojë ankand elektronik në të cilin do të marrë çmime të reja të korigjuara teposhtë, përkatësisht vlera të reja për elemente të caktuara nga ofertat, me ç'rast ankandi strukturohet si proces elektronik përsëritës, që vijon pas evaluimit fillestar të plotë të ofertave dhe mundëson rangim të ofertave me metodat për evaluim automatik.

Ankandi elektronik mund të shfrytëzohet vetëm nëse specifikimet teknike janë definuar në mënyrë precize te procedura e hapur, procedura e kufizuar, procedura konkurruese me negociim, procedura me negociim me publikim të shpalljes, prokurim me vlerë të vogël me publikim të shpalljes dhe procedurë të thjeshtësuar të hapur, si dhe gjatë mbledhjes së sërishme të ofertave të marrëveshja kornizë me më shumë operatorë ekonomikë dhe te sistemi dinamik për prokurime.”⁵³

⁵²Ligji për prokurime publike neni 58 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/2019)

⁵³Ligji për prokurime publike neni 59 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/2019)

2.6.10.4. Katalogu elektronik

“Organi kontraktues mund të kërkojë parashtrim të ofertave në formë të katalogut elektronik ose oferta të përfshijë katalog elektronik.

Ofertat e parashtruara në formë të katalogut elektronik mund të shoqërohen me dokumente tjera që e plotësojnë ofertën. Operatori ekonomik e përpilon katalogun elektronik për pjesëmarrje në procedurë të caktuar për prokurim publik, në pajtim me specifikimet teknike dhe formatin e caktuar nga ana e organit kontraktues. Katalogu elektronik doemos duhet të jetë në pajtim me kërkesat për veglat për komunikim elektronik dhe të gjitha kërkesat plotësuese të përcaktuara nga organi kontraktues. Nëse lejohet ose kërkohet parashtrim i ofertave në formë të katalogëve elektronikë, organi kontraktues atë e cek në: - shpalljen për prokurim publik; - në ftesën për vërtetim të interesit, nëse shfrytëzohet njoftim indikativ periodik si zëvendësim për shpallje për prokurim publik ose në ftesën për parashtrim të ofertave, nëse shfrytëzohet shpallje për vendosje të sistemit kualifikues. Në dokumentacionin e tenderit organi kontraktues i cek të gjitha informatat e nevojshme në lidhje me formatin, pajisjen e shfrytëzuar elektronike si dhe lidhjet teknike dhe specifikimet lidhur me katalogun.”⁵⁴

2.6.10.5. Aktivitetet e centralizuara për prokurim dhe trupi qendror për prokurime

“Organi kontraktues mund të prokurojë mallra ose shërbime nga trupi qendror për prokurime. Organi kontraktues mund të prokurojë mallra, shërbime ose punë në bazë të marrëveshjes të lidhur nga trupi qendror për prokurime, me shfrytëzim të sistemit dinamik për prokurime ose sistemit kualifikues të menaxhuar nga ana e trupit qendror për prokurime, ose në bazë të marrëveshjes kornizë të lidhur nga ana e trupit qendror për prokurime.

Organi kontraktues mund të shfrytëzojë sistem dinamik për prokurime të cilin e menaxhon trupi qendror për prokurime nëse kjo është cekur në shpalljen për vendosje të sistemit.

Konsiderohet se organi kontraktues ka zbatuar procedurë adekuate për prokurim publik nëse ka prokuruar mallra, shërbime ose punë në pajtim me marrëveshjen e lidhur të trupit qendror për prokurime.”⁵⁵

⁵⁴Ligji për prokurime publike neni 60 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/2019)

⁵⁵Ligji për prokurime publike neni 61 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/2019)

KAPITULLI I TRETË

3. Problemet në zbatimin e ligjit për prokurimin publik

3.1. Transparenca dhe përgjegjësia e pamjaftueshme

“Parimi i transparencës është një detyrim për Organet kontraktuese që operatorëve ekonomik t’ua sigurojnë të gjithë informacionet në lidhje me prokurimet publike (mundësia e dhënies së kontratave të prokurimeve publike, vendimet e marra gjatë procedurës, si dhe të dhënat mbi kontratat e prokurimit publik). Transparenca nënkupton konkurrencë dhe çmime më të favorshme, d.m.th. sa më shumë operatorë ekonomik që kanë informacion në lidhje me qëllimin e Autoritetit kontraktues për të kryer prokurime të caktuara, interesimi dhe konkurrenca janë më të mëdha. Në këtë mënyrë, ofertat e dorëzuara tek Organet kontraktues do të ishin më të favorshme, duke kursyer dhe duke marrë vlerën më të mirë për fondet publike.”⁵⁶

“Në rastin e institucioneve shtetërore, problemi është dhënia e informatave të rëndësishme për opinionin lidhur me kontratat e prokurimit publik, edhe pse ky është obligimi i tyre ligjor. Ligji për Prokurimin Publik përcakton që Organet shtetërore kanë detyrim të dorëzojnë tek Byroja e Prokurimit Publik një njoftim mbi kontratën e prokurimit publik të lidhur për prokurim me vlerë më të madhe brenda 30 ditëve nga data e lidhjes së kontratës. Por Organet shtetërore në praktikë e kanë vonuar dorëzimin e të dhënave mbi kontratat e përfunduara, dhe në disa raste ato nuk paraqesin fare të dhëna. Dobësia tjetër e transparencës janë edhe marrëveshjet me procedurë me negociatë pa shpalljen e një thirrjeje për oferta, d.m.th. të ashtuquajturat kontrata të drejtpërdrejta. Duke pasur parasysh mungesën e transparencës në përfundimin e këtyre marrëveshjeve, është e qartë se kjo procedurë për lidhjen e marrëveshjes së prokurimit publik lë hapësirë për sjellje subjektive të organeve kontraktuese dhe mund të përbëjë rrezik për shfaqjen dhe përhapjen e veprimeve korruptive.”⁵⁷

⁵⁶Богева Мицовска, М., Јованоска, М., Агрировски, А., Глигоријевска, Р., Примена на Законот за Јавни Набавки во Пракса II издание, Здружение на финансиски работници на локалните самоуправи и јавните претпријатија- Велес, Скопје 2012, fq.19.

⁵⁷Проблеми во примена на законот за јавни набавки, Стојановски, С., април 2012 Скопје.

3.2. Abuzimi me marrëveshjet e drejtpërdrejta

“Arsyetimet më të shpeshta të përdorura nga Organet kontraktuese në lidhje me kontratat e lidhura pa shpallje, edhe pse nuk bëhet fjalë për prokurime të vogla, shkaqet se pse kjo procedurë përdoret nga Organet është koha urgjente dhe arsyet e shkaktuara nga situata të paparashikuara që Organet kontraktuese nuk mund t’i parashikojnë dhe t’ju atribuohet si lëshim. Përkatësisht, shpenzimi i parave publike nëpërmjet kontratave të përfunduara në këtë mënyrë gjithmonë fsheh dyshimin për arsyetimin e tyre, si dhe dilemën nëse e abuzojnë qëllimisht këtë të drejtë ligjore.

“Procedura me bisedime pa botimin paraprak të shpalljes e ka zvogëluar transparencën dhe konkurrencën, dhe jep mundësinë e sjelljes subjektive të pjesëmarrësve kryesorë në procedurë, si dhe ka mungesë të mekanizmave të kontrollit dhe jep mundësinë e praktikave korruptive.”

Organet kontraktuese realizojnë një procedurë me bisedime pa botim paraprak të shpalljes për të gjitha llojet e kontratave, d.m.th. për Prokurime mallrave, punëve dhe shërbimeve.

Zbatimi i shpeshtë i procedurës së negociuar bazuar në këtë kërkesë mund të jetë një tregues i dobësive serioze në procedurat e dhënies së kontratave për disa Organe kontraktuese, planifikimin e tyre të dobët dhe menaxhimin e dobët të vetë Organeve. Rastet e urgjencës së justifikuar ekstreme mund të jenë paraqitja e zjarrit, përmbytjeve, etj., ngjarjet e forcës madhore dhe rrethanat që dalin si rezultat i tyre.”⁵⁸

3.3. Korrupsioni në prokurimin publik

Baza dhe korniza ligjore për luftimin e korrupsionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut është Ligji për Parandalimin e Korrupsionit.⁵⁹

Nuk ka një përkufizim të përgjithshëm mbi korrupsionin që si i tillë të jetë i pranuar nga të gjitha shtetet. Përcaktimi se çfarë duhet konsideruar si korrupsion ndryshon nga një vend tek tjetri. Kriminaliteti si dukuri shoqërore negative dhe e rrezikshme, paraqet një dukuri shoqërore që manifestohet në forma të ndryshme gjatë rrjedhës së historisë njerëzore.⁶⁰

⁵⁸Стојановски, С., Проблеми во примена на законот за јавни набавки, април 2012 Скопје.

⁵⁹Ligji për parandalim të korrupsionit („Gazeta zyrtare e R.M “nr.28/02,46/04,126/06,10/08,161/08 и 145/10)

⁶⁰Sahiti, E., “Kriminaliteti si dukuri shoqërore negative dhe provimi (argumentimi) procedural i tij” Revista e Drejta nr.1,Prishtinë ,1995,,fq.13

Korrupsioni është aq evident sa që nuk është imun as tek shtetet e forta ekonomikisht, as te ato me rend juridik të rregulluar, apo as te ato të varfrat. Dallimi është në lajmërimin, formën, shtrirjen dhe intensitetin.⁶¹

Disa autorë problematiken e korrupsionit e definojnë si p.sh., G. Kouplend e definojnë si përdorim i pavend i shërbimeve publike për përfitime private. A. Van Der Zalman korrupsionin e definojnë si procesetë ndryshme me emërim të përbashkët të mosfunksionimit të procesit demokratik gjatë vendimmarrjes, sipas tij korrupsioni ekziston kur personi privat i ka bërë shërbim individit në pushtet ose të afërmit të tyre.

Format më të shpeshta të korrupsionit janë: dhënia dhe marrja e ryshfetit, shantazhi dhe tregtia me informacione sekrete, siç janë informacionet shtetërore, ekonomike e ushtarake, korrupsioni mund të bëhet nëpërmjet mitosjes së drejtpërdrejtë të zyrtarëve publik, por edhe nëpërmjet mitosjes të tërthortë (p.sh. premtimi për punësim të mëvonshëm, provizioni për nënshkrimin e marrëveshjeve afariste, nënshkrimi i marrëveshjeve të punës me miq ose të afërm, etj.).⁶²

Institucioni përgjegjës për parandalimin e korrupsionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut është Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit - i themeluar në vitin 2002 si një institucion i pavarur i cili ka kapacitetin e një personi juridik i cili përbëhet nga shtatë anëtarë të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut me mandat katërvjeçar me të drejtën e ri emërimit.⁶³

“Gjatë vitit 2017, Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit ka vepruar për gjithsej 7 paraqitje të parashtruara për korrupsion të mundshëm në fushën e prokurimeve publike, në raport me procedurat për dhëniene kontratave për prokurime publike të cilat kanë qenë të realizuara nga ana e Organeve kontraktuese. Duke vepruar në përputhje me kompetencat sipas Ligjit për parandalim të korrupsionit, pas përmbledhjes së informatave relevante nga institucionet tjera me qëllim vërtetimin e gjendjes faktike dhe kontrollimin e pretendimeve të paraqitura, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, në 7-të lëndët ka konstatuar se nuk janë vërtetuar pretendimet e paraqitura dhe ka vendosur se nuk ka elemente për veprimin e mëtutjeshëm të saj për lëndët konkrete.”⁶⁴ Prokurimet publike për herë të parë u bënë pjesë e Kodit penal të

⁶¹Vuković, S., *Korupcija i Vladavina Prava*, Beograd. 2003 fq.9

⁶²Latfi.V, *Kriminalistika, Zbulimi dhe të provuarit e krimin, Prishtinë* 2006,f,q 209

⁶³Ligji për parandalim të korrupsionit („Gazeta zyrtare e R.M “nr.28/02,46/04,126/06,10/08,161/08 и 145/10)

⁶⁴Извештај за активностите за Бирото за Јавни Набавки во функционирањето на системот за јавни набавки, Скопје јуни 2018, fq.30.

Maqedonisë së Veriut në vitin 2004 duke zgjeruar akuzën e veprës penale të nenit 353 të Kodit Penal, me ç'rast politikat penale u ashpërsuan seriozisht për kryerjen e keqpërdorimeve në prokurimet publike.⁶⁵ Rregullimi i legjislacionit për keqpërdorimet me procedurat e prokurimit publik nuk dha fryt, dhe për këtë në vitin 2009, u fut një inkriminim i veçantë nga neni. 275-v në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë, Shpërdorimi i procedurës për shpalljen publike, dhënia e kontratës së prokurimit publik ose partneriteti publiko-privat.⁶⁶ Arsyeja themelore për se ligjvënësit u përcaktuan për të vendosur këtë vepër penale ishte perceptimi se te kjo lëmi e prokurimit publik dhe shpenzimi i parave nga buxheti shpesh janë një fushë e korrupsionit të pakontrolluar dhe abuzimit që mund bëjnë personate përfshirë në të gjithë procesin.⁶⁷

Me ndryshimet në LPP nga viti 2013 dhe 2014, u bë një rregullore jashtë kodit penal që përfshin 19 dispozita penale. Ekzistenca e rregulloreve jashtë kodit penal është rezultat i natyrës plotësuese të funksionit mbrojtës të kodit penal.⁶⁸

“Personi për prokurime publike ose cilido person tjetër i angazhuar te organi kontraktues, si dhe çdo person i interesuar i cili ka informata për korrupsionin e kryer, është i detyruar ta njoftojë Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit ose Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Personit nuk guxon t’i ndërpritet marrëdhënia e punës, respektivisht nuk guxon të transferohet në vend tjetër pune sepse ka paraqitur korrupsion në prokurimet publike duke vepruar me ndërgjegje dhe me qëllim të mirë”⁶⁹

⁶⁵Malahova, M., Казнено-правна заштита на јавните набавки со посебен акцент врз вонкривичните прописи, Универзитет „Св.Кирил и Методиј“ – Скопје, Правен факултет „Јустинијан Први“ Скопје, студент на трет циклус на правни студии, УДК:35.073.53.037 (497.7) Скопје fq.223.

⁶⁶Законот за изменување и дополнување на Кривичниот законик, „Службен весник на Република Македонија“ бр. 114/09 од 14.9.2009 година; Н.Тупанчески/Д.Кипријановска, Ново (сепаратно) казнено право за јавните набавки, Правник, бр. 261, 2014 година.

⁶⁷Камбовски, В., Коментар на Кривичниот законик на Република Македонија, Клуб Матица, Скопје, 2011, стр. 948-949.

⁶⁸Камбовски, В., & Тупанчески, Н., Кодификација на казненото законодавство, ЗКПКМ и ОБСЕ, 2015 година.

⁶⁹Ligji për prokurime publike neni 34 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 24/2019)

KAPITULLI I KATËRT

4. Parandalimi i korrupsionit

4.1. Roli i policisë në parandalimin e korrupsionit

Në të gjitha vendet, duke llogaritur edhe shoqëritë bashkëkohore, policia, me përjashtim të organizimit formal, ka të njëjtat funksione dhe detyra.⁷⁰

Roli dhe qëllimi kryesor i policisë në një shoqëri demokratike të udhëhequr nga forca e ligjit është të ruaj qetësinë publike dhe rendin në shoqëri, të mbrojë dhe të respektojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parandalojë dhe të luftojë krimin, të zbulojë krimin të kryej funksione ndihmëse dhe shërbime për publikun.⁷¹

Lufta kundër krimit është obligim për organet shtetërore, qytetarët dhe shoqërinë në tërësi. Sfidat e ndryshme dhe problemet e llojllojshme mund të jenë vendimtare me punën e mëtutjeshme në polici për shumë individë. Përkrahja e udhëheqësve policor në kryerjen e detyrave të rregullta, për policët do të jetë stimulim për punë.⁷²

“Veprimtaria e policisë është e shumëfishtë. Policia, duke vepruar në parandalimin dhe zbulimin e krimit i ofron prokurorit publik dhe gjykatës materiale të nevojshme për fillimin e procedurës penale, gjatë zhvillimit të procedurës penale ofron ndihmë kriminalistike lidhur me identifikimin e personave dhe të sendeve, ofron ndihmë për ekzekutimin e vendimeve, jep të dhëna nga evidencat e caktuara, etj.

Eprorë të policisë së jurispruencës janë udhëheqësit e njësive organizative në MPB, në Drejtorinë e Policisë Financiare dhe Drejtorinë Doganore, të cilët janë në lidhje të drejtpërdrejtë me prokurorinë publike, sikundër që nëpunës të policisë së jurispruencës janë nëpunësit policor të njësive organizative në këto organe (neni 49), si dhe pjesëtarët e policisë së jurispruencës në qendrat hetimore të prokurorisë publike dhe nëpunësit të ndarë prokurorit publik në pajtim me nenin 50 të LPP-së.”⁷³

⁷⁰Latifi, V., Taktika Kriminalistike, Prishtinë, 2001, fq.26

⁷¹Halili, Xh., DREJTA (Roli, Organizimi dhe Kontrolli i Policisë së Kosovës) Nr.1-2010, Prishtinë, fq. 92

⁷²Shishani, F., Roli i Policisë në Parandalimin e Kriminalitetit, Prishtinë 2006, fq.60

⁷³Saiti, E., Zejneli, I., E Drejta E Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup 2017, fq. 93,94.

Në vijim të punimit do të paraqesim pyetjet që i kemi përdorur në pyetësorin tonë drejtuar institucionit përkatës dhe përgjigjet që i kemi marrë, të cilat i kemi dërguar nëpërmjet Kërkesës për Qasje në informata me karakter publik deri të MPB.

1. Në çfarë mënyrë e zbatoni procesin e zbulimit të abuzimeve në prokurimet publike të Organeve shtetërore?

2. A keni zbuluar dhe nëse po, sa raste janë zbuluar rreth abuzimeve të prokurimit publik?

3. Çfarë masash merrni në përputhje me ligjet e Republikës së Maqedonisë për trajtimin e korrupsionit në prokurimet publike?

- Procesi i zbulimit të abuzimeve në prokurimet publike bëhet përmes kontrollit të Sistemit Elektronik të Prokurimit Publik (ESPP), marrjes së informatave në mënyrë operative, raportimit të ndryshëm, iniciativave të paraqitura nga Drejtoria për Parandalimin e Korrupsionit (DPK) përmes Kërkesës dhe Urdhrave nga Prokuroria Publike Themelore për ndjekjen penale të krimit të Organizuar dhe korrupsionit, e cila prokurori është kompetente për të vepruar në lidhje me abuzimet e kryera gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, etj.

- Sipas statistikave zyrtare, gjatë vitit 2017 dhe 2018, janë zbuluar 31 vepra penale në bazë të arsyeve të parashikuara në nenin 353 paragrafi 4 të Kodit Penal. Megjithatë, duke pasur parasysh natyrën specifike të veprimeve inkriminuese që kanë të bëjnë me prokurimin publik, si dhe faktin se në rastet e përmendura përveç elementëve të veprës penale "keqpërdorim i pozitës zyrtare dhe autorizimit", më së shpeshti në këto vepra penale bëjnë pjesë edhe krime tjera, ju informojmë se sipas të dhënave jozyrtare nga Ministria e Punëve të Brendshme nga rastet për të cilat janë parashtruar kallëzime penale gjatë vitit 2017 dhe 2018, 53 raste lidhen me abuzimet në prokurimet publike në Organet shtetërore, ndërmarrjet publike dhe institucionet.

-Në përputhje me ligjet e Republikës së Maqedonisë për trajtimin e korrupsionit në prokurimet publike, pas marrjes së informatave për abuzime në zbatimin e procedurave të prokurimit publik, kryhen kontrole me qëllim që të konfirmohen abuzimet dhe nëse është e mundur të sigurohet dokumentacion nga institucionet tjera (të kërkuara për pjesëmarrje në një prokurim

publik), pas së cilës informohet Prokuroria Publike për Ndjekje të Krimeve të Organizuar dhe Korrupsionit, e cila lëshon kërkesa ose urdhra të përshtatshëm për ofrimin e dokumentacionit në dëshmi origjinale dhe të tjera. Analizohet dokumentacioni i siguruar për të kontrolluar procedurat që janë ndjekur dhe nëse procedura është në përputhje me ligjin për prokurimin publik. Për të marrë njohuri rreth rrjedhës së procedurës, përveç sigurimit të dokumentacionit, zhvillohet edhe një bisedë me personat, pjesëmarrësit në procedurë të cilët mund të japin informata të dobishme. Për informacionin e marrë informohet edhe Prokuroria Publike.

4.1.1 Drejtoria e Policisë Financiare

Policia financiare është pjesë e policisë së jurisprudencës, si autoritet për ndjekjen e kryerësve të krimeve të lidhura me krimin e organizuar financiar dhe veprave të tjera penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare si "Shoqërimi kriminal" Neni 394, "Keqpërdorimi i pozitës zyrtare dhe autoritetit "Neni 353", "Puna e pandërgjegjshme në shërbim", Neni 353 - v, "Larja e parave dhe të ardhurat tjera nga vepra ndëshkuese", Neni 273, "Tregtia e palejuar", Neni 277", "Mashttrim tatimor" Neni 247, "Evazioni fiskal" Neni 279, "Mashttrim" Neni 247, "Falsifikimi ose shkatërrimi i librave afariste" Neni 280, "Shpërdorimi në shërbim" Neni 354, "Shkaktimi i qëllimshëm i falimentimit" Neni 254, "Kontrabanda" Neni 278 si dhe vepra të tjera penale sipas Kodit Penal, fitimi i pasurisë së paligjshme të pronës me vlerë të konsiderueshme ose dëm në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.⁷⁴

Në vijim do të paraqesim disa raste konkrete se si ka vepruar Drejtoria e Policisë Financiare dhe e cila ka zbuluar disa raste të keqpërdorimit të procedurës së thirrjes publike, gjatë dhënies së kontratave të prokurimeve publike.

1. Mes ngjarjeve të përditshme me të cilët merret policia financiare për të parandaluar korrupsionin është edhe rasti kur "Drejtoria e Policisë Financiare deri të Prokuroria Themelore Publike në Shkup ka parashtruar aktakuza penale kundër personave V.T., ish kryetar i komunës Qendër, M.T., ish Sekretar në Komunën Qendër dhe D.R., i punësuar në Sektorin e Mbrojtjes së Mjedisit në Komunën Qendër, për shkak të ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm se kanë kryer

⁷⁴<http://finpol.gov.mk/mk/osnovni-informacii>

krim "Punë e pandërgjegjshme në shërbim" nga neni 353, pika 1, Neni 22 i KP i Republikës së Maqedonisë. Personi i parë, V.T., në cilësinë e kryetarit të Komunës Qendër, në emër dhe për llogari të Komunës Qendër, më 3 shtator 2009 ka lidhur një Kontratë për prokurimin publik të punëve - "Ndërtimi i një ure për këmbësorë në lumin Vardar - "Ura Syri", me personin juridik Konstruktor Engineering A.D., për Ndërtim - Split në shumë prej 92.546.647,00 denarë duke përfshirë TVSH-në dhe aneksin e kontratës së prokurimit publik, me çka vlera e kontratës është rritur në 119.197.783,00 denarë duke përfshirë TVSH-në. I dyshuari i parë V.T., gjegjësisht sipas kontratës në dy raste është paguar një paradhënie (avancë) prej 20% të kontratës që është shuma prej 23.839.557,00 denarë, për të cilën shumë nga Konstruktor-Inxhinieri A.D. për ndërtimin Split janë lëshuar dy garanci bankare për pagesën. Në të njëjtën kohë, personi i dytë i dyshuar, M.T. - Sekretari i komunës Qendër, nënshkruesi i formularëve - kërkesave për pagesë, ishte i detyruar të kontrollojë dokumentacionin e bashkangjitur dhe në këtë mënyrë të mbikëqyr realizimin e projektit në përputhje me afatet e përcaktuara në kontratë. Për të dyshuarin e tretë D.R., i punësuar në Komunën Qendër në Departamentin e ndërtimit dhe mbrojtjes së mjedisit, nga Kryetari i komunës personi i parë, V.T., emërohet si person përgjegjës për mbikëqyrje të kontratës specifike, ishte i detyruar të mbikëqyr realizimin e projektit në përputhje me afatet e përcaktuara në kontratë dhe të informojë kryetarin e komunës që është V.T. i akuzuari i parë për rrjedhën e performancës, si dhe për të gjitha problemet e performancës që kanë ndodhur.

Në të dhënat e kontabilitetit të Komunës Qendër, ekzistojnë situata të përkohshme ndërtimi dhe faturat për punët e kryera sipas kësaj marrëveshjeje në shumën e përgjithshme prej 82,398,458.88 denarë dhe pagesa e bërë nga ana e Komunës Qendër në shumën e përgjithshme prej 91,172,172.00 denarë, dita në të cilin shuma e avansit është përfshirë në shumën prej 23.839.557,00 denarë dhe në emër të avansit, fondet e mbetura janë në shumën prej 8,773,714.00 denarë si kërkesë nga Komuna Qendër, për të cilat Konstruktor Engineering AD Split nuk i ka kryer punët ndërtimore në pajtim me kontratën dhe nuk ka përgatitur situatat kohore të punëve që në fakt përbëjnë një borxh nga Konstruktor Engineering AD Split ndaj Komunës Qendër. Periudha e vlefshmërisë së garancive bankare për faturat e pagesave të avansit ka skaduar dhe nga personi përgjegjës i komunës nuk janë mbledhur, i akuzuari i parë V.T. në

ushtrimin e autorizimit diskrecional dhe duke mos mbikëqyrur ka vepruar pandërgjegjshëm në ushtrimin e kompetencave dhe detyrave të tij, duke dëmtuar Buxhetin e Komunës Qendër.

Të akuzuarit e përgjegjshëm në ushtrimin e detyrës së tyre zyrtare, edhe pse afati i fundit për kryerjen e punimeve kishte mbaruar, duke e ditur se kontraktuesi ka një borxh ndaj komunës Qendër në vlerë prej 8,773,714.00 denarë, në emër të avansit, edhe pse nga ana e tyre në komunën Qendër nuk ishte depozituar garanci e vlefshme bankare, kanë lejuar në komunën Qendër të pranohen dhe të paguhen dy fatura të dorëzuara nga kontraktuesi Konstruktor-Inxhinieri AD Split, më përshkrim “Dallimi në çmimet për punët e kryera dhe harxhimet për shkak të vonesave të punëve” në shumën e përgjithshme prej 7.069.245,00 denarë.

Gjithashtu në përputhje me Kontratën dhe Aneksin e Kontratës në Komunën Qendër është dorëzuar një garanci bankare në shumë prej 17.879.710,00 denarë për kryerjen në kohë dhe me cilësi të punëve me të cilën Konstruktor Engineering AD Split i garanton Komunës Qendër se do të kryejë punët në kohë dhe në mënyrë cilësore në pajtim me Kontratën e Prokurimit Publik. Kontraktuesi, Konstruktor Engineering AD për Ndërtim Split është prezantuar në kryerjen e punimeve më 27.07.2010, d.m.th. afati për kryerjen e punëve sipas kontratës është 18 muaj dhe skadon më 27.01.2012.

Edhe pse afati për punët ndërtimore kishte kaluar, i akuzuari i parë V.T. dhe i akuzuari i tretë D.R. duke dështuar në kryerjen e mbikëqyrjes, kanë vepruar me neglizhencë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare të cilët sipas pozicioneve të tyre të punës, duhet të kishin ndërmarrë masa, d.m.th. nuk kanë ndërmarrë aktivitete për të mbrojtur Buxhetin e Komunës Qendër, në pajtim me kontratën e prokurimit publik dhe aneksin e asaj kontrate, duke mos kërkuar vazhdimin e periudhës së vlefshmërisë së garancive bankare për të shlyer avansin dhe zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së garancisë bankare për ekzekutimin në kohë dhe me cilësi të punëve të cilët duhej të aktivizonin pagesën në favor të Komunës Qendër para skadimit të garancive bankare dhe para përfundimit të kontratës nga ana e Komunës Qendër me kontraktuesin Konstruktor Engineering AD Split.

Për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve nga kontrata, shkeljes së afatit për kryerjen e punëve si dhe për shkak të performancës së dobët të punëve të kryera në vitin 2012, Komuna Qendër e ndërpreu kontratën me kontraktuesin Konstruktor Engineering AD Split. Për

përfundimin e punimeve për ndërtimin e urës së këmbësorëve “Ura e Syrit” mbi lumin Vardar, u zhvillua një procedurë e re e prokurimit publik dhe u lidh një kontratë me një tjetër kontraktues. Të akuzuarit V.T. , M.T. dhe D.R. , sipas nenit 353-v paragrafi 3,nenit 22 nga KP i Republikës së Maqedonisë, gjatë ushtrimit të autoritetit diskrecional dhe duke mos kryer mbikëqyrje, kanë vepruar në mënyrë të paqëndrueshme në ushtrimin e kompetencave dhe detyrave të tyre në emër të mos aktivizimit të dy garancive bankare për dhënien e një avansi të caktuar në vlerë prej 8.773.714,00 denarë, si dhe nuk kanë aktivizuar një garanci bankare për mos kryerjen në kohë dhe me cilësi të punëve në shumën nga 17.879.719,00 denarë, dhe kanë dëmtuar Buxhetin e Komunës Qendër në vlerë prej gjithsej 26.653.424,00 denarë.”⁷⁵

2. Edhe një rast tjetër është kur Prokuroria Themelore Publike për përndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit duke vepruar rreth aktakuzës penale të parashtruar nga ana e Drejtorisë për polici financiare, solli Vendim për zbatimin e procedurës hetuese kundër pesë personave, për të cilët është ngritur propozim për përcaktim të masave të kujdesit kundër individëve S.J. në cilësinë e Kryetarit të komunës së Karposhit, M.D., udhëheqës i Sektorit për Prokurime Publike, N.N. ndihmës udhëheqës i Sektorit për Çështje Financiare, S.M., udhëheqës i Sektorit Normativ në Sektorin Juridik dhe A.S., udhëheqës i Sektorit për Kontabilitet, për shkak të dyshimit se ata kanë kryer veprë penale "Keqpërdorim i pozitës dhe autorizimit zyrtar" e dënueshme sipas nenit 353 paragrafi 5, paragrafi 1, me Vazhdim i veprës penale, Neni 45 dhe me bashkëkryerje, neni 22 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë.

Duke e keqpërdor pozitën dhe autorizimin zyrtar S.J. dhe bashkëpunëtorët e tij u kanë mundësuar përfitimin e fitimit të paligjshëm personave juridik “Alkonproekt” në vlerë prej 33.789.441 denarë dhe “S.M. Kompani” në vlerë prej 2.845.234 denarë, me çfarë e kanë dëmtuar buxhetin e Komunës së Karposhit në vlerë prej gjithsej 36.634.675 denarë ose rreth gjysmë milion euro.

S.J., siç theksohet në kumtesë, në cilësi të kryetarit të Komunës së Karposhit gjatë vitit 2012 dhe 2013 e ka keqpërdor pozitën dhe autorizimin zyrtar me atë që në emër dhe në llogari të komunës ka zbatuar dy procedura për Prokurime publike.

S.J., në vend që ta shfuqizojë marrëveshjen dhe ta aktivizojë dhe paguajë garancinë bankare të ofertës në pajtim me nenin 47 të Ligjit për prokurime publike, i ka lejuar ekzekutuesit të fillojë me kryerjen e aktiviteteve në pajtim me marrëveshjet, ndërsa pastaj për shkak të kryerjes

⁷⁵<http://finpol.gov.mk/mk/180704-krivicna-prijava-poranesen-gradonacalnik-centar-most-ok>

jocilësore dhe në kohë të punëve i ka shfuqizuar marrëveshjet me kryerësin, me çfarë i ka mundësuar të përfitojë fitim të paligjshëm në emër të garancive bankare të pasiguruara dhe të papaguara për kryerje cilësore të marrëveshjes me vlerë të përgjithshme prej 911.166 denarë, e cila skemë është në dëm të buxhetit.

M.D. në cilësi të udhëheqësit të Sektorit për Prokurime Publike në Komunën e Karposhit gjatë vitit 2012-2016 e ka keqpërdor pozitën dhe autorizimin zyrtar në mënyrë që në procedurat e zbatuara për prokurime publike me Alkonproekt, edhe pse e ka ditur se nuk është dorëzuar garanci bankare, në vend që të propozojë aktivizim dhe pagesë të garancisë bankare të ofertës dhe të shpall referencë negative për ofruesin i ka ndjekur marrëveshjet, me çfarë i ka mundësuar personit juridik të përfitojë me fitim të paligjshëm në emër të garancive bankare të pa aktivizuara, a.q. të papaguara të ofertës.

N.N. në cilësi të kryetarit të Komisionit për prokurime publike, S.M. si anëtar i Komisionit dhe A.S. si zëvendës anëtar në vitin 2016 e kanë keqpërdor pozitën dhe autorizimin zyrtar me çfarë në kundërshtim me normat ligjore e kanë pranuar ofertën e S.M Kompani sh.p.k, Shën Nikollë, edhe pse nuk ka dorëzuar certifikatë për cilësi të materialeve ndërtimore, si dhe siç është paraparë në specifikimin teknik të dokumentacionit të tenderit. Me këtë i kanë mundësuar të marrë pjesë në procedurën dhe të për zgjidhet ofertues më i volitshëm dhe të përfitojë këtë përfitim të paligjshëm.”⁷⁶

3.Një rast tjetër është kur Drejtoria e Policisë Financiare ka ngritur aktakuza penale kundër Kryetarit të Komunës së Vevçanit dhe personave të tjerë në Prokurorinë Themelore Publike për përndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit për shkak të ekzistencës së një dyshimi të arsyeshëm për keqpërdorim të pozitës dhe autorizimit zyrtar, “Keqpërdorim i procedurës për shpalljen publike, dhënien e një Marrëveshje të prokurimit publik dhe asistencë“. Zyra e Policisë Financiare e Prokurorisë Themelore Publike për Krimin e Organizuar ngriti aktakuza penale kundër personave C.U., N.K., L.M., Gj.V., L.K., B.C.K. dhe E.K. Abuzimi i procedurës së thirrjes publike, dhënia e një Marrëveshje të prokurimit publik ose partneritetit publik-privat dhe asistencës, gjatë vitit 2013 në një mënyrë që solli dhe nënshkroi një Vendim për Prokurimin e Punimeve (Ndërtim i Mureve Mbështetëse) dhe Vendimi për zgjedhjen e Furnizuesit më të favorshëm, përkatësisht në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik, filloi një procedurë të

⁷⁶<http://finpol.gov.mk/mk/180808-krivicni-prijavi-opstina-karpos-gradonacalnik-vraboteni> сопштение бр.02-2046 дт. 08.08.2018.

prokurimit publik për Ndërtimin e një muri mbështetës në zonën ku do të ndërtohej një hallë sporti, edhe pse ai e dinte që puna e ndërtimit nga prokurimi publik i lartpërmendur ishte përfunduar para se të bëhet shpallja për prokurimin publik - Ndërtimi i një muri mbështetës. Personi i dytë N.K. në cilësinë e Kryetarit të Komisionit për Prokurim Publik, personi i tretë, L.M. në cilësinë e një anëtari të Komisionit për Prokurim Publik dhe Gj.V. anëtar i komisionit për prokurime publike kanë keqpërdorur pozitën dhe autorizimin e tyre zyrtar në atë mënyrë që kanë kryer një prokurim publik pas një vendimi të sjellë më parë për prokurimin e punëve (Ndërtimi i mureve mbajtëse) i iniciuar nga personi i parë, për punët ndërtimore që ishin përfunduar më parë, të gjithë në dobi të kërkuarit L.K. i cili në cilësinë e udhëheqësit të personit juridik “VVULF - Transport v.Veleshtë– Strugë” me vetëdije dhe me një qëllim të paracaktuar, edhe pse ai e dinte se punimet e ndërtimit lidhur me ndërtimin e murit mbështetës ishin përfunduar prej tyre, kanë shkelur rregullat e procedurës së prokurimit publik.

Personi i gjashtë V.N.V në cilësinë e mbikëqyrësit me autorizim për kryerjen e mbikëqyrjes në fushën e ndërtimit dhe personi i shtatë E.K. i diplomuar si një inxhinier ndërtimi me autorizim për kryerjen e mbikëqyrjes për ndërtim me vetëdije dhe me një qëllim të paracaktuar i kanë ndihmuar të akuzuarave në mënyrë që ju kanë vënë në dispozicion licencat e tyre si mbikëqyrëspër inxhinier ndërtimi dhe kanë nënshkruar dhe vulosur situacionet e përkohshme 1, të përgatitur dhe të paraqitur nga personi i pestë L.K. i cili e bëri atë të besueshëm dhe legjitim, edhe pse ata e dinin se ndërtimi i murit mbështetës ishte kryer më parë.

Të akuzuarit për keqpërdorim të pozitës dhe autorizimit zyrtar të cilët në mënyrë të paligjshme i mundësuan personit të pestë të dyshuar L.K. dhe personit juridik “VVULF-Transport f. Veleshtë – Strugë” për të përfutur pronësi të paligjshme prej 1,322,458 denarë, me se kanë dëmtuar Buxhetin e Komunës së Vevçanit.”⁷⁷

⁷⁷<http://finpol.gov.mk/mk/171006-krivicna-gradonacalnik-vevcani> соопштение бр. 02-1994, dt. 06.10.2017

4.2. Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Rregullimi juridik i prokurorisë publike dhe organizimi i saj është bërë me anë të ligjit.⁷⁸ Republika e Maqedonisë së Veriut është e përbërë si shtet i pavarur, sovran, demokratik dhe civil, e cila ka si vlerë themelore sundimin e ligjit dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut. Në Kushtetutë, Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si një autoritet publik i pavarur që ndjek autorët e krimeve dhe veprat e tjera penale, në bazë të dy dispozitave (Neni 106 dhe 107), sipas të cilëve ky Autoritet shtetëror është një ndër Autoritetet më të rëndësishme shtetërore në drejtim të mbrojtjes së vlerave themelore të konceptit të ri kushtetues. Sipas nenit 106 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Prokuroria Publike është përcaktuar si një autoritet publik i pavarur që ndjek autorët e krimeve dhe veprave tjera penale dhe kryen detyra të tjera të përcaktuara me ligj. Prokuroria Publike kryen funksionet e saj në bazë dhe në kuadër të Kushtetutës dhe ligjit. I njëjti nen përcakton emërimin dhe shkarkimin e Prokurorit Publik nga Kuvendi për një periudhë prej gjashtë vjetësh.

Dispozita tjetër e Kushtetutës (neni 107) ka të bëjë me gëzimin e imunitetit të Prokurorit Publik për të cilin vendos Kuvendi, gjatë ushtrimit të detyrës si prokuror publik nuk duhet të ushtrohet asnjë detyrë tjetër publike ose profesion ose nuk lejohet të anëtarësohet në një parti politike.⁷⁹

“Në secilën prokurori publike ekziston prokurori publik i cili mund të ketë një ose më shumë zëvendës (neni 4 i LPrP). Kësisoj ekziston prokurori publik i RMV, prokurori publik i lartë, prokurori publik themelor dhe prokurori i lartë për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit.”⁸⁰

Në vijim të punimit do të paraqesim pyetjet që i kemi drejtuar deri të Prokuroria Publike e RMV dhe përgjigjet që i kemi pranuar, nëpërmjet Kërkesës për Qasje në informata me karakter publik.

⁷⁸Ligji mbi prokurorinë publike i Republikës së Maqedonisë Gazeta zyrtare e RM nr.80/92, 19/93, 9/94, 9/96, 38/2006, 150/2007.

⁷⁹http://jorm.gov.mk/?page_id=1703

⁸⁰Saiti, E., Zejneli, I., E Drejta E Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup 2017, fq 93.

Pyetjet e drejtuara deri të Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë:
1. Në çfarë mënyrë e zbatoni procesin e zbulimit të abuzimeve në prokurimet publike të Organet shtetërore?
2. A keni zbuluar dhe nëse po, sa raste janë zbuluar rreth abuzimeve të prokurimit publik?
3. Çfarë masash merrni në përputhje me ligjet e Republikës së Maqedonisë për trajtimin e korrupsionit në prokurimet publike?
Përgjigja e Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë:
<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, do t'i referohemi juridiksionit të Prokurorisë Publike. Sipas nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit për Qasje të Lirë në Informacionin Publik, "informacioni i karakterit publik", Zyra e Prokurorit Publik është organ i pavarur shtetëror i cili ndjek penalisht autorët e krimeve dhe veprat e tjera penale dhe kryen detyra të tjera të përcaktuara me ligj. Duke pasur parasysh kompetencat e mësipërme dhe funksionine Prokurorit Publik të mos zbulojë krimet, por për të ndjekur penalisht autorët e krimeve. Parandalimi dhe zbulimi i veprave të dënueshme dhe ndërmarrja e masave për ndjekjen penale të kryerësve të këtyre krimeve është nën autoritetin e policisë.</p> <p>Sa i përket pjesës së tretë të kërkesës. Prokuroria publike nuk e ushtron detyrimin ligjor vetëm përmes fushës së veprimtarisë, por mbikëqyr dhe studion marrëdhëniet shoqërore dhe ngjarjet të cilët janë në interes të prokurorisë publike. Qëllimi i rezultateve të aktiviteteve është perceptimi i plotë i problemeve që kanë lidhje negative me realizimin e veprës së kryerësve të veprave penale dhe të shkeljeve të tjera. Prokuroria Publike ka një qasje jo-selektive në luftën kundër korrupsionit dhe njeh dëmet që i kanë shkaktuar gjithë shoqërisë veprat penale që kanë lidhje me korrupsionin, ju qaset me seriozitet problemeve dhe vepron si represiv dhe parandalues. Në këtë kuptim, raportet vjetore mbi punën e prokurorive publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut kanë publikuar të dhëna për veprat penale që lidhen me korrupsionin.</p>

Në vijim do të paraqesim të dhënat nga raporti i prokurorive publike për vitin 2017.

Sipas raportit të publikuar gjatë vitit 2017, për veprën penale Keqpërdorim i pozitës zyrtare dhe autoritetit sipas nenit 353 paragrafi 5 të Kodit Penal, janë parashtruar aktakuza penale kundër 133 personave, nga të cilët 93 persona të sapo regjistruar dhe 40 persona të raportuar vitet e mëparshme. Në krahasim me vitin 2016, janë paraqitur akuza ndaj 130 personave nga të cilët 27

persona të sapo raportuar dhe 103 persona të raportuar nga vitet e mëparshme. Për këto vepra penale në procedurë parahetimore janë ndërmarrë veprime hetimore dhe urdhra për përgatitjen e domosdoshme të raporteve të ekspertëve kundër 41 personave dhe urdhra për mbledhjen e të dhënave të nevojshme për 12 njerëz. Aktakuzat penale u hodhën për 23 vetë, dhe për 13 persona u zgjidhën në një tjetër mënyrë. Në këtë prokurori mbetën të pazgjidhura Aktakuza penale për 6 persona, në Organet tjera mbeten të pazgjidhura aktakuza penale për 51 persona.

Sipas raportit të vitit 2017, pas veprimeve hetimore të cilat kanë mbetur pa u zgjidhur nga viti i kaluar kundër 63 personave, janë sjellë urdhëresa të reja për procedurë hetimore kundër 40 personave. Kjo nënkupton se në raportin e vitit 2017 është zhvilluar hetim kundër 103 personave. Pas përfundimit të hetimeve është parashtruar aktakuza penale kundër gjashtë personave. Pas ngritjes së aktakuzave penal kundër 6 personave është llogaritur dëmi pronësor që kanë shkaktuar në vlerë prej 24.212.222,00 denarë, më të cilat është dëmtuar buxheti i Republikës së Maqedonisë. Duke pasur parasysh faktin se më këto aktakuza janë të dyshuar për kryerje të veprës penale “Pastrim i parave dhe përfitime tjera të paligjshme të pronës” sipas nenit 273 të Kodit Penal dhe “evazion tatimor” sipas nenit 279 të Kodit Penal. Pas përfundimit të hetimeve është sjellë urdhëresë për të ndaluar hetimin kundër 4 personave, dhe kundër 2 personave hetimet janë zgjidhur në një tjetër mënyrë.

Në fund të raportit të vitit 2017 kanë mbetur të pazgjidhura hetime kundër 91 personave. Është sjellë aktvendim për dënim kundër 1 personi, ku i është shqiptuar dënim me kusht, kundër të cilit prokurori publik ka paraqitur ankesë.”⁸¹

Në vijim do të paraqesim një rast se si ka vepruar prokuroria publike pas aktakuzave penal të paraqitura nga Drejtoria e Policisë Financiare të cilat kanë të bëjnë më keqpërdorimet në sferën e prokurimeve publike.

“Prokurori kompetent publik nga Prokuroria Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit që veproi në lidhje me aktakuzën penale të paraqitur nga Drejtoria e Policisë Financiare, miratoi një urdhër për kryerjen e procedurës hetimore kundër pesë personave.

Të dyshuarit akuzohen se kanë keqpërdorur pozitën e tyre zyrtare dhe autorizimin në tre procedura të prokurimit publik, ku dy persona kanë kryer një vepër penale "Keqpërdorim i

⁸¹Të dhënat janë nga Годишен извештај за работата на јавните обвинителства за 2017 година, Скопје.

pozitës zyrtare dhe autorizimit” në bazë të neni 353, paragrafi 5 në lidhje me paragrafin 1,e në lidhje me nenin 22, në lidhje me nenin 45, ndërsa tre nga të dyshuarit për kryerjen e veprës penale “Keqpërdorim me pozitën e tyre zyrtare dhe autorizimin” nga neni 353 paragrafi 5, në lidhje me paragrafin 1,e në lidhje me paragrafin 45 të Kodit penal.

Prokurori kompetent para gjykatësit të procedurës paraprake në Gjykatën Themelore Shkupi 1, të dyshuarve iu caktoi një propozim për përcaktimin e masave parandaluese dhe atë detyrim që të dyshuarit të paraqiten tek një person i caktuar zyrtar ose në një organ kompetent shtetëror dhe përkohësisht t’iu merrendokumentet e udhëtimit ose dokument tjetër që nevojitet për të kaluar kufirin shtetëror, dhe përkatësisht ndalimin e lëshimit të tyre.”⁸²

4.2.1 PROKURORIA PUBLIKE për ndjekjen e veprave penale të cilat kanë të bëjnë dhe rezultojnë nga përmbajtja e ndjekjes së paligjshme të komunikimeve

“Themelimi, kompetencat, funksionimi dhe struktura e Prokurorisë special publike rregullohen me Ligjin për Prokurorinë publike për ndjekjen e veprave penale të cilat kanë të bëjnë dhe rezultojnë nga ndjekja e paligjshme të komunikimeve (në tekstin në vijim Ligji).

Prokuroria publike udhëhiqet me parimin e barazisë, se të gjithë qytetarët janë të njëjtë para Kushtetutës dhe Ligjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke synuar ta rrisë besimin tek qytetarët ndaj sistemit të drejtësisë duke vepruar në mënyrë transparente dhe të pavarur, për çka garanci është autonomia e prokurorisë.

Funksioni kryesor i kësaj Prokurorie publike brenda sistemit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut është hetimi dhe ndjekja e veprave penale të cilat kanë të bëjnë dhe rezultojnë nga përmbajtja e ndjekjes së paligjshme të komunikimeve.

Ndjekje e paligjshme e komunikimeve definohet si ndjekje e paautorizuar e të gjithë komunikimeve të realizuara në periudhën ndërmjet 2008 dhe 2015, duke i përfshirë, por pa kufizim, audio incizimet dhe transkriptet e dorëzuara në Prokurorinë publike të Republikës së Maqedonisë, para 15 korrikut të vitit 2015.

Prokuroria speciale publike ka mandat 5 vjeçar nga momenti i hyrjes së Ligjit në fuqi. Mandati mund të vazhdohet për një vit me vendim të miratuar nga dy të tretat e shumicës së deputetëve.

⁸²<http://jorm.gov.mk/?p=5422>сопштение 8.08.2018

Prokurori publik i cili qeveris me Prokurorinë publike është i autorizuar të veprojë dhe ti përfaqësojë lëndët para Gjykatës Themelore, të Apelit dhe asaj Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Prokurori publik i cili qeveris me Prokurorinë publike ka autorizim dhe kompetencë të plotë ti kryejë të gjitha funksionet hetimore dhe ato të prokurorisë në Prokurorinë publike.”⁸³

Në vijim të punimit do të paraqesim pyetjet që i kemi dërguar deri të institucioni dhe përgjigjet që i kemi pranuar, të cilat i kemi dërguar nëpërmjet Kërkesës për Qasja në informata me karakter publik deri të Prokuroria Speciale Publike.

Pyetjet e drejtuara deri të PROKURORIA PUBLIKE për ndjekjen e veprave penale të cilat kanë të bëjnë dhe rezultojnë nga përmbajtja e ndjekjes së paligjshme të komunikimeve:
1. Në çfarë mënyrë e zbatoni procesin e zbulimit të abuzimeve në prokurimet publike në Organet shtetërore?
2. A keni zbuluar dhe nëse po, sa raste janë zbuluar rreth abuzimeve të prokurimit publik?
3. Çfarë masash merrni në përputhje me ligjet e Republikës së Maqedonisë për trajtimin e korrupsionit në prokurimet publike?
Përgjigje nga: Prokurori publik për ndjekjen e krimeve të lidhura dhe që rrjedhin nga përmbajtja e përgjimeve të paligjshme të komunikimeve:
Në pajtim me nenin 5 paragrafi 1 në lidhje me nenin 2 paragrafi 1, të Ligjit për Prokurorinë Publike për ndjekjen e krimeve të lidhura dhe që rrjedhin nga përmbajtja e përgjimeve të paligjshme të komunikimeve, Prokuroria Publike për ndjekjen e krimeve të lidhura dhe që rrjedhin nga përmbajtja e përgjimeve të paligjshme të komunikimeve është e autorizuar për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet e lidhura dhe që rrjedhin nga përmbajtja e përgjimeve të paautorizuara.
Përgjimet e paautorizuara të komunikimeve përcaktohen si përgjim i paautorizuar i të gjithë komunikimeve të kryera në periudhën 2008-2015, duke përfshirë por pa u kufizuar vetëm në regjistrimet audio dhe transkriptet e dorëzuara në Prokurorinë Publike para datës 15 korrik 2015. Prandaj, duke vepruar në përputhje me kompetencat ligjore, Prokurori Publik, pas marrjes së

⁸³http://sq.jonsk.mk/?page_id=114

masave për dëgjimin e bisedimeve të publikuara të paraqitura nga opozita, pasi ka përcaktuar se nga pretendimet për një thirrje telefonike, pasi ka pohime se nga bisedat telefonike ka dyshime se janë kryer veprat penale të ndjekura sipas detyrës zyrtare, dhe duhet të formohet dhe të fillohet një procedurë e hetimit paraprak në të cilën do të kontrollohet nëse janë marrë apo jo, veprime të caktuara inkriminuese dhe nga cilat persona.

Kështu, procesi i zbulimit të abuzimeve në prokurimet publike dhe në Organet shtetërore zhvillohet gjatë procedurës paraprake dhe pastaj në procedurën hetimore, e cila bazohet në analizën e dokumentacioneve të përgjithshme të shkruara, që prokuroria publike i mbledh në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Penale, nga organet shtetërore.

Që nga themelimi i kësaj prokurorie publike janë ngritur një numër i madh procedurash para hetimore dhe hetimore, ku janë zbuluar abuzime në procedurat e prokurimeve publike, në gjykatat kompetente janë dërguar 10 (dhjetë) aktakuza me pretendime se janë shkelur dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik

Prokuroria Publike për ndjekjen e krimeve të lidhura dhe që rrjedhin nga përmbajtja e përgjimeve të paligjshme të komunikimeve është e autorizuar për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet e lidhura dhe që rrjedhin nga përmbajtja e përgjimeve të paautorizuara, dhe në kompetencat dhe detyrat ligjore nuk është paraparë të ndërmerren masa për trajtimin e korrupsionit në procesin e prokurimeve publike, përkatësisht Organ kompetent për parandalimin e korrupsionit në prokurimet publike është Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit të Republikës së Maqedonisë.

Në vijim do të paraqesim disa raste se si ka vepruar Prokuroria Speciale Publike në lidhje me keqpërdorimet në sferën e prokurimeve publike.

1. “Prokuroria Speciale Publike në konferencë për shtyp publikoi hetimin për lëndën me kodin “Transportuesi”, i cili u hap më datë 14.04.2016, dhe më 05.04.2017 u dorëzua aktakuza penale për 21 persona për vepër penale “Keqpërdorim i pozitës zyrtare dhe autorizimit” nga neni 353 i Kodit penal të Republikës së Maqedonisë që i referohet transportit të nxënësve në komunën e Manastirit me emrin e shifruar “Transportuesi” ku një nga të dyshuarit është ish kryetari i Manastirit, V.T.

Ish kryetari V.T., në marrëveshje me drejtorët e shkollave fillore dhe disa transportues, dëmtoi buxhetin në vlerë prej 360,000 euro në vetëm dy vite shkollore. Prokurori i Prokurorisë Speciale Publike, F.F. njoftoi se rasti është marrë nga Prokuroria Themelore Publike - Manastir nga provat e mbledhura mund të vërtetohet se komuna e Manastirit nëpërmjet kryetarit të saj ndoshta ka paguar më shtrenjtë se transporti në "Tokio". Pikërisht nga ekspertiza gjyqësore dhe nga faktet materiale të mbledhura prokuroria ka bindje serioze se komuna e Manastirit e përfaqësuar nga Kryetari i komunës nga faktet e mbledhura ka dyshime se ka paguar më shumë para për transportin e nxënësve se sa në Tokio, me pasoja të dëmshme financiare në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në dëm të qytetarëve të këtij vendi. Përkatësisht, ekziston një dyshim i arsyeshëm se kryetari i komunës së Manastirit dhe kryetari i Komisionit për prokurim publik i komunës i themeluar nga kryetari i komunës, në marrëveshje me drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme të Manastirit dhe personat përgjegjës të transportuesve, "Hera-Tours", "Transkup" AD, "Jim Tours", "Bobi Tours", "Jimmy Tours", "Hera Trans", "Transport Hera Trans", "Hera Trans" dhe "Gospesh trans" kanë shkaktuar dëme të përgjithshme të fondeve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë në vlerë prej 22.024.891,00 ose rreth 360,000 euro në vetëm dy vite akademike."⁸⁴

2. "Edhe një hetim me emrin e shifruar "Trust" është hapur më 28.02.2017 dhe më 29.06.2017 është parashtruar aktakuza kundër 3 personave për veprën penale "Keqpërdorim me procedurat për prokurime publike, dhënien e një kontrate të prokurimit publik ose partneritetit publiko-privat" nga neni 275-v i Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë. Kundër tre personave juridik është parashtruar aktakuza për veprën penale Keqpërdorim me procedurat të shpalljes publike, dhënia e kontratës së prokurimit publik ose partneriteti publiko-privat" në bazë të nenit 275-v të Kodit penal të Republikës së Maqedonisë, ku si të dyshuar janë tre persona juridik poashtu edhe udhëheqësi i firmave „Transmet“, „Sileks“ dhe „Bato Dooel Studeniçani Shkup, për pjesëmarrje në tenderin për termocentralet e Maqedonisë (ELEM). Sipas PSP, ELEM ka mundësuar që konsorciumi i këtyre tre kompanive të realizojë një përfitim të paligjshëm të pronës prej mbi 17 milionë euro. Procedura paraprake filloi në bazë të përmbajtjes së tre bisedave nga bisedat e përgjuara të paraqitura në këtë prokurori dy prej të cilave nuk janë publikuar në opinion, përmbajtja e të cilave tregon dyshimin për ligjshmërinë e prokurimit publik për germimin e

⁸⁴https://www.jonsk.mk/?page_id=1012 обвиненија НСК-КО.бр.15/15 Скопје, 05.04.2017 година.

skorieve dhe thëngjillit nga Suvodoli - Manastir. Prokurimi publik, subjekt i këtij hetimi, është realizuar në bazë të një njoftimi të datës 07 tetor 2011 nga “AD Elektrani na Makedonija” Shkup,dhe bisedimet u zhvilluan më 03.08.2011 dhe më 06.10.2011. Në veçanti, ekziston një dyshim i arsyeshëm se më 14 nëntor 2011 në Shkup, i dyshuari i parë si person përgjegjës-menaxhues i personit të dyshuar juridik "Trans Met" DOO Shkup,i dyshuari i dytë si përfaqësues i personit juridik të dyshuar "SILEKS NEMETALI ST" DOOEL Kratovë dhe i dyshuari i tretë si drejtues i personit juridik të dyshuar "VATO" DOO Shkup,kanë shkelur me vetëdije rregulloret për procedurën për dhënien e një kontrate të prokurimit publik dhe i kanë siguruar konsorciumit përfitime të paligjshme të kryera në disa milionë euro.Në të vërtetë, dëshmitë tregojnë një dyshim të arsyeshëm me qëllim shmangien e procedurës për dhënien e kontratës së prokurimit publik, të njëjtët që aplikojnë për fazën e parë në procedurën për prokurime publike si dëshmi për posedimin e pajisjeve teknike për realizimin e prokurimit i cili është kusht i domosdoshëm për pjesëmarrje dhe kualifikim në fazën e dytë të procedurës së prokurimit, ka dorëzuar dokumentacion të rrejshëm për pronësinë e mekanizimit.”⁸⁵

3.“Hetimi i rastit me emrin e shifruar Tanku(Tank) i cili është hapur më 24.01.2017 dhe më 29.06.2017 është parashtruar aktakuza kundër 2 personave për veprën penale "Keqpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar" nga neni 353 i Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë dhe aktakuza kundër një personi për veprën penale "Marrja e një shpërblimi për ndikim të paligjshëm" nga neni 359 i Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në periudhën nga shkurti 2012 deri në fund të tetorit 2012, i pandehuri N.G. si zyrtar, duke keqpërdorur pozitën dhe autoritetin zyrtar, i kërkoi të akuzuarit G.J. - ministër që të kryejë një veprim zyrtar që nuk duhet të kryhet dhe se duhet të bëjë një prokurim publik në të cilin Ministria do të blejë një automjet të markës Mercedes-Benz C 600. kështu që në procedurë të favorizohet operatori ekonomik M.A. DOOEL S. - përfaqësues i përgjithshëm i automjeteve nga marka Mercedes nëRepublikën e Maqedonisësë Veriut, prandaj i pandehuri G.J. me qëllim që ta përmbushë kërkesën e të pandehurit N.G, nxiti të pandehurin G.P. për të kryer një krim “Keqpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar”, i cili nga i akuzuari G.J. u autorizua si ndihmës i Ministrit për të kryer procedurat e prokurimit publik në Ministri dhe të cilit me vendim nr.... nga data 08.02.2012, Ministrit i ishin deleguar plotësisht të gjitha kompetencat për kryerjen e

⁸⁵https://www.jonsk.mk/?page_id=1012обвиненија НСК-КО бр.4/2017 Скопје, 29.06.2017 година

prokurimeve publike, në mënyrë që të mund të keqpërdor pozitën dhe autoritetin zyrtar gjatë kryerjes së prokurimeve publike për të favorizuar në mënyrë të paligjshme operatorin ekonomik M.A.DOOEL S. dhe të porosis një automjet të tillë, në mënyrë që të përmbushë kërkesën e të pandehurit G.J, i akuzuari Gj.P. si ndihmës zyrtar i Ministrit tësektorit për zhvillim të prokurimeve publike, i ka mundësuar operatorit ekonomik M.A.DOOEL S. përfitimin që përfshin dhënien e një kontrate për blerje, servisim dhe mirëmbajtje të një automjeti të pasagjerëve. veturë e blinduar Mercedes-Benz Model S 600 Gard. Kështu që më 03.04.2012 mori vendim për prokurimin publik të mallrave nr ... me 03.04.2012. ku vlera e parashikuar e prokurimit është 30.750.000 denarë ose 500.000 euro pa TVSH, dhe lënda e prokurimit është furnizim me automjet të blinduar, automjet motorik i pasagjerëve me mbrojtje më të lartë VR6/VR7 ku në specifikimin e automjetit në dokumentacionin e tenderit nr. , nga data 03.04.2012 me qëllim që në procedurë mos të ketë konkurrencë, operatori ekonomik M.A.DOOEL S, dhe për favor të saj, ka pasur disa specifikime teknike që i referohen prodhimit për automjetin specifik dhe markave tregtare Mercedes S 600 Gard (markat e regjistruara të Mercedes-Benz D-AG nga Mercedes-Benz, si më poshtë: AIRMATIC, SPEEDTRONIC, PRE-SAFE, THERMOTRONIC, COMAND, DISTRONIC PLUS, GUARD dhe Assist Night View) dhe pa specifikuar se ato mund të jepen edhe ekuivalente me ato të deklaruara në dokumentacionin e tenderit, i cili ka vepruar në kundërshtim me nenin 36 të Ligjit për Prokurim Publik, prandaj për shkak të kushteve dhe specifikimeve teknike që janë dhënë në dokumentacionin e tenderit gjatë procedurës nr ... vetëm operatori ekonomik M.A.DOOEL S. paraqiti një ofertë më 15 maj 2012 dhe ishte ofertuesi i vetëm, dhe pastaj i akuzuari Gj.P. edhe pse ishte në dijeni të favorizimit të paligjshëm të operatorit ekonomik dhe shfrytëzimit joracional të fondeve të ministrisë, më 30.05.2012 mori një vendim nr. . për përzgjedhjen e ofertës më të favorshme, dhe më 11.06.2012. është nënshkruar kontrata e prokurimit publik me nr. nga 11.06.2012. nga M.A.DOOEL S. dhe me nr. 08.06.2012. të Ministrisë me vlerë të kontratës prej 29.852.542 denarë edhe shumën e TVSH prej 5.373.458 denarë, ku nënshkruesi i Ministrisë është i pandehuri Gj.P., dhe nënshkruesi i M.A.DOOEL S. është dëshmitari Z.M. dhe në bazë të marrëveshjes nga Ministria me M.A.DOOEL S. të datës 29 tetor 2012, i ishte paguar gjithsej 35.226.000 denarë, edhe pse të pandehurit e dinin se blerja e një automjeti të tillë të ri ishte jashtëzakonisht e shtrenjtë, në kushtet e reduktimit të fuqisë blerëse ekonomike të ministrisë, dhe

megjithëse prokurimi publik është kryer sikur të ishte për nevojat e Ministrisë, i akuzuari G.J. nxiti të akuzuarin Gj.P. për të kryer krimin në mënyrë që automjeti nga Ministria ti jepet të pandehurit N.G., i cili dëshironte të përdor një makinë të tillë të re të blinduar, por nuk dëshironte që opinioni të zbulojë se si një zyrtar përdor një makinë të tillë luksoze. Me atë që i akuzuari G.J. e ka kryer vepër penale “Keqpërdorim i pozitës zyrtare dhe i autoritetit” në bazë të nenin 355 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 1 në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal, i pandehuri Gj.P. ka kryer vepër penale duke keqpërdor pozitën dhe autoritetin zyrtar sipas nenit 353 paragrafi 5 në lidhje me paragrafin 1 të KP, i pandehuri N.G. ka kryer një vepër penale “pranimi i një dhurate të paligjshme” sipas nenit 399 paragrafi 2 i Kodit Penal.”⁸⁶

4.Në rastin “Trajektorja” të Prokurorisë Speciale Publike, në të cilën akuzohen ish-kryeministri N.G., ish-zëvendëskryeministri V.P., ish-ministri i Transportit dhe Lidhjeve, M.J.dhe ish-drejtori i Agjencisë për rrugë shtetërore, L.G.,të cilët dyshohen se në gjysmën e dytë të vitit 2012 dhe gjatë vitit 2013 kanë ndërmarrë më shumë veprime, me të cilat në procedurën për zgjedhje të kompanisë për ndërtimin e akseve rrugore Milladinovc – Shtip – dhe Kërçovë – Ohër i kanë tejkaluar autorizimet e tyre. Me këtë ata i kanë shkaktuar dëm buxhetit shtetëror prej 155.117.172 euro, ndërsa kompanisë kryerëse i kanë mundësuar që të bëhet me pronë22.05.2017dhe më 29.06.2017 është parashtruar aktakuza kundër 3 personave me iniciale V.P., M.J. dhe L.G. për krimin "Keqpërdorim të pozitës dhe autorizimit zyrtar" nga neni 353, paragrafi 5, paragrafi 1 të nenit 22 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe njëAktakuzë me propozim të prokurorisë kundër personit me iniciale N.G. për një vepër penale "Marrja e një shpërblimi të paligjshëm" nga neni 359 paragrafi 2 i Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjatë periudhës nga tetori 2012 deri në tetor 2013 në Shkup të iniciuara me qëllim nga i akuzuari G.N, i pandehuri V.P. si person zyrtar Zëvendës i Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, M.J. si person zyrtar ministër dhe L.G. si person zyrtar i Drejtorit të NP Rr.M.,bashkëpjesëmarrës në procedurëkanë rënë dakord për zgjedhjen e një kompanie që do të ndërtojë seksione të autostradës. M.- Sh. dhe K.-O. Ikanë ushtruar kompetencat e tyre zyrtare për kompaninë S.C.L. dhe kanë fituar përfitime pronësore në shumën prej 155.117.256 euro, ose 9.569.183.522.00 denarë dhe i kanë shkaktuar dëm Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në atë mënyrë që i pandehuri N.G. me synimin për ti

⁸⁶https://www.jonsk.mk/?page_id=1012обвиненијаНСК – КО бр.3/17 Скопје, 29.06.2017 година.

mundësuar kompanisë S.C.L. të ndërtojë seksione të autostradës e përdori ndikimin e tij të vërtetë dhe pozitën zyrtare dhe u kërkoi të pandehurve V.P., M.J. dhe L.G. për të kryer një veprim zyrtar që nuk duhet ta kryejnë - për të anashkaluar zbatimin e Ligjit mbi Prokurimin Publik në favor të listës së kompanive të rekomanduara nga Ministria e N. R. K., dokumentacionin e projektuar në nëntor e kanë dorëzuar vetëm tek kompanitë S.C.L dhe C.W.E të cilat kompani S.C.L dhe C.W.E kanë dorëzuar oferta paraprake, ofertat e para për seksionin e autostradës M-Sh, për të cilën të pandehurit V.P. dhe M.J. së pari kanë biseduar me të dy kompanitë, ndërsa për seksionin e autostradës K-O, me kërkesë të të pandehurit N.G. kanë filluar procedurë me bisedime vetëm me Kompaninë S.C.L duke e përjashtuar nga procedura me bisedime kompaninë C.W.E, dhe në një procedurë jo konkurruese në muajin maj 2013, të pandehurit V.P., M.J., dhe L.G. me kompaninë S.C.L arritën të nënshkruajnë një marrëveshje të harmonizuar për ndërtimin e pjesës së autostradës M-Sh, me vlerë prej 226.696.367 euro, që përfshin llogarinë e pranuar të objektit prej 206.087.607 euro dhe shumën e përkohshme prej 10% prej 20.608.760 euro, pa TVSH, ndërsa për pjesën e autostradës K-O, edhe pse nga i akuzuari L.G. u informuan se çmimet e korigjuara të projektit nga JPDP për koston e autostradës K-O arritën në 266.730.000 euro dhe ata e dinin se gjatë negociatave me kompaninë S.C.L, kompania C.W.E. ka dorëzuar një ofertë shtesë me çmim më të ulët për autostradën K-O në vlerë prej 369 milion euro dhe në realitet kishte një kosto më të ulët për ndërtimin e kësaj autostrade, me kompaninë S.C.L, ka arritur dhe ka nënshkruar një kontratë të harmonizuar për ndërtimin e pjesës së autostradës K-O me vlerë prej 411.287.800 euro, e cila përfshin llogarinë e pranuar të lëndës prej 373.898.00 euro dhe shumën e përkohshme prej 10% prej 37.389.800 euro pa TVSH, pas së cilës për shkak të përmbushjes së kushteve për marrjen e një kredie nga C.E.B e cila kërkonte një kontratë të nënshkruar me kompaninë që ishte përzgjedhur për të kryer punimet me qëllim që të jepte një kornizë ligjore për përzgjedhjen e paligjshme tashmë të kryer të një kontraktuesi më 10.10.2013 i pandehuri V.P., në emër të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, propozuesi dhe i akuzuari M.J. si përfaqësues i Qeverisë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ka paraqitur projektligjin për realizimin e projekteve të infrastrukturës për ndërtimin e rrugës M-Sh. dhe pjesës rrugore K-O, në të cilën si kompani që do ti ndërtojë autostradat, propozoi kompaninë S.C.L. si për dy seksione të autostradës për të cilin propozim i paraqiti kontratat e harmonizuara dhe të parafraguara me kompaninë S.C.L, duke treguar në mënyrë të rrejshme që oferta e kompanisë S.C.L. është oferta

më e favorshme duke mbuluar ofertën shtesë më të ulët të C.W.E. për autostradën K-O. Prandaj deputetët duke besuar se të dhënat në projektligjin e paraqitur janë të sakta dhe se miratimi i Ligjit është i dobishëm për Republikën e Maqedonisë së Veriut kanë votuar Ligjin për Realizimin e Projekteve të Infrastrukturës për Ndërtimin e Sektorit të Rrugëve M.Sh. dhe rruga seksion K-O, dhe pas miratimit të Ligjit në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, të akuzuarit V.P., M.J. dhe L.G. nënshkruan kontratat e nënshkruara më parë për ndërtimin e autostradave dhe kompania S.C.L. fitoi një përfitim në pronë në vlerë prej së paku 155.117.256 euro ose 9.569.183.522.00 denarë mbi vlerën ekonomike të ndërtimit të seksioneve të autostradës për të cilën shumë i shkaktuan dëm Buxhetit të Republikës së Maqedonisë. Me atë që i pandehuri N.G. ka kryer një veprë penale “Pranimi i një shpërblimi për ndikimin të paligjshëm” sipas nenit 399 paragrafi 2 të Kodit Penal dhe të pandehurit V.P., M.J. dhe L.G. kanë kryer veprë penale “Keqpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar” nga neni 353 paragrafi 5 v.v. me paragrafin 1 dhe nenin 22 të KP.”⁸⁷

5. “Hetimi në rastin e koduar "Tarifa" u hap më 01.24.2017 dhe në 29.06.2017 është parashtruar aktakuza kundër tre personave për veprën penale "keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit" sipas nenit 353 të Kodit Penal, si më poshtë:

- D.B. për veprën penale "keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit" sipas nenit 353 paragrafi 5 VV me paragrafin 1 të Kodit Penal;
- M.S tre krime për "keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit" sipas nenit 353 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 4 v.v. paragrafi 1 v.v. Neni 45 i Kodit Penal dhe krim “keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit” nga neni 353 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 4 c.v. paragrafi 1 i KP;
- N.G. për tre vepra penale "keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit" nga neni 353 paragrafi 5 v.v. me paragrafin 4 v.v. paragrafi 1 v.v. Neni 45 i ligjit penal dhe një veprë penale "Keqpërdorim i pozitës zyrtare dhe autoritetit” nga neni 353 paragrafi 5 c.v. me paragrafin 4 c.v. paragrafi 1 i KP. Në rastin konkret ekziston dyshimi se është bërë keqpërdorimi i detyrës zyrtare nga persona zyrtar dhe përgjegjës në procedurën për furnizim publik me softuer - ERP Sistem për nevojat e Sh.A “ELEM”, gjatë të cilës, personat e dyshuar me mos kryerjen e obligimit i kanë mundësuar personit fizik - konsorcium, i cili më vonë ka fituar tenderin, që të kualifikohet

⁸⁷https://www.jonsk.mk/?page_id=1012 обвиненија НСК-КО. бр.9/17 Скопје, 29.06.2017 година

në fazën e dytë për të negociuar gjatë ankandit publik, edhe pse nuk ka dorëzuar dokumentacion të plotë. Vlera e Marrëveshjes është 4.09.420 euro. Njëkohësisht, ekziston dyshimi se një pjesë e personave të dyshuar pa bazë kanë miratuar të paguhen mjete në të holla në emër të licencave për mirëmbajtje të softuerit, kjo në kundërshtim me kushtet e posaçme nga Marrëveshja për furnizim publik, ku është e parashikuar se pagesa në emër të licencave për mirëmbajtjen e softuerit do të bëhet në periudhën e garancisë dhe pas-garancisë, periudhë e cila asnjëherë nuk ka filluar të rrjedhë, nga se sistemi nuk është zbatuar, me çka është shkaktuar dëm prej 456.560 euro. Poashtu ekziston dyshimi se një person juridik nga konsorciumi, edhe pse ka qenë subjekt i autorizuar për furnizim dhe zbatim të modulit për menaxhim të dokumentacionit, megjithatë është bërë furnizimi i modulit të tillë nëpërmjet personave tjerë juridik me marrëveshje të posaçme, edhe pse ky modul është parashikuar në Ofertën e konsorciumit dhe për të nuk ka qenë i nevojshëm furnizim i posaçëm. Njëkohësisht ekziston dyshimi se pas furnizimit të modulit për menaxhim të dokumentacionit, një nga personat e dyshuar ka lëshuar certifikatë për pranim operativ të modulit, që është kusht për miratim të pagesës në bazë të zbatimit të modulit, edhe pse ekzistojnë argumente të shkruara se moduli nuk është vënë në funksion. Në bazë të certifikatës së tillë, një pjesë e të dyshuarve kanë miratuar rroga në vlerë prej 16.800 euro. Nga faktet, del edhe ajo që është më e rëndësishme, se një pjesë e madhe e sistemeve nuk janë zbatuar, edhe pse për to janë paguar 3.700.000 euro, ndërsa në përputhshmëri me Marrëveshjen për furnizim publik, sistemi është dashur të zbatohet deri 11.02.2013. Në veprimet e përshkruara më lart, të pandehurit kanë kryer vepra penale:

-I pandehuri N.G. dhe M.S. ka kryer veprë penale “keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit” sipas nenit 353, paragrafi 5 v.v, në lidhje me paragrafi 4, lidhje me paragrafi 1 v.v të Nenit 45 të Kodit Penal;

-Të pandehurit N.G. dhe M.S. kanë kryer veprë penale “keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit” në bazë të nenit 353, paragrafi 5 v.v, me paragrafi 4 v.v në paragrafi 1 të Nenit 45 të Kodit Penal;

- I akuzuari N.G. dhe MS. kanë kryer veprë penale “keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit” nga Neni 355, paragrafi 5, v.v lidhje me paragrafi 1, 4 v.v, lidhje me paragrafi.1 v.v, Neni 45 të Kodit Penal.

- I pandehuri D.B. ka kryer veprë penale “keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit” nga neni 353 paragrafi. 5 v.v në lidhje me paragrafi 1 të Kodit Penal, ndërsa i akuzuari N.G. dhe M.S.kanë kryer veprë penale “keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit” nga neni 353 paragrafi 5 v.v në lidhje me paragrafi 1 të Kodit Penal.”⁸⁸

6.“Hetimi i çështjes me "Tenderët"është hapur më 20 tetor 2016 dhe më 29 qershor 2017 është parashtruar aktakuza kundër 3 personave për veprën penale "keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit" nga neni 353 i Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë, si më poshtë:

- E.K.M. për veprën "Keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit" nga neni 353, paragrafi 5, v.v. me paragrafin 1 v.v. me nenin 22 të KP;
- LLC për veprën "Keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit" nga neni 353, paragrafi 5, v.v. me paragrafin 1 v.v. me nenin 22 të KP;
- J.U. për veprën "Keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit" nga neni 353, paragrafi 5, v.v. me paragrafin 1 në v.v. me nenin 22 të Kodit Penal.

Në periudhën prej qershorit 2011 deri më 05.08.2011, në Shkup, i akuzuari i parë E.K.M. si ministre zyrtare dhe punonjësee Ministrisë – zyrtar, i akuzuari i dytë L.L.C si anëtar i komisionit për prokurim publik dhe i akuzuari i tretë J.U. si kryetar i komisionit për prokurim publik, duke keqpërdorur pozitën zyrtare dhe autorizimin, gjatë kryerjes së prokurimeve publike, si bashkë-pjesëmarrës i kanë mundësuar operatorit ekonomik “GTD B. Sh AD Sh”. përfitim i përbërë nga privilegje të paligjshme - favorizim për realizimin e punëve për ndërtimin të objektit “Muzeu i Luftës Maqedonase për Shtetësi dhe Pavarësi - Muzeu i Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase dhe Muzeu i Viktimave të Regjimit Komunist" në Shkup, në atë mënyrë që, përpara shpalljes së njoftimit për dhënien e kontratës së prokurimit publik dhe para fillimit të procedurës, në kundërshtim me parimet që parashikojnë ligjshmërinë e prokurimit publik të përmendur në nenin 2 të Ligjit mbi Prokurimin Publik dhe në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit për prokurimin publik, përpara se të merret vendimi për nevojën e prokurimit publik i akuzuari i parë ka biseduar me dëshmitarin I.B. i cili ka qenë Drejtor i Përgjithshëm i “GTD B. Sh AD Sh”duke i thënë “GTD B. Sh AD Sh” për të vazhduar punën në ndërtesën ku më parë kanë kryer punë në bazë të një kontratë të prokurimit publik të lidhur më parë për ndërtimin e kompleksit të muzeut,për të kryer të gjitha punët që kanë dalë në mënyrë plotësuese dhe të cilat

⁸⁸https://www.jonsk.mk/?page_id=1012обвиненијаНСК – КО бр. 2/17 Скопје, 28.06.2017 година.

nuk janë mbuluar në kontratën e prokurimit publik dhe anekset e tij, dhe për të mos pritur njëzet ditë për zbatimin e prokurimit të ri publik dhe se i akuzuari i parë kishte rënë dakord tashmë me të akuzuarin e dytë në komisionin e prokurimit publik pas publikimit të shpalljes që kontrata ti jepet “GTD B. Sh AD Sh”, kështu që kompania e ndërtimit “GTD B. Sh AD Sh” ndërkohë ka kryer punimet përfundimtare të ndërtimit të objektit të ndërtesës në përputhje me kërkesat e komisionit të parë dhe më pas më 20 qershor 2011, pas shpalljes për dhënien e prokurimit publik nr...

ku Organ kontraktues është Ministria dhe lënda e kontratës ka qenë ekzekutimi i punimeve përfundimtare të ndërtimit dhe artizanatit të Muzeut, për shkak të kushteve të dhëna në shpallje dhe në dokumentacionin e tenderit vetëm operatori ekonomik “GTD B. Sh AD Sh” më 18 korrik 2011 mori pjesë në procedurë si ofertuesi i vetëm duke dorëzuar një ofertë në procedurën e prokurimit publik dhe megjithëse të gjithë të akuzuarit e dinin se “GDD B. Sh AD Sh” tashmë i kryen aktivitetet e objektit të të cilat janë theksuar në shpalljen për dhënien e një prokurimi publik nr/...megjithatë, i akuzuari i dytë dhe i tretë, si anëtarë të komisionit për prokurim publik, përpiluan dhe nënshkruan një raport nga procedura e zhvilluar më 19.07.2011, se ofertuesi më i volitshëm është “GTD B. Sh AD Sh”, i cili raport është nënshkruar nga dëshmitari A.N. si anëtar i komisionit i cili nuk e dinte se “GDD B. Sh AD Sh” tashmë i kryen aktivitetet e objektit të shënuara në njoftimin e shpalljes për dhënie të kontratës dhe më 26.07.2011 vendimi për përzgjedhjen e ofertës më të favorshme është nënshkruar nga i akuzuari i parë dhe më 05.08.2011 kontrata e prokurimit publik është arkivuar me datën 05.08.2011 nga “GTD B. Sh AD Sh” dhe me nr. ... 04.08.2011 të Ministrisë, me vlerë të kontratës prej 62.480.543 denarë ku nënshkruesi i Ministrisë është i akuzuari i parë dhe nënshkruesi i “GTD B. Sh AD Sh” është dëshmitari I.B., me të cilën E.K.M i akuzuari i parë, i akuzuari i dytë L.L.C. dhe J.U. i akuzuari i tretë, si bashkëkryerës të veprës, kanë kryer vepër penale “Keqpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar” në bazë të nenit 353 paragrafi 5 në lidhje me paragrafin 1 në lidhje me nenin 22 të KP.”⁸⁹

7.“Edhe tek një hetim me emrin “Pacienti” sipas PSP-së, ekziston dyshim i bazuar për shpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar të zyrtarëve dhe personave përgjegjës në procedurat e prokurimit publik për të kryer punë ndërtimore dhe vepra zejtare në më shumë objekte të

⁸⁹https://www.jonsk.mk/?page_id=1012 обвиненија НСК – КО бр.10/16 Скопје, 29.06.2017 година.

shëndetit publik në të gjithë vendin. Hetimi përfshin 15 persona, mes tyre dhe ish-Ministrinë Shëndetësisë, B.O.

Ekziston dyshimi bazë se në vitin 2010 katër nga të dyshuarit, F.A., B.L., M.I. dhe Zh.Ç., si persona përgjegjës: Kryetar dhe anëtarë të Komisionit për prokurimin publik në Ministrinë e Shëndetësisë, në kryerjen e prokurimit publik nr. 02/2010 për kryerjen e punëve ndërtimore dhe ndërtimore-zejtare në më shumë institucione publike shëndetësore në të gjithë vendin, kanë paraqitur një propozim të paligjshëm për përzgjedhjen e tenderit fitues. Ndërkaq i dyshuari, B.O., Ministër i Shëndetësisë, në vend që të refuzojë propozimin e Komisionit, ka marrë vendim për përzgjedhjen e ofertës më të favorshme të ofertuesit “GBS – Blagoevgrad – Republika e Bullgarisë” thuhet në kumtesën e PSP-së. Sipas po të njëjtit burim, nga dëshmitë e siguruara kuptohet se anëtarët e dyshuar të Komisionit e kanë favorizuar ofertuesin GBC – Blagoevgrad, edhe pse e kanë ditur se ofertuesi nuk i plotëson kushtet e dokumentacionit të tenderit.

“Ata e kanë ditur se në fakt, ofertuesi nuk i ka poseduar kompetencat e nevojshme për performancën e inxhinierëve, ndërsa në përlllogaritjet e lëndës që janë pjesë e ofertave, nuk kanë bërë as përmbledhjen e saktë të të dhënave dhe si pasojë nuk kanë arritur në përfundim se oferta e kompanisë Ingra Zagreb është për 637,303.00 denarë më e lirë se ajo e GBS – Blagoevgrad”, thonë nga PSP. Edhe pse e gjithë kjo ka qenë e ditur për ish-Ministrinë e Shëndetësisë, ai nuk ka hedhur poshtë propozimin, por ka marrë vendim për të zgjedhur ofertën e GBS – Blagoevgrad si ofertë më të lirë, edhe pse vlera e ofertës ka qenë më e lartë se vlera e vlerësuar në prokurimin publik dhe kështu subjektit juridik i ka mundësuar përfitim në pronë në shumë prej 21,604,150.59 denarë, sipas PSP. Sipas prokurorëve të PSP-së, njofton gjatë vitit 2010, të njëjtët të dyshuar: F.A., B.L., M.I. dhe Zh.Ç., në një procedurë tjetër prokurimi, me numër 03/2010 për kryerjen e punëve ndërtimore dhe ndërtimore-zejtare në ISHP “Spitali i përgjithshëm Ohër” në mënyrë të paligjshme kanë dorëzuar propozim për zgjedhjen e ofertës më të mirë dhe përsëri kanë zgjedhur ofertën nga GBS – Blagoevgrad i cili ende nuk i ka plotësuar kompetencat e nevojshme për inxhinier të performancës, dhe kështu nuk i ka plotësuar dhe kërkesat e dokumentacionit të tenderimit. Ish Ministri i Shëndetësisë, B.O., e ka pranuar këtë propozim dhe ka lidhur kontratë me ofertuesin GBS – Blagoevgrad në vlerë prej 127,533,691 denarë. Sipas dëshmimeve të Prokurorisë Speciale Publike të Maqedonisë, gjatë vitit 2013 në një procedurë

prokurimi publik nr. 07/2010 për rikonstruktimin dhe ri-ndërtimin e ISHP “Spitali Klinik Tetovë”, të dyshuarit: Dellçe Arsoski si udhëheqës dhe Damir Lonçariq si menaxher në kompaninë “Ingra Zagreb” filialit të “Ingra Shkup”, kanë nënshkruar dhe certifikuar dokumentacionin përfundimtar me të dhëna të pavërteta në lidhje me sasinë e materialeve për ndërtim dhe cilësinë e tyre. Më pas, dokumentacioni përfundimtar është dorëzuar deri te mbikëqyrësit përgjegjës, të dyshuarit A.I., A.D. dhe Z.Z., të cilët duke mos i kontrolluar sasinë, e kanë nënshkruar dhe e kanë aprovuar dokumentacionin. I dyshuari, L.M. si inxhinier përgjegjës në Njësinë për Rikonstruktim dhe Rindërtim në Ministrinë e Shëndetësisë së Republikës së Maqedonisë, e ka miratuar dokumentacionin pa e kontrolluar, dhe gjithashtu nuk ka kërkuar të aktivizohet garancia bankare për jo-cilësi. Sipas PSP-së, dokumentacioni përfundimtar ka qenë bazë për pagesën e parave, të cilat janë paguar. Me këtë pagesë është dëmtuar Buxheti i shtetit në vlerë prej 719,470.00 denarë, ndërsa kompania INGRA Zagreb – Dega Ingra Shkup ka përfituar të ardhura që arrijnë shumën e 6,005,461.00 denarë. Sipas PSP-së, gjatë vitit 2012 në procedurën e prokurimit numër 02/2010 për rindërtimin e Spitalit të Çairit, i dyshuari A.N. si udhëheqës i punës në kompaninë GBS – Blagoevgrad, e cila ka qenë e kontraktuar për të kryer punët ndërtimore, ka përgatitur dokumentacion përfundimtar me të dhëna të rreme në lidhje me sasinë e materialeve për ndërtim dhe cilësinë e tyre. Ky dokumentacion i është dorëzuar të dyshuarit D.I., i cili si mbikëqyrës përgjegjës e ka konfirmuar, ndërsa më pas të dyshuarit J.N., specialiste për punë ndërtimore dhe S.T.N, menaxhere e Njësisë për projektim në Ministrinë e Shëndetësisë, duke mos e kontrolluar sasinë e materialeve, e kanë nënshkruar dhe e kanë aprovuar dokumentacionin përfundimtar që ka qenë bazë për pagesën e parave, të cilat janë paguar. Me këtë pagesë është dëmtuar Buxheti i shtetit në vlerë prej 1568.828 denarë.”⁹⁰

4.3. Roli i gjykatave në parandalimin e korrupsionit

4.3.1. Gjykatën Themelore

“Meqë ekzistojnë vepra penale të llojllojshme për nga rëndësia e tyre dhe gjykata të ndryshme si për nga lloji ashtu edhe për nga numri i tyre, është e domosdoshme që ndërmjet gjykatave të

⁹⁰<https://www.jonsk.mk/?p=1842>

bëhet ndarja e punës në çështjet penale në mënyrë që të dihet se cila gjykatë duhet të veprojë në një çështje penale konkrete. Në bazë të kësaj që u tha shihet se ekzistojnë disa kriteret për përcaktimin e kompetencës së gjykatës penale; - lloji dhe rëndësia e veprës penale, vendi në të cilin gjykata e ushtron funksionin e gjykimit, cilësia e kryerësit të veprës penale dhe lloji i veprimeve procedurale-penale.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut procedohen të gjitha çështjet penale në gjykatë themelore si gjykatë e shkallës së parë. Në gjykatat themelore në Manastir, Tetovë, Shkup I, dhe Shtip parashihet formim i seksioneve gjyqësore të specializuara, të cilat kanë kompetencë lëndore për gjykim të veprave nga lëmi i krimit të organizuar, ndërsa kompetenca territoriale e tyre është mjaftë e zgjeruar me që në këtë segment e mbulon gjithë territorin e RMV (neni 32 i LGJRM).⁹¹ Në vijim do të paraqesim disa raste se si ka vepruar Gjykata në lidhje me keqpërdorimet në prokurimet publike.

1. Departamenti për Krim të Organizuar dhe Korrupsioni në Gjykatën Themelore Shkup 1, vendosi lidhur me rastin Tanku. Ish-ministrja e Punëve të Brendshme e Maqedonisë G.J. u dënua me gjashtë vjet burg për furnizimin e “Mercedezit luksoz” C600 për të cilin Prokuroria Speciale Publike ngriti aktakuzën e njohur si rasti “Tank”. Aktgjykimin e shqiptoi kryetarja e Këshillit gjyqësor D. K. G.J nuk mori pjesë në shqiptimin e aktgjykimit. Në seancë ishin vetëm avokatët e saj dhe përfaqësuesit e PSP-së. Gjykimi për G.J., u veçua para disa muajve si procedurë për shkak të shtatzënisë së saj, ndërsa filloi në fund të muajit gusht 2018, pasi e pandehura kishte lindur. Në rastin “Tank” tani më janë dënuar ish-kryeministri N.G. me dy vjet burg dhe ish-ndihmës ministri në MPB, Gj.P. me gjashtë vjet e gjashtë muaj burg, për furnizimin e automjetet të blinduar “Mercedes C600 Gard” me vlerë prej 600.000 eurosh. Të dy paraqitën ankimime në Gjykatën e Apelit për gjatësinë e dënimeve. Apeli nuk e pranoi ankimimin e N.G. dhe ia konfirmoi dënimin me burg prej dy vitesh. Gj.P. aktgjykimi iu ndryshua në katër vjet e gjysmë.

2. Gjykatësja L.T.Z, e cila është kryetare e këshillit gjyqësor për lëndën “Trust”, e lexoi Aktgjykimin për të akuzuarit në këtë rast. I akuzuari i parë i rastit S.K. është dënuar me gjashtë vjet burg për veprën penale “Keqpërdorim të procedurës për thirrje publike, ndarje të marrëveshjes për prokurim publik ose partneritet publiko-privat”, ndërsa i akuzuari V.A., i cili nuk ishte i pranishëm në sjelljen e aktvendimit me arsyetim se nuk ndjehet mirë, për veprën e

⁹¹Sait.E, Zejneli.I, E Drejta E Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup 2017, fq 79,80,81

njëjtë penale është dënuar me tre vjet burg. I akuzuari i tretë S.V. u lirua nga akuza, gjegjësisht vepra për të cilën akuzohej nuk është vepër penale sipas ligjit. Gjykatësja shtoi se firmat nga arkat e firmave “Sileks” dhe “Transmet”, të cilat janë përgjegjëse për veprën penale duhet të paguajnë 2 milionë denarë gjobë të cilat duhet t’i paguajnë në afat prej 30 ditësh. S.K. ka marrë ndalesë që për tre vjet të jetë menaxher i ndonjë Organi drejtues të ndonjë firme, ndërsa V.A. të nënshkruajë marrëveshje për prokurime publike në emër të dikujt tjetër. Gjykata gjithashtu vendosi që t’u konfiskohet pasuria prej 17 milionë eurove që do të kthehen në buxhetin shtetëror. Prokurori i Prokurorisë Speciale Publike (PSP), G.B. tha se janë të kënaqur nga vendimi i gjykatës për konfiskim, sepse për herë të parë konfiskohet pasuri në lartësi të shumës së plotë të tenderit. Sipas G.B., tashmë janë siguruar 90 për qind që duhet të konfiskohen në pasuri të tundshme dhe të patundshme. Të akuzuarit S.K., V.A. dhe S.V., para Gjykatës gjatë seancës kaluar u shprehën se nuk ndejnë faj për veprën për të cilën akuzohen. S.K. në fjalët përfundimtare tha se nuk ndjehet fajtor, sepse nuk ka pasur kurrfarë qëllimi të shkelë ndonjë ligjduke thënë: “pranë të thatit digjet edhe i njomi”, dhe shtoi se qëllimi i vetëm ka qenë të jenë konkurrent në treg dhe të sigurojë punë për të punësuarit e tij dhe familjet e tyre. Ai potencoi se nuk i ka kontrolluar dokumentet për këtë rast para se t’i nënshkruajë, edhe pse si menaxher ka pasur obligim të tillë. “Si menaxher, edhe pse e kam pasur të obliguar t’i kontrolloj të gjitha dokumentet para se t’i nënshkruaj, nuk e kam bërë këtë duke besuar fuqishëm në ekipin tim”, tha S.K. Edhe V.A. në fjalët përfundimtare u shpreh se nuk ndjehet fajtor për veprën për të cilën akuzohet. Sipas tij, akuza është e pabazë dhe plotësisht e ka rrezikuar gjendjen e tij shëndetësore. I akuzuari S.V. në fjalët përfundimtare, gjithashtu, tha se nuk ndjehet fajtor dhe pret të miratohet shfajësimi. Përfaqësuesja e “Transmet” SHPK Shkup, S.A. tha se përfshihet në fjalët përfundimtare të avokatëve mbrojtës të personit juridik dhe në tërësi qëndron pas tyre. Ajo potencoi se pret aktgjykim shfajësues për personin juridik “Transmet” SHPK Shkup. Avokati J.J., i cili është përfaqësues i personit juridik “Sileks nemetali ST” tha se Gjykata në mënyrë korrekte e ka udhëhequr procedurën e tërësishme dhe pret të sillet aktgjykim shfajësues për të gjithë. Sipas tij në këtë lëndë nuk ka elemente të veprës penale për të cilën ngarkohen të gjithë të akuzuarit. PSP kërkoi tre të akuzuarit të dënohen, ndërsa firmat “Transmet SHPK Shkup dhe “Sileks nemetali ST” përmes konfiskimit të kthejnë në buxhetin shtetëror 17 milionë euro. Përveç kërkesës për konfiskim të pronës, PSP vendosi të akuzuarin e tretë në këtë rast S.V. ta përndjekë

për ndihmë dhe e tërhoqi akuzën për firmën e tij “Vatio” SHPK Studeniçan. Sipas akuzës, të dyshuarit kanë formuar konsorcium dhe me dokumente të rrejshme kanë marrë tender për gërmimin e zgjyrës në REK Bitola.

3. Nëntë vite burg për ish ndihmës- ministrin e brendshëm, Gj.P. Gjykata e shpalli fajtorë për shpërdorimin e detyrës zyrtare gjatë furnizimit të 300 automjeteve të reja të policisë. “I akuzuari Gj.P. është fajtor për veprën penale shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit nga neni 353 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 1 nga Kodi Penal. Në përputhje me dispozitën e përmendur ligjore si dhe nenet 4, 32, 33, 34, 35 dhe 39 nga Kodi Penal, gjykata e dënon të akuzuarin Gj.P. me dënim me burg prej 9 viteve – lexoi vendimin gjykatësi.Prokuroria Speciale kërkoi që ish zyrtarit të lartë menjëherë t’i shqiptohet paraburgimi për shkak të frikës nga arratisja. “Për shkak të ekzistimit të rrezikut nga arratisja, propozoj që kundër të akuzuarit Gj.P. të përcaktohet masa e paraburgimit si masë e cila në këtë moment paraqet mekanizmin e vetëm që ofron garanci për sigurimin e pranisë së tij – kërkoi prokurorja speciale F.F”. *As që kam mundësi, e as nevojë, e as që dua, e as që kam menduar të arratisem – u përgjigj i pandehuri Gj.P.*”.Megjithatë Gjykata pranoi kërkesën për paraburgim dhe Gj.P. menjëherë është dërguar në burgun e Shuto Orizarës. Avokati S.Z. i cili përfaqëson Gj.P. do ta ankimojë dënimin e lartë me burg në Gjykatën e Apelit.“Të shqiptohen nëntë vite për veprën penale të kryer para 10 viteve në furnizim publik për të cilin tani ekziston interpretim i ndryshëm i rregullave nëse janë zbatuar si duhet ose jo, konsideroj se është çështje për të cilën nuk duhet komentuar. Do të tentoj të përmbahem, këtë e kërkoj edhe Gjoko nga unë në mënyrë dinjitarë – deklaroi avokati i Gj.P., S.Z”. Popovski është dënuar për shpërdorim të detyrës zyrtare gjatë furnizimit të automobilitave për policinë përderisa ishte ndihmës-ministër i në MPB. Për veprën për të cilën e ndiqte PSP ishte parashikuar dënim me burg prej minimum katër deri në 15 vite.

4.3.2 Gjykatat e apelit

Gjykatat e apelit janë gjykata të shkallës së dytë të cilat vendosin kundër ankesave të vendimeve të gjykatave themelore, dhe kryejnë punë tjera sipas ligjit (neni 33 i LGjRMV). Gjykata e apelit i sjell vendimet në përbërje kolegjiale në kolegji prej tre gjyqtarësh ose prej pesë

gjqtarësh dhe në trup gjykues të madhkur hap shqyrtimin gjyqësor në bazë të nenit 22 paragrafi 2 i LGjRMV.⁹²

4.3.3 Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut

“Gjykata Supreme vendos në shkallë të dytë kundër kolegjeve kur është e përcaktuar me ligj, vendosë në shkallë të tretë dhe të fundit ndaj ankesave kundër vendimeve të gjykatave të apelit në bazë të nenit 439 të LPP, vendos për mjete të jashtëzakonshme juridike të paraqitura kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatave dhe vendimeve të kolegjeve të veta siç është e paraparë me ligj, vendos për ndeshje të kompetencave midis gjykatave themelore nga territori i gjykatave të ndryshme të apelit, për ndeshje të kompetencave midis gjykatave të apelit, dhe vendos për bartjen e kompetencës vendore te këto gjykata, vendos për kërkesat e palëve dhe të pjesëmarrësve të tjerë procedural të paraqitura për shkak të cenimit të së drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm në procedure të përcaktuar me ligj para gjykatave të RMV, dhe kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj, në nenin 37, paragrafi 3 i LGjRMV. Gjykata Supreme vendos lidhur me ankesë në shkallë të tretë në kolegji prej pesë gjyqtarësh dhe varësisht nga pesha e veprës penale ajo vendos edhe në kolegje prej tre gjyqtarësh.”⁹³

Në vijim do të paraqesim një rast të Gjykatës së Apelit që vendos për ankesën kundër vendimit të gjykatës themelore.

-Gjykata e Apelit e ka ndërprerë vendimin e shkallës së parë për rastin e PSP-së, “Treqind”, Gjykata e Apelit e shfuqizoi vendimin prej 9 vjet burg për ish-ndihmës ministrin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Gj.P. për prokurim në mënyrë joligjore të 300 veturave të MPB-së. Automatikisht shfuqizohet edhe vendimi që t’ia kompensojë dëmin MPB-së prej 28 milionë denarë në këtë lëndë të njohur me “Treqind”. Aktgjykimin me 22 maj 2018 e shqiptoi gjykatësja D.K. Gjykata e Apelit ia shfuqizoi vendimin dhe e ktheu në rigjykim në Gjykatën Themelore Shkupi 1.

⁹²Saiti.E, Zejneli.I, E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup 2017, fq 81.

⁹³Saiti.E, Zejneli.I, E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup 2017, fq 81-82.

- Gjykata e shkallës së dytë e Apelit raporton se duke vepruar në çështjen penale KZH-1026/18, në opinion i njohur si “Trust”, pas një seance publike më 11.03.2019, ka miratuar aktgjykimin me të cilin ankesat e të akuzuarit: nga gjashtë, e uli dënimin në katër vite e tetë muaj burg për biznesmenin S.K., respektivisht ia uli lartësinë e dënimit me burg për 16 muaj.

Gjykata për të akuzuarin e dytë V.A. vendosi që dënimin me burg prej tre vitesh t’ia zëvendësojë me dy vite me kusht. Gjykata e Apelit Shkup pjesën tjetër të aktgjykimit të shkallës së parë e vërtetoi në tërësi.”⁹⁴

- Gjykata e shkallës së dytë e Apelit e Shkupit raporton se, duke vepruar në çështjen penale KOKZ-46/18, në publik i njohur si "Tank", pas një seance publike, ka miratuar aktgjykimin me të cilin ankesat e të akuzuarit G.J. nga S, pjesërisht i pranoi në një mënyrë që ndryshoi vendimin e shkallës së parë në pjesën e vendimit për dënimin dhe dënoi të pandehurin me një dënim me burg prej 4 (katër) vjetësh.

Në pjesën e mbetur, Gjykata e Apelit në Shkup konfirmoi vendimin e shkallës së parë në tërësinë e saj.⁹⁵

⁹⁴http://www.vsrn.mk/wps/portal/asskopje/sud/vesti_sopsttениje_za_javnosta_11.3.2019апелационен суд Скопје.

⁹⁵http://www.vsrn.mk/wps/portal/asskopje/sud/vesti_sopsttениje_za_javnosta_28.3.2019апелационен суд Скопје

Analiza e rolit të Policisë Financiare në tri rastet e paraqitura

Sipas Kodit penal: - Neni 353 v, Neni 45 i Kodit penal të RMV (puna e papërgjegjshme në shërbim) pika 1 ku thuhet: “(1) Personi zyrtar ose personi përgjegjës në ndërmarrjen publike ose institucionin publik i cili me shkeljen e rregullave ligjore për konflikt të interesave ose për veprim të pandërgjegjshëm gjatë kryerjes së autorizimit diskret, me anashkalim të mbikëqyrjes së obligueshme ose në mënyrë tjetër haptazi në mënyrë të pandërgjegjshme vepron në kryerjen e autorizimeve dhe detyrave të veta dhe me këtë do të përfitojë për vete ose për tjetrin ndonjë dobi ose tjetrit do t’i shkaktojë dëm, do të dënohet me burg prej tre muajve deri në tre vjet”. Po ashtu edhe sipas Nenit 22 të Kodit penal të RMV: “(Bashkëkryerja) Nëse dy ose më shumë persona, duke marrë pjesë në një akt të kryerjes ose me ndonjë kontribut të veçantë drejt kryerjes së veprës, bashkërisht kryejnë veprë penale, secili prej tyre do të dënohet me dënimin e caktuar për atë veprë”. Por edhe Neni 45 i Kodit penal: - “(1) Kryerësit i cili me paramendim do të kryej dy ose më shumë veprime të lidhura në kohë që paraqesin realizim të shumëfishtë të veprës së njëjtë, duke përdorur lidhje të njëjtë të përhershme, raste të njëjta ose rrethana tjera të ngjashme, gjykata do t’i shqiptojë dënim të vetëm brenda kufijve të dënimit të caktuar për atë veprë.(2) “Kryerësit i cili nën kushtet nga paragrafi 1 do të kryejnë dy ose më shumë veprime të lidhura në kohë që paraqesin realizim të veprave të njëjta, gjykata do t’i shqiptojë dënim brenda kufijve të dënimit të përcaktuar për veprën më të rëndë”.(3) “Nëse me veprimet nga paragrafët (1) dhe (2), kryerësi si pasojë e tërë realizon pasojën e ndonjë veprë të rëndë penale, do të dënohet me dënimin e paraparë për atë veprë”.(4) “Dispozitat nga paragrafët (1) dhe (2) nuk zbatohen ndaj veprimeve të kryera pas ngritjes së aktakuzës”. Në të tre rastet e paraqitura policia financiare ka vepruar sipas KP dhe rregulloreve të punës dhe roli i saj është kryer në përputhshmëri me obligimet që dalin nga ato. Shkelja e Nenit 353, 22 dhe 45 nga Kodi Penal ka rezultuar me dëmtimin e Buxhetit të institucioneve të cilat të dyshuarit kanë drejtuar apo në të cilët kanë punuar dhe kjo është e dënueshme me ligj.

Analiza e rolit të Prokurorisë publike

Sipas përgjigjes që morëm nga ana e prokurorisë publike si dhe nga statistikat e raporteve të paraqitura, erdhëm në konkluzion se prokuroria publike në të shumtën e rasteve ka vepruar sipas kompetencave dhe rregullave që ka, duke reaguar në kohë ndaj paraqitjeve dhe dëshmimeve të cilat kanë ekzistuar. Gjithashtu edhe në rastin e paraqitur në punim i cili ka qenë i iniciuar nga vetë policia financiare me paraqitjen e dëshmimeve kundër 5 personave, të cilët kishin shkelur nenin 353. Nëse vepra nga paragrafët (1) dhe (4) është kryer gjatë prokurimeve publike ose në dëm të mjeteve të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga fondet publike ose mjetet e tjera shtetërore, kryerësi do të dënohet me burg më së paku pesë vjet, edhe në këtë rast prokuroria publike ka reaguar duke ngritur aktakuzë kundër të njëjtëve.

Analiza e rolit të Prokurorisë Publike për ndjekjen e veprave penale të cilat kanë të bëjnë dhe rezultojnë nga përmbajtja e ndjekjes së paligjshme të komunikimeve, në bazë të rasteve të paraqitura

Në këtë punim si shembuj për analizë morëm 6 raste të PSP të cilat ishin të lidhura me shkeljen e Ligjit të Prokurimeve Publike dhe në cilat raste kishte keqpërdorime të mëdha të procedurave të prokurimit publik. Në rastin **Transportuesi** ku është shkelur neni 353, për veprën penale “keqpërdorim i pozitës zyrtare dhe autorizimit” është ngritur padi kundër 21 personave, në rastin **Trust** "Keqpërdorim me procedurat për prokurime publike, dhënien e një kontrate të prokurimit publik ose partneritetin publiko-privat" nga neni 275-v i Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë, kundër tre personave juridik është propozuar aktakuza për veprën penale “Keqpërdorim me procedurat e shpalljes publike, dhënia e kontratës së prokurimit publik ose partneriteti publiko-privat". Në rastin **Tanku** është ngritur aktakuza kundër 2 personave për veprën penale "Keqpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar" nga neni 353 i Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë dhe aktakuza kundër një personi për veprën penale "Marrja e një shpërblimi për ndikim të paligjshëm" nga neni 359 i Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në rastin **Trajektorja** është ngritur aktakuza kundër 3 personave me iniciale V.P., M.J. dhe L.G. për krimin "Keqpërdorim të pozitës dhe autorizimit zyrtar" nga neni 353, paragrafi 5, paragrafi 1 të nenit 22 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe një Aktakuzë me propozim të prokurorisë kundër personit me iniciale N.G. për një vepër penale "Marrja e një shpërblimi të paligjshëm" nga neni 359, paragrafi 2 i Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë

së Veriut. Në rastin **Tarifa** u ngrit aktakuza kundër tre personave për veprën penale "keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit" sipas nenit 353 të Kodit Penal, në rastin Tenderët, është ngritur aktakuzë kundër 3 personave për veprën penale "keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit" nga neni 353 i Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë. Në rastin **Tender** është parashtruar aktakuza kundër 3 personave për veprën penale "Keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit" nga neni 353 parag.5 v.v me parag.1 v.v, nenin 22 nga KP.

Nga këto shembuj mund të përfundojmë se PSP ka vepruar në përputhshmëri me dëshmitë e dëgjuara si dhe me argumentet e mbledhura, duke vepruar sipas kompetencave që ka sipas Ligjit.

Analiza e rolit të gjykatave sipas shembujve të paraqitur në punim

Nga tri shembujt e rasteve Tank, Trust dhe Treqind për të cilët gjykatat morën vendime për dënim me burg sipas ligjit, mund të arrijmë në përfundimin se gjykatat në këto raste kanë vepruar sipas ligjit dhe kanë marrë parasysh kallëzimet penale dhe argumentet e paraqitura duke reaguar në mënyrë efikase në luftimin e korrupsionit në procedurat e prokurimeve publike, ku këto dënime luajnë një rol të madh në parandalimin e korrupsionit në fushën e prokurimeve publike në të ardhmen. Nga shumë raporte të cilat janë përpiluar nga ana e Komisionit Evropian në lidhje me progresin e RMV, mund të shohim se këto raporte theks të veçantë i kanë kushtuar korrupsionit si një kusht kryesor për të marrë raport pozitiv, d.m.th lufta ndaj korrupsionit fillon nga reformat në gjykata dhe këto reforma vazhdojnë ende të zbatohen në fushën e drejtësisë, si një ndër themelet e luftës ndaj korrupsionit.

Përfundime dhe Konkluzioni

Prokurimet publike paraqesin një fushë të gjerë vepruese të cilat nuk mund të përmblihen në një punim të vetëm, megjithatë kjo tezë u përpoq të përmbledhë pjesën e keqpërdorimit nga ana e pjesëmarrësve në prokurime publike, si dhe rolin e institucioneve përkatëse siç janë MPB, Prokuroria Publike, Gjykatat Themelore dhe e Apelit, PSP, Biroja për Prokurime Publike. Gjatë punimit të kësaj teze, leximit të materialeve të shumta, mbledhjes së të dhënave, hulumtimit dhe analizave që përdorëm nga rastet e ndryshme që kanë ndodhur në vitet e kaluara në shtetin tonë, përgjigjet që morëm prej institucioneve përkatëse dhe gjitha ato rezultate të

analizave të hulumtuesve të tjerë, erdhëm në përfundim se në këtë fushë ka hapësirë për manipulime të shumta dhe ka nevojë për përmirësime të rregulloreve dhe të ligjit.

Hapësira për keqpërdorime në fushën e prokurimeve publike fillon gjatë procesit të përgatitjes së dokumentacionit tenderik nga ana e autoriteteve kontraktuese, mënyra e paraqitjes dhe vendosjes së kushteve për konkurrim të palëve konkurruese, ku ka gjasa të ketë edhe diskriminime.

Sipas rasteve që përmendëm kemi edhe keqpërdorime të detyrës zyrtare, me çka organet kontraktuese nuk i kanë zbatuar rregullat e procedurës së prokurimit publik me ç'rast edhe janë dënuar nga ana e institucioneve përkatëse.

Gjykatat e pavarura, komisioni i pavarur kundër korrupsionit, policia efikase, organete përgjegjshme kontraktuese, prokuroria e përkushtuar në luftën ndaj korrupsionit në prokurimet publike, ligji efikas dhe i përshtatur normave evropiane mbi prokurimet publike, drejtësia maksimale dhe konkurrenca e drejtë, transparente dhe jodiskriminuese, do të ishin themelet mbi të cilat do të ndërtohej një shoqëri e drejtë dhe do të reduktonte në masë të madhe rastet e korrupsionit në prokurimet publike në shtetin tonë. Gjithë kjo që u përmend nuk do të thotë se nuk ekziston, por kjo fushë është aq e rëndësishme sa që gjithmonë ka hapësirë për përmirësime të reja, zhvillim të metodave të reja të luftës ndaj korrupsionit dhe avancim në rrugën drejt BE-së.

Tema e prokurimeve publike haset shumë shpesh në shoqërinë e çdo shteti, për shkak se aty preken edhe fushat më të ndjeshme të saj si sektori privat, publik, taksapaguesit, etj. Prokurimet publike si pjesë kryesore e funksionimit normal të një shteti, kanë rol kryesor në zhvillimin e drejtë të tregut ekonomik dhe konkurrencës. Për shkak të rëndësisë së madhe që ka stabiliteti i vet sistemit të prokurimeve publike dhe vendii tij në Bruto Prodhimin Vendor të shtetit, një pjesë e konsiderueshme e mjeteve të tij janë të lidhura me qëllimet themelore që duhet të arrihen nëpërmjet sistemit të prokurimeve publike, të cilat janë: konkurrenca, transparenca, llogaridhënia, jodiskriminimi, dhe shumë karakteristika të tjera themelore.

Sistemi për prokurime publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut është i rregulluar me Ligjin për prokurime publike. Qëllimi i këtij punimi është që nga njëra anë të bëjë paraqitjen, analizat dhe krahasimet në lidhje me rregullimin e prokurimeve publike dhe përputhshmërinë e Ligjit për prokurime publike me normat evropiane, dhe nga ana tjetër me anë të hulumtimit i cili është pjesë përbërëse e punimit, të hulumtojë dhe analizojë rastet dhe shkaqet e keqpërdorimit

dhe korrupsionit, të cilat kanë ndodhur nëpër institucionet shtetërore që kapin sferën e prokurimeve publike.

Korniza normative ekzistuese për prokurimet publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, siguron respektimin e parimeve themelore të transparencës, trajtim të barabartë, efikasitet dhe kursim gjatë ndarjes së marrëveshjeve përprokurime publike. Duke e pasur parasysh faktin se nëpërmjet prokurimeve publike, harxhohen para publike, para të qytetarëve dhe firmave nëpërmjet të taksave, imponohet nevoja që kjo të realizohet sa më më përgjegjësi, transparence, në mënyrë sa më ligjore dhe të qartë, sa më publike, etj. Gjithashtu duhet të jepet raport për atë se si janë harxhuar paratë e tyre.

Sipas shumë statistikave që u paraqitën në këtë punim, mund të arrijmë edhe në konkluzionin se me ndryshimin e Ligjit për Prokurime Publike dhe me përmirësimin e tij, me përshtatjen e neneve të ligjit sipas direktivave të BE-së, gjatë viteve të kaluara gradualisht janë shtuar edhe rastet të cilat kanë marrë dënimin e merituar për keqpërdorimet e bëra, por edhe janë minimizuar hapësirat për keqpërdorime të mëtutjeshme nga ana e organevekontraktuese.

Duke shikuar nga e kaluara deri në ndryshimet e fundit të Ligjit për Prokurime Publike, mund të përfundojmë gjithashtu se çdoherë ka hapësirë për përmirësime të mëtutjeshme të ligjit dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me procedurat e prokurimit publik. Dënimet e marra nga rastet e mëparshme mund të shërbejnë si mësim për udhëheqësit e organeve shtetërore si dhe për vetëdijesim më të madh në këtë aspekt.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

a) *Libra dhe artikuj*

1. Statovci Ejup, Mbrojtja e pronësisë – Prishtinës, 2009
2. JashariAdnan, Subjektet e sëdrejtës tregtare, Tetovë, 2009
3. Zejneli Ismail, Kambovski Vllado, E drejta penale (pjesa e posaçme), Tetove, 2007
4. Saiti Ejup, Zejneli Ismail, E drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup 2017
5. Hetemi Mehdi, Njohurit themelore të së drejtës afariste, Prishtinë, 2006
6. Hetemi Mehdi, Disa tema aktuale te ekonomisë së tregut, Prishtinë, 2005
7. Halili Ragip, Kriminologjia, Prishtine, 2015
8. Latifi Vesel, Kriminalistika, 2014
9. Latifi Vesel, Taktika Kriminalistike, Prishtinë, 2001
10. Latifi Vesel, Politika Kriminale, Prishtinë, 2008
11. Sahiti Ejup, E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë, 2005
12. Shishani Fitim, Roli i Policisë në Parandalimin e Kriminalitetit, Prishtinë, 2006
13. Begeja Skender, Kriminalistika, Tiranë, 2004
14. Kambovski Vllado, Zejneli Ismail, Sulejmanov Zoran, Latifi Vesel, Milovanović Zllat, Netkova Bistra, Ilievski Jovan & Janičević Nenad, Kikerekova Tanja, Kriminaliteti i Organizuar-Aspekte Juridike, Tetovë 2009.
15. TeofilovicNebojsa, Jelanqi Milenko, Sprecavanje Otkrivanje i Dokazivanje Krivicni Dela Korupcije i Pranja Novca, Beograd, 2006
16. Аргировски. А, Глигоријевска.Р, Мацевска – Сараќинчева.А, Папеш.Г, Данаилов.Д, Каракашова Шулев.Б, Трајковиќ.М, Ѓерлек.Е, Дониновска Сусинов.Ф, Прирачник за јавни набавки Четврто издание Биро за јавни набавки сектор за нормативна дејност, обуки и меѓународни односи (електронско издание) Скопје 2017
17. DragisevicMiomir, Novi ugovori u Megjunarodnoj poslovnoj, Podgorica, 2002
18. Iia Kristo, Biznesi Ndërkombëtar, Tiranë 2004
19. Marson J. "Business Law" Oxford 2009
20. Ivanka Spasić "Ugovor o Leasingu" Beograd 1990

21. Gustavo Piga, Tünde Tátrai, Law and economics of public procurement reforms, London, Routledge, 2018. ©2018.
22. Sope Williams-Elegbe, Fighting Corruption in Public Procurement: A Comparative Analysis of Disqualification or Debarment Measures (Studies in International Law), Oxford-Portland Oregon 2012.
23. Barry, N. The French Law of Contract. Oxford, 1992.
24. В. Камбовски, Коментар на Кривичниот законик на Република Македонија, Клуб Матица, Скопје, 2011, стр. 948-949.
25. Камбовски, В. & Тупанчески, Н., Кодификација на казненото законодавство, ЗКПКМ и ОБСЕ, 2015 година.
